


**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, me trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi i EULEX Jonathan Welford-Carroll si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Kryetari Xhevdet Abazi dhe Gjykatësja e EULEX Caroline Charpentier si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX Tara Khan si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër;

**SABIT GECI**, i ngarkuar, sipas aktakuzës së Prokurorit të PSRK PPS nr. 08/09 të ngritur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë më 06 Gusht 2010 dhe të konfirmuar më 24 Nëntor 2010 me Aktvendimin KA nr.64/2010, me gjashtë akuza për **Krime Luftë Kundër Popullatës Civile** në shkelje të Nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), gjithashtu paraparë në Nenet 120 dhe 121 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës; dhe **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** në shkelje të Nenit 328(2) të KPK;

**RIZA ALIJA**, i ngarkuar, sipas aktakuzës së PSRK PPS nr. 08/09 të ngritur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë më 06 Gusht 2010 dhe të konfirmuar më 24 Nëntor 2010 me Aktvendimin KA nr.64/2010, me tri akuza për **Krime Luftë Kundër Popullatës Civile** në shkelje të Neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ, gjithashtu paraparë në Nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës;

**HAKI HAJDARI**, i ngarkuar, sipas aktakuzës së PSRK PPS nr. 117/10 të ngritur më 29 Dhjetor 2010 dhe të konfirmuar më 25 Mars 2011 me Aktvendimin KA nr. 208/2010 dhe të bashkuar me çështjen P nr. 45/2010 gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 04 Maj 2011, me dy akuza për **Krime Luftë Kundër Popullatës Civile** në shkelje të Neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ, gjithashtu paraparë në Nenet 23 dhe 120 të KPK, dhe në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës; dhe



**SHABAN HOTI**, i ngarkuar, sipas aktakuzës së PSRK PPS nr. 117/10 10 të ngritur më 29 Dhjetor 2010 dhe të konfirmuar më 25 Mars 2011 me Aktvendimin KA nr. 208/2010 dhe të bashkuar me çështjen P nr. 45/2010 gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 04 Maj 2011, me dy akuza për **Krime Lufte Kundër Popullatës Civile** në shkelje të Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ, gjithashtu paraparë në Nenet 23 dhe 120 të KPK, dhe në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor në datat në vijim:

- 14, 16, 21, 23, 24, 28, 31 Mars 2011;
- 04, 06, 07 Prill 2011;
- 04, 05, 16, 19, 23, 25 Maj 2011;
- 02, 08, 09, 10, 20 Qershor 2011;
- 18, 20, 21, 25, 29 Korrik 2011;

Të gjitha në praninë e Prokurorit të PSRK Maurizio Salustro<sup>1</sup>, të pandehurit Sabit Geci dhe avokatëve të tij mbrojtës Mahmut Halimi dhe Haxhi Millaku, të pandehurit Riza Alija dhe avokatit të tij mbrojtës Gëzim Kollqaku<sup>2</sup>, dhe nga 05 Maji 2011 dhe më tej gjithashtu në praninë e të pandehurit Haki Hajdari dhe avokatit të tij mbrojtës Gani Rexha<sup>3</sup>, dhe të pandehurit Shaban Hoti dhe avokatit të tij mbrojtës Agim Lushta;

Pas shqyrtimit dhe votimit të Trupit Gjykues më 29 Korrik 2011, në të njëjtën ditë, në pajtim me Nenin 392 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), ka shpallur publikisht dhe në praninë e të gjitha palëve të lartpërmendura këtë:


## AKTGJYKIM

I akuzuari **SABIT GECI**, me nofkën “Qopa”, i biri i Sheremet Geci dhe Shefkije Nuraj, i lindur më 20 Gusht 1958 në fshatin Llaushë, Komuna e Skenderajt, Shqiptar Kosovar, aktualisht me vendbanim në Mbreti Zogu nr. 9 në Prishtinë, i martuar me katër fëmijë, më parë i dënuar për Tentim Detyrimi, Rrezikim të Sigurisë dhe Shkaktim të Rrezikut të Përgjithshëm, në paraburgim që nga 06 Maji 2010;

<sup>1</sup> Me përjashtim të atyre ditëve kur ai ka dërguar zëvendësues të autorizuar.

<sup>2</sup> Me përjashtim të atyre ditëve kur ai ka dërguar zëvendësues të autorizuar.

<sup>3</sup> Me përjashtim të atyre ditëve kur ai ka dërguar zëvendësues të autorizuar.



## **SHPALLET FAJTOR**

### **Për (Akuza 1) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**


- sepse nga ose rreth 18 Maji deri më 03 Qershor 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duke mbajtur post komandues në burgun e improvizuar përbrenda një kompleksi ushtarak të UÇK në qytetin Kukës në Republikën e Shqipërisë, së bashku me pjesëtarë të tjerë të UÇK ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore (p.sh. kushte të pista të jetesës, mungesë e kushteve higjienike adekuate, ujit dhe ushqimit) një numër të papërcaktuar të burgosurve civilë, duke përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe [REDACTED].

### **Për (Akuza 2) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- sepse më ose rreth 19 Majit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK duke mbajtur post komandues në burgun në kampin e UÇK në Kukës, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK, ka torturuar të burgosurit civilë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe [REDACTED] duke tentuar që të nxjerrë informacione dhe pohime nga viktimat duke përdorur dhunë kundër tyre në mënyrë të përsëritur dhe duke urdhëruar pjesëtarë të tjerë të UÇK që të bëjnë të njëjtën gjë.

### **Për (Akuza 3) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- Sepse në disa raste nga ose rreth 18 Maji deri më 03 Qershor 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duke mbajtur post komandues në burgun në kampin e UÇK në Kukës, i akuzuari ka shkelur integritetin trupor të një numri të papërcaktuar të burgosurve civilë duke përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe



██████████ me anë të keqtrajtimit të rëndë dhe rrahjeve që kanë ndodhur brenda qelive të improvizuara ku të burgosurit mbaheshin të ndaluar.

### **Për (Akuza 5) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- Sepse më ose rreth 12 Prillit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Riza Aliajn, ka shkelur integritetin trupor të ██████████, civil i ndaluar në një burg të improvizuar në kampin e UÇK në Cahan, Republika e Shqipërisë, duke e rrahur atë rëndë dhe në mënyrë të përsëritur me një patericë dhe shkop të drurit.

Duke vepruar kështu, **Sabit Geci ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për katër akuza për veprën penale Krime Luftë Kundër Popullatës Civile** sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ në lidhje me Nenin 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës.


### **I akuzuari SABIT GECI gjithashtu**

## **SHPALLET FAJTOR**

### **Për (akuza 7) Posedim të Paautorizuar të Armës**

- sepse më 06 Maj 2010 kur u arrestuar në Prishtinë, i akuzuari kishte në posedim personal një armë gjysmë automatike të mbushur, respektivisht një Crvena Zastava M-57 Lux kalibër 7.62x25 mm pistoletë, pa autorizim.

Duke vepruar kështu, **Sabit Geci ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** në shkelje të Nenit 328(2) të KPK.



**I akuzuari SABIT GECI**

## **SHPALLET I PAFAJSHËM**

### **Për (Akuza 4) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**


- sepse nuk është vërtetuar që më ose rreth 05 Qershorit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK duke mbajtur post komandues në burgun e Kukësit, në bashkëkryerje me Xhemshit Krasniqin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK, ka marrë pjesë në vrasjen e [REDAKTUAR], një civil i mbajtur rob në Kukës i cili ka vdekur si rezultat i një plage në këmbë, të shkaktuar nga një e shtënë me armë zjarri nga një ushtar i paidentifikuar i UÇK.

### **Për (Akuza 6) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- sepse nuk është vërtetuar që në një datë të papërcaktuar në mes të 12 Prillit dhe mesit të Qershorit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuarin në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Riza Aliajn, ka shkelur integritetin trupor të një numri të paidentifikuar të civilëve duke përfshirë [REDAKTUAR], Dëshmitarin O, Dëshmitarin K, Dëshmitarin M, dhe Dëshmitarin N të ndaluar në qendrën e ndalimit në Cahan duke e urdhëruar kryesin e drejtpërdrejtë Riza Alija që të përdorë dhunë kundër tyre.

Prandaj, sipas Nenit 390 pika (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) i akuzuari **Sabit Geci lirohet nga akuzat (Akuza 4) dhe (Akuza 6) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile.**

I akuzuari **RIZA ALIJA**, me nofkën “Komandant Hoxha”, i biri i Imer Alija dhe Nepe Bajrami, i lindur më 21 Janar 1960 në fshatin Ponoshec, Komuna e Gjakovës, Shqiptar Kosovar, aktualisht me vendbanim në fshatin Ponoshec, Gjakovë, i martuar me katër fëmijë, pa dënime të mëparshme të ditura, në paraburgim që nga 23 Qershori 2010;



## SHPALLET FAJTOR


### Për (Akuza 2) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile

- sepse me ose rreth 12 Prillit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Sabit Gecin, ka shkelur integritetin trupor të [REDACTED], një civil i ndaluar në një burg të improvizuar në kampin e UÇK në Cahan, Republika e Shqipërisë, duke e rrahur atë rëndë dhe në mënyrë të përsëritur me një patericë dhe me shkop të drurit.

### Për (Akuza 3) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile

- sepse gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, ka shkelur integritetin trupor të civilëve të cekur në vijim të ndaluar në burgun në kampin e UÇK në Cahan:
  - [REDACTED], duke e rrahur atë në një numër mënyrash duke përfshirë duke e goditur atë me këpucë të forta më ose rreth 14 Prillit 1999, dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK që të godasin dhe shkelmojnë [REDACTED] në një numër të papërcaktuar rastesh (veçanërisht kur [REDACTED] ka qenë rrugës nga qelia në cilën mbahej për në tualet) në data të papërcaktuara në mes të 12 Prillit dhe mesit të Qershorit 1999.
  - Dëshmitari M, duke e goditur atë në mënyrë të përsëritur në shpinë me shufër hekuri me ose rreth 17 Prillit 1999.
  - Dëshmitari K, Dëshmitari M, Dëshmitari N, dhe Dëshmitari O, duke i rrahur ata në një numër mënyrash, përfshirë goditjen e tyre me një shkop të drurit dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK që të i rrahin ata, në data të papërcaktuara në mes të 12 Prillit dhe mesit të Qershorit 1999.

Duke vepruar kështu, **Riza Alija ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për dy akuza për veprën penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ**



dhe në lidhje me Nenin 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit shtesë II të Konventave të Gjenevës.

**I akuzuari RIZA ALIJA**

## **SHPALLET I PAFAJSHËM**

### **Për (Akuza 1) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- sepse nuk është vërtetuar që nga Prillit deri në mesin e Qershorit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Haki Hajdarin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK, kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore (p.sh. kushte të pista të jetesës, mungesë e higjienës së përshtatshme, ushqimit dhe ujit) një numër të paidentifikuar i të burgosurve civil të mbajtur në qendrën e ndalimit në kampin e UÇK në Cahan.


Prandaj, sipas Nenit 390 pika (3) të KPPK, i akuzuari **Riza Alija lirohet nga akuza (Akuza 1) për Krime Luftë Kundër Popullatës Civile.**

I akuzuari **HAKI HAJDARI**, me nofkën “Haki Drenica”, i biri i Bajram Hajdari dhe Ajete Musliu, i lindur më 19 Maj 1963 në Klinë të Ulët, Komuna e Skenderajt, Shqiptar Kosovar, aktualisht me vendbanim në Klinë të Ulët, pa dënime të mëparshme të ditura;

## **SHPALLET FAJTOR**

### **Për (Akuza 2) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile**

- sepse më ose rreth 03 Majit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Shaban Hotin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK, ka torturuar Dëshmitarin N, një civil Shqiptar Kosovar të ndaluar në qendrën e ndalimit në Cahan duke tentuar që të nxjerr nga ai informata dhe pohime duke e rrahur në mënyrë të përsëritur me shkopinjtë druri.



Duke vepruar kështu, **Haki Hajdari ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Krime Lufte Kundër Popullatës Civile** sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ dhe në lidhje me Nenin 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit II shtesë të Konventave të Gjenevës.

**I akuzuari HAKI HAJDARI**

### **SHPALLET I PAFAJSHËM**

**Për (Akuza 1) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile**

- sepse nuk është vërtetuar që nga Prilli deri në mesin e Qershorit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK duke mbajtur post komandues në kampin e Cahanit, në bashkëkryerje me Riza Alijajn dhe ushtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK, ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore (p.sh. kushte të pista të jetesës, mungesë e higjienës adekuate, ushqimit dhe ujit) një numër të papërcaktuar të burgosurve civilë të ndaluar në qendrën e ndalimit në kampin e UÇK në Cahan.

Prandaj, sipas Nenit 390 pika (3) të KPPK, i akuzuari Haki Hajdari lirohet nga akuza (Akuza 1) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile.

I akuzuari **SHABAN HOTI**, i biri i Ahmet Hotit dhe Aza Jasharit, i lindur më 24 Shtator 1971 në Polac, Komuna e Skenderajt, Shqiptar Kosovar, aktualisht me vendbanim në Skenderaj, pa dënime të mëparshme të ditura;

### **SHPALLET FAJTOR**

**Për (Akuza 1) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile**

- sepse me ose rreth 03 Majit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me Haki



Hajdarin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK, ka torturuar Dëshmitarin N, një civil Shqiptar Kosovar të ndaluar në qendrën e ndalimit në Cahan, duke tentuar që të nxjerrë informacione dhe pohime nga ai përderisa e ka rrahur në mënyrë të përsëritur me shkopinj druri.

Duke vepruar kështu, Shaban Hoti ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Krime Lufte Kundër Popullatës Civile sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ dhe në lidhje me Nenin 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe Nenet 4 dhe 5(1) të Protokollit II të Konventave të Gjenevës.

## **I akuzuari SHABAN HOTI**

### **SHPALLET I PAFAJSHËM**

#### **Për (Akuza 2) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile**


- sepse nuk është vërtetuar që më ose rreth 09 Majit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK, në bashkëkryerje me një ushtar tjetër të paidentifikuar të UÇK, ka torturuar Dëshmitarin N, një civil Shqiptar Kosovar të ndaluar në qendrën e ndalimit në Cahan, duke tentuar që të nxjerrë informacione dhe pohime nga dëshmitari N përderisa një ushtar i paidentifikuar i UÇK e ka rrahur atë në duar dhe në këmbë me një shkop druri.

Prandaj, sipas Nenit 390 pika (3) të KPPK, i akuzuari Shaban Hoti lirohet nga akuza (Akuza 2) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile.

## **SABIT GEÇI**

### **DËNOHET**

- me tetë /8/ vite burgim për (Akuza 1) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile
- me dymbëdhjetë /12/ vite burgim për (Akuza 2) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile
- me nëntë /9/ vite burgim për (Akuza 3) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile



- me tetë /8/ vite burgim për (Akuza 5) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile
- me gjobë prej 4,000.00 euro për veprën penale Mbjajta në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi unik përcaktohet të jetë pesëmbëdhjetë /15/ vite burgim dhe një gjobë prej 4,000.00, sipas Nenit 48 paragrafi (2) nënparagrafi (3) i KP RSFJ.

Koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e përcaktuar, sipas Nenit 50 paragrafi (1) të KP RSFJ.

**RIZA ALIJA**

**DËNOHET**

- me tetë /8/ vite burgim për (Akuza 2) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile
- me nëntë /9/ vite burgim për (Akuza 3) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile

Dënimi unik përcaktohet të jetë dymbëdhjetë /12/ vite burgim sipas Nenit 48 paragrafi (2) nënparagrafi (3) të KP RSFJ.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënimin e përcaktuar, sipas Nenit 50 paragrafi (1) të KP RSFJ.

**HAKI HAJDARI**


**DËNOHET**

- me gjashtë /6/ vite burgim për (Akuza 2) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile

**SHABAN HOTI**

**DËNOHET**

- me shtatë /7/ vite burgim për (Akuza 1) Krime Luftë Kundër Popullatës Civile



Arma e cila u e gjet në posedimin personal të Sabit Gecit, një pistoletë gjysmë-automatike Crvena Zastava M-57 Lux kalibër 7.62x25, konfiskohet sipas Nenit 60 paragrafi (1) të KPK dhe Nenit 494 paragrafi (1) të KPPK.


Secili prej të akuzuarve do të kompensojë pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale sipas Nenit 102 paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. I akuzuari Sabit Geci dhe i akuzuari Riza Alija do të kompensojnë shumën prej 2,000.00 euro secili. I akuzuari Haki Hajdari dhe ai akuzuari Shaban Hoti do të kompensojnë shumën prej 500.00 euro secili.

Pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil, sipas Nenit 112 paragrafi (3) të KPPK.

## ARSYETIMI


### I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 06 Gusht 2010, Prokurori i PSRK Robert Dean ka ngritur aktakuzën PPS nr. 08/2009 kundër Sabit Gecit dhe Riza Alijajt duke e ngarkuar secilin të pandehur me një akuzë për Krime Luftë Kundër Popullatës Civile për veprat e kryera kundër të ndaluarve civilë të mbajtur në dy kampe të drejtuara nga UÇK në Kukës dhe në Cahan në Republikën e Shqipërisë gjatë vitit 1999, dhe një akuzë për Posedim të Paautorizuar të Armës kundër të pandehurit Geci. Seanca për konfirmimin e aktakuzës është mbajtur më 07 Tetor 2010 dhe gjatë saj Prokurori i PSRK Maurizio Salustro ka paraqitur një ndryshim të formulimit të dispozitivit të aktakuzës ku janë ndarë akuzat e ndryshme individuale për Krime Luftë. Seanca është shtyrë deri në 22 Tetor me qëllim që Mbrojtjes të i jepet kohe e duhur që të shqyrtojë ndryshimin. MË 24 Nëntor 2010, Gjykatësi i EULEX Nikolay Entchev e ka konfirmuar Aktakuzën siç është ndryshuar ë Aktvendimin KA nr. 64/2010.
2. Me 29 Dhjetor 2010, Prokurori i PSRK Salustro ka ngritur Aktakuzën PPS nr. 117/2010 kundër Haki Hajdarit dhe Sali Rexhepit, duke i akuzuar ata për Krime Luftë Kundër Popullatës Civile me anë të maltretimit të të ndaluarve civil në kampin e drejtuar nga UÇK në Cahan, Shqipëri gjatë vitit 1999. Më 14 Shkurt 2011 është



mbajtur seanca për konfirmim të aktakuzës dhe pranueshmërinë e provave. Me kërkesë të avokatëve mbrojtës të të dy të pandehurve, seanca është shtyrë për 22 Mars 2011 me qëllim që mbrojtjes të i jepet kohë e duhur për të shqyrtuar materialet e mbledhura gjatë hetimeve që mbështesin aktakuzën.

3. Në ndërkohë, më 16 Shkurt 2011, Prokurori ka parashtruar një Aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve penale në rastin PPS nr. 117/2010 për të përfshirë Shaban Hotin si të dyshuar. Më pas, më 25 Shkurt 2011, Prokurori ka ngritur një aktakuzë ndaras nën PPS nr. 117/2010 (të regjistruar në Gjykatë nën KA nr.09/2011) kundër Shaban Hotit duke e ngarkuar atë me dy akuza për Krime Luftë në lidhje me të ndaluarit në kampin e UÇK në Cahan.
4. Me kërkesë të Prokurorit të PSRK, më 02 Mars 2011 Gjykatësi për Konfirmim Nikolay Entchev ka lëshuar një Urdhër për bashkimin e çështjes penale KA nr. 09/2011 kundër Shaban Hotit me çështjen penale KA nr. 208/2010 kundër Haki Hajdarit dhe Sali Rexhepit pasi që veprat e pretenduara penale janë të lidhura dhe mbështeten mbi prova të përbashkëta.
5. Seanca për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hajdarit, Rexhepit dhe Hotit është mbajtur më 22 Mars 2011. Më 25 Mars 2011, Gjykatësi për Konfirmim Nikolay Entchev ka lëshuar Aktvendimin KA nr. 208/2010 me të cilin konfirmoi të dy aktakuzat dhe shpalli të gjitha provat në dosje të lëndës si të pranueshme.
6. Shqyrtimi gjyqësor kundër Sabit Gecit dhe Riza Alijajt ka filluar më 14 Mars 2011 përpara trupit të lartcekur të përzier të gjykatësve. Të dy të pandehurit janë deklaruar “të pafajshëm” për të gjitha akuzat për Krime Luftë të cekura në Aktakuzë. Sabit Geci është deklaruar “i fajshëm” për veprën penale të Posedim të Paautorizuar të Armës. Në mes 14 Marsit dhe 04 Majit, janë dëgjuar gjashtë dëshmitarë të Prokurorisë, dhe ata të gjithë kanë dëshmuar ekskluzivisht për ngjarjet që kanë ndodhur në kampin e drejtuar nga UÇK në Kukës.
7. Më 14 Prill 2011, Prokurori Salustro ka kërkuar që çështja kundër Haki Hajdarit, Sali Rexhepit dhe Shaban Hotit të bashkohet me shqyrtimin gjyqësor në vazhdim e sipër kundër Gecit dhe Alijajt. Më 04 Maj, ka filluar shqyrtimi gjyqësor kundër Hajdarit,




Rexhepit dhe Hotit në çështjen P nr. 13/2011, gjithashtu në praninë e të pandehurve Geci dhe Alija dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Të gjitha palët janë pajtuar për bashkimin e çështjeve sepse edhe pse ishin mbajtur njëmbëdhjetë seanca në shqyrtimin gjyqësor Geci/Alija, të gjitha provat e dëgjuar deri atëherë kishin të bëjnë me veprat që pretendohet të kishin ndodhur në kampin e UÇK në Kukës. Vetëm Geci dhe Alija janë akuzuar për kryerje të veprave penale në atë lokacion. Akuzat kundër Hajdarit, Rexhepit dhe Hotit kishin të bëjnë me ngjarjet që pretendohet të kishin ndodhur në kampin e UÇK në Cahan, Shqipëri. Prandaj, në bashkimin e këtyre çështjeve nuk kishte kurrfarë paragjykimi ndaj të pandehurve të ri. Si rrjedhim shqyrtimi gjyqësor vazhdoi kundër të pesë të pandehurve.

8. Më 16 Qershor 2011, avokati mbrojtës Qerimi kërkoi leje nga Gjykata që i pandehuri Rexhepi të lejohet të udhëtojë për në Turqi për një operacion urgjent të zemrës. Më 20 Qershor, Trupi Gjykses e veçoi lëndën kundër Sali Rexhepit sipas Nenit 34 KPPK dhe shqyrtimi gjyqësor vazhdoi kundër të katër të pandehurve të tjerë.
9. Fjalët përfundimtare janë dëgjuar më 21 dhe 25 Korrik 2011, dhe aktgjykimi është shpallur më 29 Korrik.

## **II. KOMPETENCA E GJYKATËS & CILËSIMI I VEPRËS PENALE**

10. Sipas Nenit 23 pika 1) i) të KPPK, Gjykatat e Qarkut janë kompetente që të gjykojnë çështjet penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon imponimin e dënimit penal prej së paku pesë viteve. Secili prej katër të akuzuarve është akuzuar për vepra penale Krime Luftë Kundër Popullatës Civile, që dënohen me minimum pesë vite burgim (sipas Nenit 142 KP RSFJ).
11. Prandaj, Gjykata e Qarkut është organi kompetent gjyqësor për të gjykuar këtë çështje penale.
12. Sipas Nenit 3.1 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX (“Ligji mbi Kompetencat”), Gjykatësit e EULEX kanë juridiksion dhe kompetenca “mbi çdo lëndë të hetuar apo



ndjekur penalisht nga PSRK.” Kjo lëndë është hetuar dhe ndjekur penalisht nga prokurorët e PSRK. Trupi gjykues në shqyrtim gjyqësor ka qenë i përbërë nga Gjykatësi i EULEX Jonathan Welford-Carroll si Kryetari i Trupit Gjykues, dhe Gjykatësja e EULEX Caroline Charpentier dhe Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Xhevdet Abazi si anëtarë të trupit gjykues. Palët nuk kanë pasur kundërshtime ndaj përbërjes së trupit gjykues.

13. Në aktakuzën e bashkuar të gjithë të pandehurit janë ngarkuar me disa akuza për “Krime Luftë Kundër Popullatës Civile”, sipas nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës 1949 dhe neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit II shtesë 1977 nën Nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ).
14. Sipas Rregullores së UNMIK 1999/24, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK 2000/59, KPRSFJ është Ligji Thelbësor i aplikueshëm në këtë rast. Kjo konfirmohet nga Gjykata Supreme e Kosovës në Populli v Latif Gashi.<sup>4</sup> KPPK është Ligji Procedural i Aplikueshëm në këtë rast.
15. Neni 3 i përbashkët i Konventave të Gjenevës 1949, inter alia, cekë:

Në rast të një konflikti të armatosur *jo të natyrës ndërkombëtare* (theksim shtesë) që ndodh në territorin e njërës prej Palëve të Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt do të jetë e detyruar që të aplikojë, si minimum, dispozitat në vijim:

- (1) Personat që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në armiqësitë, ... , në të gjitha rastet do të trajtohen në mënyrë humane, pa asnjë dallim armiqësor të bazuar në racë, ngjyrë, fe apo besim, gjini, prejardhje apo pasuri, apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.  
Për këtë qëllim, veprat në vijim janë dhe do të mbeten të ndaluara *në secilën kohë dhe në secilin vend* (theksim shtesë) sa i përket personave të lartpërmendur:
  - a. Dhunë ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasje së të gjitha llojeve, gjymtim, trajtim mizor dhe torturë;
  - b. – d. ... (jo relevante) Marrja e pengjeve;
- (2) ... (jo relevante)  
... (jo relevante)

<sup>4</sup> Latif Gashi, Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, 21 Korrik 2005 në f5.



Aplikimi i dispozitës paraprirëse nuk ndikon në statusin ligjor të palëve në konflikt.

16. Protokoll i Shtesë II, Pjesa II Trajtimi Human çekë:

Neni 4 – Garancitë themelore

1. Të gjithë personat që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ... në armiqësitë, pavarësisht nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, kanë të drejtë që të respektohen ata, nderi dhe bindjet dhe praktikat fetare të tyre. Ata në të gjitha rrethanat do të trajtohen në mënyrë humane, pas kurrfarë dallimi. Ndalohet që të urdhërohet që nuk do të mbijetojë askush.
2. Pa paragjykim ndaj parimit të përgjithshëm të përmendur më lart, veprat në vijim kundër personave të përmendur në paragrafin (1) janë dhe do të mbesin të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend kudo qoftë [theksim i shtuar]:
  - (a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të personave, në veçanti vrasja si dhe trajtimi mizor siç është tortura, gjymtimi apo çdo formë e ndëshkimit trupor;
  - (b) – (h) ... (jo relevante)
3. ... (jo relevante)

Neni 5 – Personat, liria e të cilëve ka qenë e kufizuar

1. Veç dispozitave të nenit 4, dispozitat në vijim duhet të respektohen si minimum në raport me personat e privuar nga liria për arsye të lidhura me konfliktin e armatosur, pavarësisht nëse ata janë të internuar apo të ndaluar:
  - (a) ... (jo relevante)
  - (b) personave të përmendur në këtë paragraf do t'u sigurohet, në masë të njëjtë si popullatës civile, ushqim dhe ujë i pijshëm dhe do t'u ofrohet siguri sa i përket shëndetit dhe higjienës dhe mbrojtje ndaj klimës së ashpër dhe rreziqeve të konfliktit të armatosur;
  - (c) – (e) ... (jo relevante)



17. Është ligj i vërtetuar dhe i qëndrueshëm se Neni 3 i Përbashkët i Konventës së Gjenevës dhe Nenet 4 dhe 5(1) të AP2 1977 janë e drejtë ndërkombëtare zakonore dhe kështu ka qenë edhe në kohën relevante për këtë lëndë.<sup>5</sup>

18. KP RSFJ – veprat penale esenciale:

Neni 22 – bashkë-pjesëmarrja

Nëse disa persona së bashku kryejnë një veprë penale duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre do të ndëshkohet siç është e përshkruar për veprën.

SHËNIM: Dispozita e mësipërme përsëritet në KPK në fuqi në Nenin 23 – Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale/bashkëkryerja.

Neni 142 – Krimet e luftës kundër popullatës civile

Kushdo që në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohë lufte, konflikti të armatosur apo okupimi, jep urdhër që popullata civile t'i nënshtrohet vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor, ..., vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të integritetit trupor apo shëndetit; ..., sjelljen e kundërligjshme në kampe përqendrimi dhe arrestime dhe ndalime të tjera joligjore, privimit të të drejtave për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; ... , apo që kryen ndonjë nga veprat e përmendura më lart, do të ndëshkohet me jo më pak se pesë vjet burgim apo dënim me vdekje.

SHËNIM: Dispozita e mësipërme përsëritet në KPK në fuqi në Nenin 120 – Krimet e luftës si shkelje e rëndë e nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës.

19. KP RSFJ – Zbatueshmëria e ligjit penal Jugosllav ndaj qytetarit të RSFJ që ka kryer veprë penale jashtë shtetit

Neni 106.


<sup>5</sup> Shin Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ku thuhet se Neni 3 i Përbashkët paraqet të drejtën ndërkombëtare zakonore në të dy konfliktet ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare në *Nikaragua vs Sh.B.*, *Merits* 1986 ICJ Rep. 4 (27 Qershor) në parag. 118-120.



Ligji penal Jugosllav zbatohet ndaj qytetarit të RSFJ kur ai, jashtë shtetit, kryen një vepër penale tjetër nga ato të përmendura në nenin 105 të këtij ligji, nëse ai gjendet në territorin e RSFJ ose është ekstraduar në RSFJ.

SHËNIM: Dispozita e mësipërme përsëritet në KPK në fuqi në Nenet 100 dhe 101.

20. Jugosllavia është bërë palë e lartë kontraktuese e Konventave të Gjenevës më 15 dhjetor 1950 dhe e Protokolleve Shtesë më 28 dhjetor 1978.
21. Ligji procedural relevant për këtë gjykim është KPPK në fuqi.
22. Secili nga të pandehurit ka ngritur çështjen e kompetencës së gjykatës për të gjykuar lëndët e krimeve të pretenduara të luftës të lidhura me luftën në mes të forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ka ekzistuar në Kosovë në rrethanat ku ka ndodhur kriminaliteti i pretenduar brenda territorit të palës së tretë, shtetit të Shqipërisë, e cila në asnjë fazë nuk ka qenë palë ndërlyftuese në konfliktin e armatosur. Për më shumë, të Pandehurit kanë përfshirë në këtë argument çështjet që lidhen me cilësimin e duhur të veprave të tilla që mund të vërtetohet se kanë ndodhur në Shqipëri. Ndonëse këto dy çështjet e kompetencës dhe cilësimit janë ngushtë të lidhura brenda kontekstit të kësaj lënde, ato mbesin dy çështje të veçanta dhe të ndara.
23. Si rrjedhim ngrihen çështjet në vijim:
  1. A ka ekzistuar në Kosovë gjendje e konfliktit të armatosur e cila ka qenë e karakterit jo-ndërkombëtar?
  2. A përfshihet ky konflikt i armatosur (nëse ka ekzistuar) në Konventat e Gjenevës, Nenin 3 të Përbashkët dhe Protokollin II Shtesë, Nenet 4 dhe 5(1)?
  3. Nëse po, çfarë ndikimi, nëse ka ndonjë, ka kjo mbi kompetencën e Gjykatave Penale të Kosovës, ku sjellja e pretenduar kriminale ka ndodhur jashtë kufirit territorial të Kosovës dhe brenda shtetit të palës së tretë, Shqipërisë, e cila asnjëherë nuk ka qenë palë në konflikt?



24. Së pari, duhet të vërehet se Neni 3 i Përbashkët për Konventat e Gjenevës dhe Protokollin II Shtesë ishin në fuqi në kohën e fakteve të pretenduara.<sup>6</sup>
25. Neni 3 i Përbashkët për Konventat e Gjenevës zbatohet në konfliktet e “karakterit jo-ndërkombëtar”. Konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare janë ballafaqime të armatosura që ndodhin brenda territorit të një Shteti të vetëm dhe në të cilin nuk janë të përfshira forca të armatosura të ndonjë Shteti tjetër kundër qeverisë qendrore.<sup>7</sup> Megjithatë, atëherë kur një Shtet i huaj ofron përkrahje ushtarake një grupi të armatosur që vepron kundër qeverisë, konflikti merr karakter të ndërkombëtar.<sup>8</sup> Në këtë rast, bombardimet e NATO-s të caqeve ushtarake serbe kanë filluar më 24 mars 1999<sup>9</sup>. Varësisht nga çështja e pragut (shih më poshtë), deri në atë moment, konflikti në mes të forcave të Qeverisë Serbe dhe UÇK-së përbënte konflikt të karakterit jo-ndërkombëtar. Pas atij momenti, konflikti mund të ketë marrë karakter të Konfliktit të Armatosur Ndërkombëtar, ndonëse me asgjë në këtë lëndë nuk kërkohet që të vërtetohet njëra apo tjetra.
26. Në mënyrë që të arrihet niveli i “konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar”, duhet të arrihet një prag minimal. Ndonëse Neni 3 i Përbashkët thjesht kërkon që konflikti i armatosur të mos jetë i “karakterit ndërkombëtar” dhe të ndodh në “territorin e njëres nga Palët e Larta Kontraktuese” (të dy kushtet janë përmbushur në rastin konkret), nën Protokollin II Shtesë aplikohet prag më i lartë. PShII aplikohet vetëm në konfliktet në mes të forcave të armatosura të Palës së Lartë Kontraktuese dhe “forcave të armatosura disidente apo grupeve të tjera të armatosura të cilat, nën komandë të përgjegjshme ushtrojnë kontroll të atillë mbi një pjesë të territorit sa që kjo u mundëson atyre të kryejnë operacione ushtarake të pandërprera dhe të bashkërenduara.”<sup>10</sup> Prokuroria ka pohuar, dhe nuk ka pasur argument kundërshtues nga mbrojtja në rastin konkret, se kushtet e pragut më të lartë të PShII janë përmbushur. Në të vërtetë, ishte pohuar edhe nga mbrojtja se UÇK-ja ishte përfshirë në një konflikt të tillë të armatosur. Sipas aktakuzës, krimet e pretenduara janë kryer


<sup>6</sup> Vendim i Gjykatës Supreme i datës 21 korrik 2005 në *Latif Gashi et al.*, f6.

<sup>7</sup> Doracak mbi Ligjin e Konfliktit të Armatosur Jo-Ndërkombëtar, me komentare, *Instituti Ndërkombëtar i Ligjit Humanitar*, mars 2006, f2.

<sup>8</sup> *Ibid*, p2.

<sup>9</sup> Shih [http://nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49602.htm](http://nato.int/cps/en/natolive/topics_49602.htm).

<sup>10</sup> *Ibid*, p3.



në periudhën kohore në mes të prillit dhe mesit të qershorit 1999. Ekzistimi i konfliktit të armatosur në mes të forcave serbe dhe UÇK-së në periudhën relevante është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës në Vendimin e datës 5 gusht 2004 në rastin Kolasinac. Konstatimi është konfirmuar në Vendimin e Gjykatës Supreme të datës 21 korrik 2005 në rastin Latif Gashi et al., f. 9-11. Vendimi i dytë po ashtu ka gjetur se struktura organizative e UÇK-së ka përmbushur kriteret e lartpërmendura nën Protokollin II Shtesë. Me rëndësi të veçantë për rastin aktual është konstatimi se “vetë fakti se UÇK-ja ndalonte civil Kosovar të dyshuar për sjellje armiqësore ndaj qëllimeve të UÇK-së reflekton shkallën e kontrollit të tyre mbi një pjesë të territorit” (shih Vendimin e Gjykatës Supreme të datës 21 korrik 2005 në Latif Gashi et al., f. 10).

27. Trupi gjykues nuk heziton të konkludojë se kushti precedent i Nenit 3 të Përbashkët dhe Protokollit II Shtesë është përmbushur dhe ato dispozita ishin përfshirë në fazën e konfliktit jo-ndërkombëtar të armatosur të luftës në Kosovë. Neni 3 i Përbashkët dhe PShII paraqet të gjitha obligimet që zbatohen për palë në konflikte të tilla dhe, ajo që është e rëndësishme kritike, këto obligime zbatohen automatikisht dhe pa ndonjë kusht të reciprocitetit.<sup>11</sup> Po ashtu, duhet të vërehet se përdorimi i frazës ‘secila Palë në konflikt’ qartë tregon se Neni nuk ka pasur për qëllim të jetë i kufizuar për PLK por zbatohet për të gjithë pjesëmarrësit në konfliktin e armatosur.
28. Shtrohet pyetja, a ka ndryshuar statusi apo zbatueshmëria e Nenit 3 të Përbashkët dhe Protokollit II Shtesë kur konflikti është bërë konflikt i armatosur ndërkombëtar pas fillimit të bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999? Përgjigjja e shkurtë është jo. Pavarësisht nga gjuha e Nenit 3 të Përbashkët që thotë se zbatohet në rastet e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar, në dy mënyra të rëndësishme, thelbi i tekstit duhet të konsiderohet që zbatohet për të gjitha konfliktet e armatosura të çdo përshkrimi, përfshirë ato ndërkombëtare. Meqë ndalesat absolute të Nenit 3 të Përbashkët është deklaruar të jenë ‘si minimum’ që duhet të zbatohen ‘në konfliktet më së paku të përcaktuara, kriteret e tij duhet *a fortiori* të respektohen në rastin e konflikteve tipike ndërkombëtare, kur të gjitha dispozitat e Konventës janë të zbatueshme. Pasi që, siç mund të thuhet, "obligimi i madh përfshin atë më të

<sup>11</sup> GC3 & GC4 Komentaret mbi Nenin 3 në <http://ëëë.icrc.org/ihl.nsf/COM/380-600006?OpenDocument>.




vogël".<sup>12</sup> Prandaj, pasoja e vetme që lufta në Kosovë të arrijë nivelin e “konflikt i armatosur ndërkombëtar” është që obligimet më të gjëra, të cilat vazhdojnë të përfshijnë Nenin 3 të Përbashkët dhe Protokollin II Shtesë, janë imponuar mbi palët ndërluftuese. Si rrjedhim, Trupi gjykues konkludon që sjellja e palëve gjatë tërë kohës relevante të përmendur në aktakuzën aktuale ka qenë e nënshtruar rregullave të Nenit 3 të Përbashkët dhe Protokollit II Shtesë, dhe sjellja e pretenduar, nëse dëshmohet, mund të arrijë nivelin e Krimeve të Luftës kundër popullatës civile në kundërshtim me Nenin 142 të KP RSFJ.


29. Por, çfarë ndikimi, nëse ka ndonjë, ka fakti që ngjarjet që pretendohet se përbëjnë veprat e ngarkuara penale kanë ndodhur tërësisht brenda territorit të Shqipërisë, e cila në asnjë fazë nuk ka qenë palë në konflikt? A ndikon ky fakt në jurisdiksonin e gjykatës për të gjykuar rastin, apo, nëse gjykata mund të gjykojë rastin pas klasifikimit të veprës penale që përbën sjellja e pretenduar?
30. Neni 9 i STATUTIT TË TPNJ i Kompetencës Bashkegzistuese:
1. Tribunali Ndërkombëtar dhe gjykatat vendore kanë kompetenca bashkegzistuese të ndjekin persona për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Jugosllavisë që nga 1 janari 1991.
  2. Tribunali Ndërkombëtar ka parësi ndaj gjykatave vendore. Në çdo fazë të procedurës, Tribunali Ndërkombëtar mund të kërkojë zyrtarisht që gjykatat vendore t'i nënshtrohet kompetencës së Tribunalit Ndërkombëtar në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar aktual.
31. Nuk ka pasur kërkesë nga TPNJ në pajtim me Nenin 142(2) për të marrë përsipër këtë rast.
32. Ligji mbi PSRK Neni 5.1(f) i jep PSRK-së kompetencë të veçantë mbi krimet që shkelin Nenin 3 të Përbashkët, KPK Neni 120.

---

<sup>12</sup> *Ibid.*



33. Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë Neni 3 qartë parasheh që Gjykatësit e EULEX-it kanë kompetencë mbi çdo lëndë të ndjekur nga PSRK.
34. Kompetenca e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Kjo gjykatë nuk është jurisdiksion ad hoc dhe jurisdiksioni vendor nuk ka mandat të kufizuar. Sipas Nenit 23(1)(i) të KPPK, gjykatat e qarkut kanë kompetencën të shqyrtojnë rastet penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon caktimin e dënimit penal prej së paku pesë vitesh. Kjo përfshin çështjet për të cilat të pandehurit janë akuzuar në këtë aktakuzë.
35. Neni 22 kombinuar me Nenin 142 të KP RSFJ, reflektuar në Nenet 23 dhe 120 të KPK, i jep jurisdiksion Gjykatës së nivelit të Qarkut për të gjykuar Krimet e Luftës kundër popullatës civile.
36. Neni 106 i KP RSFJ, reflektuar në Nenin 101(2) të KPK, zgjeron këtë kompetencë për të përfshirë veprat penale që janë kryer jashtë shtetit nga ana e qytetarëve të RSFJ-së (që domosdoshmërisht përfshin territorin e Shqipërisë) dhe prandaj i jep Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë kompetencë/juridiksion të gjykojë krimet e luftës që pretendohet se janë kryer nga Sabit Geci, Riza Alija dhe të bashkë-pandehurit e tjerë.
37. I kthehem çështjes së vendndodhjes gjeografike në kuptim të klasifikimit të sjelljes së pretenduar që përbën krim lufte.
38. Janë shqyrtuar dhe marrë parasysh vendime të ndryshme të TPNJ përfshirë: *Tadic*, *Blaskic*, *Kunarac* dhe *Kovac & Vasiljevic*. Asnjë nga këto vendime nuk janë konsultuar për të trajtuar rrethanat e sakta në rastin Geci, përkatësisht ndikimin në juridiksion dhe cilësim të aktivitetit të pretenduar kriminal që ka pasur kalimi i kufirit ndërkombëtar në shtetin e tretë. Pra, për një çështje të tillë, në bazë të informacioneve që ka gjykata, nuk është gjykuar në të kaluarën.
39. Në *Tadic*, Trupi gjykues për ankesa ka deklaruar se “Ligji ndërkombëtar humanitar rregullon sjelljen edhe të konflikteve të armatosura të brendshme edhe të atyre ndërkombëtare. Pala ankuese me të drejtë thekson se, në mënyrë që të ekzistojë shkelje e këtij korpusi ligjor duhet të ekzistojë konflikti i armatosur. Definicioni



"konflikt i armatosur" ndryshon varësisht nga fakti nëse armiqësitë janë ndërkombëtare apo të brendshme, por, ndryshe nga pretendimi i Palës ankuese, parametri kohor dhe gjeografik i konflikteve të armatosura të brendshme dhe ndërkombëtare shkon përtej kohës dhe vendit të saktë të armiqësive."<sup>13</sup> Siç e qartëson edhe aktgjykimi *Tadic*, edhe Konventat e Gjenevës edhe Protokollat Shtesë, në disa dispozita të caktuara kyçe, veçanërisht ato lidhur me mbrojtjen e civilëve, zbatohen në tërë territorin e palëve. Në veçanti, lidhur me civilët që kanë qenë të ndaluar "për arsye të lidhura me një konflikt të tillë",<sup>14</sup> Trupi gjykues për ankesa në *Tadic* ka deklaruar se "natyra relativisht e lirë e gjuhës "për arsye të lidhura me një konflikt të tillë", sugjeron një sferë të gjerë gjeografike. Lidhja e nevojshme është vetëm raporti në mes të konfliktit dhe privimit të lirisë."<sup>15</sup> Trupi gjykues për ankesa në *Tadic* ka konkluduar se "konflikti i armatosur ekziston kurdoherë kur përdoret forca e armatosur në mes të Shteteve apo dhunë e vazhdueshme e armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose në mes të grupeve të tilla brenda një Shteti. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet që nga fillimi i konflikteve të tilla të armatosura dhe vazhdon përtej ndërprerjes së armiqësive derisa të arrihet një paqe e përgjithshme; apo, në rast të konflikteve të brendshme, derisa të arrihet një marrëveshje paqësore. Deri në atë moment, e drejta ndërkombëtare humanitare vazhdon të jetë e zbatueshme në tërë territorin e Shteteve ndërluftuese apo, në rastet e konflikteve të brendshme, në tërë territorin nën kontroll të palës, pavarësisht nëse aty zhvillohen luftime apo jo."<sup>16</sup>

40. Rasti *Blaskic*<sup>17</sup> nuk i ka shtuar asgjë domethënëse parimeve të paraqitura në *Tadic*, por thjesht ka ri-konfirmuar nevojën për nexus/lidhje mbi nevojën për lidhjen gjeografike dhe kohore me luftimet.

“Nexus/Lidhja në mes të krimeve që u ngarkohen të akuzuarve dhe konfliktit të armatosur

69. Përpos ekzistimit të konfliktit të armatosur, është e domosdoshme të gjendet një nexus/lidhje e qartë në mes të krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur si

<sup>13</sup> *Tadic*, Vendimi mbi kërkesën e mbrojtjes për Ankesën e Ndërmjetme mbi Jurisdiksion, në para 67.

<sup>14</sup> Protokollit Shtesë II, Neni 2 para 2.

<sup>15</sup> *Tadic*, para 69.

<sup>16</sup> *Tadic*, para 70.

<sup>17</sup> *Blaskic*, IT-95-14-T, 3 mars 2000.



tërësi. Kjo nuk do të thotë se të gjitha krimet duhet të jenë të kryera në rajonin e saktë gjeografik ku ndodh konflikti i armatosur në një moment të caktuar. Për të treguar se ekziston lidhja, është e mjaftueshme që krimet e pretenduara të jenë ngushtë të lidhura me armiqësitë që ndodhin në pjesët e tjera të territorit të kontrolluara nga palët në konflikt.

70. Vërejtjet paraprake demonstrojnë se nuk është e domosdoshme që një komunë e caktuar të jetë pre e ballafaqimeve të armatosura në mënyrë që standardet e Ligjit ndërkombëtar humanitar të jenë të zbatueshme. Po ashtu është e përshtatshme të konstatohet se, siç kanë bërë edhe Aktgjykimet *Tadic dhe Celebici*, nuk është e domosdoshme që krimi të jetë pjesë e politikës apo praktikës zyrtarisht të përkrahur apo toleruar nga njëra palë në konflikt, apo që akti të jetë në fakt mbështetje e politikës së lidhur me zhvillimin e luftës apo në interes të palës në konflikt.

71. Lidhur me Nenin 5 të Statutit në veçanti, kriteret e këtij Neni, Aktgjykimi i Trupit gjykues për ankesa në *Tadic*, Vendimi i Trupit gjykues që ka shqyrtuar rastin *Tadic* dhe deklaratat e përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara, Francës, Britanisë së Madhe dhe Federatës Ruse në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të gjitha theksojnë se krimet kundër njerëzimit duhet të jenë të kryera gjatë konfliktit të armatosur. Pra, nëse vepra e kryerësit përpunohet në kontekstin gjeografik dhe kohor të konfliktit, nuk është e domosdoshme që ai të ketë për qëllim të marrë pjesë aktivisht në konfliktin e armatosur.”<sup>18</sup>


41. Çështja e njëjtë është përsëritur në rastin *Kunarac dhe të tjerët*<sup>19</sup> dhe në *Vasiljevic*.<sup>20</sup> Po ashtu ia vlen të vërehet se lidhur me fjalën territor, lëndët, përderisa shprehimisht kanë shqyrtuar incidentet që kanë ndodhur brenda kufijve të njëjtë territorial sikur luftimet, konstatojnë se ligjet e luftës janë të zbatueshme dhe vazhdojnë të zbatohen “për tërë territorin nën kontroll të njërit nga palët në konflikt.”<sup>21</sup> Një “territor” i tillë nuk mund dhe nuk do të thotë kufij politik apo kufij territorial shtetëror/kombëtar. Mund vetëm të kuptohet se do të thotë vendet e caktuara në të cilat njëra nga palët ndërluftuese ka kontroll thelbësor dhe real, pavarësisht se ku është ky vend. Në kontekstin e rastit konkret, ajo duhet dhe përfshin baza ushtarake të UÇK-së në Shqipëri, funksionale dhe të sistemuara, të cilat janë themeluar dhe përdorur nga

<sup>18</sup> *Blaskic*, para 69-71.

<sup>19</sup> *Kunarac*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, para 57.

<sup>20</sup> *Vasiljevic*, IT-98-32-T, para 25.

<sup>21</sup> *Tadic*, paras 68-70; *Vasiljevic*, para 25; *Kunarac*, para 57.




UÇK-ja si baza ushtarake logjistike, baza për stërvitje, shtab i përgjithshëm, baza prej nga kanë filluar operacionet ushtarake dhe si qendra ndalimi për të ndaluarit që ishin ndaluar vetëm për arsye të lidhura me luftën. Është e qartë se kjo përbën “territor nën kontroll të njërës nga palët në konflikt.” Përcaktimi ndryshe, do të thotë lejim i një boshllëku ligjor të tërë teknik dhe të pajustificueshëm nga mbrojtja e Konventave dhe Protokolleve, sipas së cilit, thjesht duke kaluar kufirin, por duke qëndruar në territorin i cili ishte nën kontroll të njërës Palë në konflikt përsa u përket gjithë aspekteve të tjera, kjo palë u shmanget tërësisht detyrimeve të saj sipas Ligjit Humanitar Ndërkombëtar. Kjo nuk është as në frymën e as në formulimin e ligjit. Përfundimi ynë përforcohet përmes kritereve të Komentareve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKQ) mbi Nenin 3, në përgjithësi dhe Nenin 3, nën-paragrafët (1) dhe (2) “shkalla e obligimit”. Kjo e bën të qartë se Neni 3 përfaqëson “minimumin e obligimit” të zbatueshëm edhe për konfliktet e brendshme edhe ato ndërkombëtare dhe se veprimet e ndaluara me Nenin 3 “janë dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend kudo qofte [theksim i shtuar]” dhe prandaj “nuk është lejuar asnjë boshllëk ligjor i mundshëm; nuk mund të ketë asnjë arsyetim, asnjë rrethanë lehtësuese.”<sup>22</sup> Të shmanget përgjegjësia penale sepse Pala e ka kaluar kufirin vetëm për disa kilometra në territorin politik të shtetit fqinj por ka kryer veprime brenda territorit qartësisht nën kontroll të palës në konflikt siç është kampi ushtarak i UÇK-së do të përbënte boshllëkun ligjor më teknik dhe më të pajustificueshëm të cilin Neni 3 i Përbashkët ka pasur për qëllim të parandalojë.

42. Parimet thelbësore që mund të rrjedhin nga këto raste janë si në vijim:

1. Konflikti i armatosur ekziston kurdoherë kur ka përdorim të forcës së armatosur në mes të shteteve apo dhunë të vazhdueshme të armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose në mes të grupeve të tilla brenda një shteti. Nuk ka ndonjë kundërshtim të fortë nga mbrojtja ndaj pohimit se në kohën relevante ka pasur konflikt të brendshëm të armatosur në Kosovë.

2. Neni 3 i Përbashkët, kur zbatohet për civilët në veçanti (GC4), duhet të interpretohet në mënyrën më të gjerë të mundshme në të dy aspektet, edhe kohore

<sup>22</sup> Komentaret e KNKQ, Neni 3, nënparagrafët (1) & (2) “Shkalla e obligimit”.



edhe gjeografike, meqë po të veprohet ndryshe do të thotë të shkohet kundër qëllimit të këtyre dispozitave. Pra, nuk është e domosdoshme që të dëshmohet se konflikti i armatosur brenda një shteti ka ekzistuar në secilën komunë, mjafton që ka ekzistuar brenda një rajoni më të madh ku kanë ekzistuar komunat, me fjalë të tjera në tërë shtetin. Duhet të vërehet se në asnjë nga këto raste nuk është kërkuar shprehimisht nga TPNJ që të përcaktojë situatën ku ka ndodhur sjellja e pretenduar përtej kufirit ndërkombëtar në shtetin e tretë. Meqë TPNJ nuk ka shqyrtuar shprehimisht një situatë të tillë, mund të konsiderohet se asgjë në aktgjykimet e cituara nuk përjashton një situatë të tillë.

3. Ajo çfarë nevojitet është nexus/lidhja në mes të pandehurit, viktimës, sjelljes së pretenduar kriminale dhe konfliktit të armatosur dhe se sjellja e pretenduar ka ndodhur në territorin nën kontroll të njëres nga Palët në konflikt. Sa i përket fakteve të pretenduara të lëndës, thuhet se të pandehurit janë sjellë në mënyrën e pretenduar për shkak të anëtarësisë së tyre në UÇK, se viktimat janë përzgjedhur për trajtimin e pretenduar për shkak të besimeve apo simpativë të tyre lidhur me konfliktin e armatosur që ndodhte në atë kohë dhe se sjellja e pretenduar është shkaktuar për shkak të këtyre simpativë. Në çdo rast, sjellja e pretenduar ka ndodhur brenda kampeve të UÇK-së në Kukës dhe Cahan. Nuk ka fare dyshim se këto bien nën territorin nën kontroll të qartë të palës në konflikt, domethënë UÇK-së. Me fjalë të tjera, pretendohet lidhje e qartë në mes të të pandehurve, viktimave, sjelljes, trajtimit dhe kontrollit territorial. Asgjë në asnjërin nga rastet e cituara nuk parandalon që kjo të arrijë nivelin e krimit të luftës vetëm për shkak se vendndodhja gjeografike e ngjarjeve ishte në Shqipëri. Asgjë në sjelljen e pretenduar nuk privon këtë Gjykatë nga juridiksioni vetëm pse vendndodhja gjeografike e ngjarjeve është në Shqipëri.

43. Pra, për Trupin Gjykes është e qartë se ka juridiksion dhe kompetencë të gjykojë lëndë që përfshijnë persona me shtetësi të mëparshme Jugosllave dhe tani me shtetësi Kosovare për vepra të cilat kanë ndodhur jashtë territorit të Kosovës ku veprat e pretenduara përbëjnë sjellje kriminale brenda Kosovës dhe se veprat penale të veçanta të pretenduara në aktakuzën aktuale, nëse veprat në fakt provohen, mund të klasifikohen si krime lufte, pavarësisht faktit se krimet e tilla kanë ndodhur brenda territorit të shtetit si palë e tretë Shqipërisë), e cila vetë nuk ishte palë në konflikt. Çfarëdo përfundimi tjetër do të shkonte kundër qëllimeve të qarta të Konventave të

Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë dhe do të ishte në kundërshtim me kodin penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i cili ka përparësi, kodit aktual penal të Kosovës, formulimit të saktë dhe frymës së Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë dhe kundër çdo arsyeje të shëndoshë.

44. Gjatë kohës në fjalë ekzistonte edhe konflikt i armatosur i brendshëm edhe ndërkombëtar, në të cilin UÇK-ja ishte e angazhuar në një luftë çlirimtare kundër forcave të rregullta dhe jo të rregullta serbe, i atillë që përfshin dispozitat e Nenit 3 të Përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949, & Nenit 4 & 5(1) të PShII të vitit 1977.
45. UÇK-ja kishte themeluar dhe mbajtur kampe brenda Shqipërisë, në Kukës dhe Cahan. Këto kampe janë përdorë për një mori qëllimesh duke përfshirë logjistikën, strehimin tranzitor për ushtarë në rrugë e sipër për në luftime, stërvitje, administratë, shtab dhe objekt ndalimi në të cilin shqiptarët etnik nga Kosova që dyshoheshin për bashkëpunim me forcat serbe ndaloheshin, merreshin në pyetje dhe keqtrajtoheshin.
46. Pavarësisht vendndodhjes fizike të këtyre kampeve brenda territorit të Shqipërisë, ka ekzistuar një lidhje e qartë në mes të UÇK-së, viktimave të ndalimit dhe konfliktit të armatosur brenda Kosovës, që do të thotë se kjo është e mjaftueshme që veprat e tilla kriminale të cilësohen si krime lufte nëse vërtetohen si të tilla brenda kuptimit të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar.

### III. PËRMBLEDHJE E PROVAVE TË PREZANTUARA

47. Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:
  - (1) Dëshmitari B – 16, 21, 23 & 24 mars 2011
  - (2) Dëshmitari F – 24 & 28 mars 2011
  - (3) Dëshmitari H – 31 mars & 04 prill 2011
  - (4) ██████████ – 06 prill 2011
  - (5) Dëshmitari E – 07 prill 2011
  - (6) Dëshmitari D – 07 prill 2011
  - (7) ██████████ – 04 & 05 maj 2011
  - (8) Dëshmitari K – 16 maj 2011




- (9) Dëshmitari M – 19 maj 2011
- (10) Dëshmitari N – 23 & 25 maj 2011
- (11) ██████████ – 02 qershor 2011
- (12) ██████████ – 02 qershor 2011
- (13) ██████████ – 08 qershor 2011
- (14) ██████████ – 08 qershor 2011
- (15) Dëshmitari A – 09 & 10 qershor 2011
- (16) ██████████ – 20 qershor 2011


48. Më 20 korrik 2011, të katër të pandehurit kanë zgjedhur të qëndrojnë në heshtje dhe pranë deklaratave të tyre të mëhershme.

49. Gjatë shqyrtimit kryesor dokumentet në vijim janë lexuar për procesverbal:

- (1) Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori i dëshmitarit C i datës 17 dhjetor 2009 – pranuar më 07 prill 2011.
- (2) Raport i Njësisë Hetimore për Krime të Luftës e Policisë (NjHKL) së EULEX-it mbi Deklaratën e marrjes në pyetje të Dëshmitarit C i datës 09 prill 2009 – pranuar më 07 prill 2011.
- (3) Raport i EULEX-it mbi Procedurën e foto-identifikimit (Dëshmitari C) i datës 17 dhjetor 2009 – pranuar më 07 prill 2011.
- (4) Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G) i datës 04 mars 2011, pranuar më 28 prill 2011.
- (5) Vërtetim mjekësor i Qendrës Universitare Spitalore Ushtarake në Tiranë lidhur me shtrimin në spital të Sabit Gecit prej 03-14 qershor 1999 – pranuar më 20 korrik 2011.
- (6) Raport mbi incidentin i Prokurorit Publik të Qarkut (Republika e Shqipërisë), PP nr. 876/99 (lidhur me aksidentin e Sabit Gecit me makinë) – dorëzuar nga Sabit Geci më 20 korrik 2011.
- (7) Dokument i nënshkruar nga Azem Sylja që mban edhe vulë zyrtare (lidhur me aktivitetet e aktiviteve të Riza Alijajt – dorëzuar nga Alija dhe avokati mbrojtës Kollqaku më 20 korrik 2011.
- (8) Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari F) i datës 16 dhjetor 2009.



- (9) Raport i NjHKL së Policisë së EULEX-it mbi Deklaratën e marrjes në pyetje të Dëshmitarit F i datës 24 qershor 2009.
- (10) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedure e foto identifikimit (Dëshmitari F) i datës 03 dhjetor 2009.
- (11) Raport i zyrtarit Victor Odom i datës 06 maj 2010.
- (12) Raport i Policisë së EULEX-it nga Francesco Duminuco i datës 06 maj 2010 me dëftesë të konfiskimit të përkohshëm të artikujve.
- (13) Raport i zyrtarit të Raport të NjHKL të EULEX-itnga Antonio Rocha i datës 15 maj 2010.
- (14) Raport i zyrtarit të NjHKL të EULEX-it nga Claudio Scipione i datës 15 maj 2010.
- (15) Përshkrim i hollësishëm i EULEX-it të artikujve të konfiskuar më 06 maj 2010 nga Sabit Geci dhe më 13 maj 2010 nga Xhemshit Krasniqi.
- (16) EULEX Memo: Verifikim i autorizimit për armën nga Victor Tenovici i datës 25 maj 2010.
- (17) Verifikim i databazës së PK mbi autorizimin për armën nga nënkolonel Zylfije Krasniqi i datës 03 qershor 2010.
- (18) Raport i NjHKL i EULEX-it mbi bastisjen e personit, vendit të banimit dhe hapësirave të tjera (lidhur me bastisjen e shtëpisë së Riza Alijat) nga Victor Odom i datës 23 qershor 2010.
- (19) Raport i Policisë së EULEX-it (lidhur me bastisjen e shtëpisë së Riza Alijat) nga Claudio Scipione i datës 23 qershor 2010.
- (20) Raport i NjHKL i EULEX-it mbi bastisjen e personit, vendit të banimit dhe hapësirave të tjera (lidhur me bastisjen e shtëpisë së Riza Alijat) nga Claudio Scipione (pa datë).
- (21) Raport i zyrtarit të NjHKL të EULEX-it (lidhur me bastisjen e shtëpisë së Riza Alijat) nga Claudio Scipione i datës 24 qershor 2010.
- (22) Foto të bëra gjatë bastisjes së shtëpisë së Riza Alijat.
- (23) Procesverbal i PSRK nga dëgjimi i dëshmitarit ekspert gjatë hetimeve (Marek Gasior) i datës 02 mars 2011.
- (24) Raport i DML i ekzaminimit fizik të dëshmitarit B nga Dr. Marek Gasior i datës 02 mars 2011 me fotografitë shoqëruese.
- (25) Raport i Zyrës për Kontrollime Mjekësore të DML mbi ekzaminimin e dëshmitarit B i datës 10 nëntor 2010 me shtojcë.



- (26) Raport i DML i ekzaminimit fizik të dëshmitarit H nga Dr. Marek Gasior i datës 10 nëntor 2010 me shtojcë.
- (27) Raport i zyrtarit Jouni Voutila i datës 01 shkurt 2011 së bashku me një listë të pjesëtarëve të UÇK-së me bazë në Cahan dhe një tufë fotografish – të dorëzuara më 04 maj 2011.
- (28) Raport i autopsisë i ZPZHML MA09216 ( [REDACTED] ) nga Dr. Marek Gasior i datës 18 gusht 2009 me fotografi.
- (29) Policia e Czech Republic, Instituti i Kriminologjisë Prague, Ekzaminim i ekspertit i datës 22 dhjetor 2009.
- (30) Listë e imigrantëve të vdekur nga Kosova, Komuna e Kukësit (28 mars 1999 deri 17 qershor 1999) në mbështjellësin e PSRK pp. B80-B84.
- (31) Raportet e ekspertizave mbi armët e zjarrit në mbështjellësin e PSRK pp. B52-B73.
- (32) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto identifikimit (Dëshmitari A) i datës 27 tetor 2009.
- (33) Fotografi e dëshmitarit A dhe viktimës [REDACTED] në mbështjellësin e PSRK p. C247.
- (34) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto identifikimit (Dëshmitari B) i datës 23 tetor 2009.
- (35) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto identifikimit (Dëshmitari B) i datës 01 prill 2010.
- (36) Raport i NjHKL së EULEX-it: Deklaratë nga marrja në pyetje e Dëshmitarit/Viktimës (Dëshmitarët D dhe E) i datës 22 prill 2009.
- (37) Raport lidhur me ftesat e gjykatës të dorëzuara dhe epizodi lidhur me [REDACTED], nga Claudio Scipione i datës 06 mars 2010.
- (38) Procedurë e foto-identifikimit (Dëshmitari G) i datës 04 mars 2010.
- (39) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto-identifikimit ( [REDACTED] ) nga Jouni Voutila i datës 16 qershor 2010.
- (40) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto-identifikimit ( [REDACTED] ) nga Jouni Voutila i datës 14 qershor 2010.
- (41) Artikuj të gazetave shkruar nga [REDACTED] dhe raportet relevante në mbështjellësin e dosjes të SPRK pp. D245-D253.
- (42) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto-identifikimit (Dëshmitari M) i datës 18 qershor 2010.



- (43) Raport i NjHKL së EULEX-it mbi procedurën e foto-identifikimit (Dëshmitari N) i datës 17 janar 2011.
- (44) Procesverbal i PSRK nga dëgjimi i dëshmiatrit gjatë hetimeve paraprake dhe procedura e foto-identifikimit (Dëshmitari N) i datës 02 dhjetor 2010.
- (45) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve (Riza Alija) i datës 23 qershor 2010.
- (46) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve (Riza Alija) i datës 28 korrik 2010.
- (47) Fotot e referuara gjatë intervistës së Riza Aliajt më 28 korrik 2010.
- (48) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve (Sabit Geci) i datës 06 maj 2010.
- (49) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve (Sabit Geci) i datës 10 maj 2010.
- (50) Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Haki Hajdari) i datës 15 qershor 2010.
- (51) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve në prokurori (Haki Hajdari) i datës 15 dhjetor 2010.
- (52) Procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimeve në prokurori (Shaban Hoti) i datës 18 shkurt 2011.

#### **IV. BESUESHMËRIA E DËSHMITARIT**

50. Trupi Gjykues mori parasysh faktin se ngjarjet e përshkruara kanë ndodhur para më shumë se dhjetë vitesh dhe dëshmitarët ishin të gjithë palë të dëmtuara të cilët kanë dëshmuar për detaje dhe ngjarje të cilat kanë ndodhur në një kohë kur secili po përjetonte traumatizëm të rëndë fizik, mendor dhe emocional. Si e tillë, është thjesht njerëzore dhe logjike se do të ketë disa mospërputhje të vogla mes dëshmimeve të dëshmitarëve, për shembull, lidhur me datën e saktë të një rrahje apo kohëzgjatja e saktë e një rrahje. Këto mospërputhje të vogla nuk i bëjnë gjithë dëshmitë të pabesueshme. Trupi Gjykues ka vlerësuar me kujdes tregimin e dhënë nga secili dëshmitar dhe dëshmitë mbështetëse dhe provat për këtë tregim, dhe ka gjetur se dëshmitarët ishin të besueshëm me përjashtimet në vijim.



51. Dëshmitari D dhe E janë [REDACTED]  
[REDACTED] Si të tillë, është e lehtë që këta të identifikohen në dëshmitë e të tjerëve kur ata flasin për dëshmitarin D dhe E. Në dëshminë e tyre, dëshmitari D dhe E janë përpjekur të paraqesin një pamje të një trajtimi të mirë në kampin e UÇK-së në Kukës ku ata kanë këmbëngulur se ishin vullnetarë dhe se nuk mbaheshin të ndaluar kundër vullnetit të tyre. Tregimi i tyre për trajtim të mirë, ushqim dhe ujë të përshtatshëm, punë vullnetare për UÇK-në dhe mungesa e rrahjeve apo formave të tjera të keqtrajtimit ishte tërësisht në mospërputhje me asnjërën nga provat nga burime të tjera lidhur me faktin sesi janë trajtuar dëshmitari D dhe E. Edhe burime të tjera e kanë bërë të qartë se dëshmitarët D dhe E nuk kanë qëndruar vullnetarisht në kampin e Kukësit por ata ishin të ndaluar siç ishin edhe dëshmitarë të tjerë. Për më tepër, tregimi i dhënë nga dëshmitari D dhe E në gjykatë nuk ishte koherent në vetvete me sugjerimin e tyre se ata nuk ishin mbajtur të ndaluar kundër vullnetit të tyre. Për shembull, gjatë shkëmbimit në dhënien e dëshmisë në shqyrtimin kryesor lidhur me kujtesën e dëshmitarit D lidhur me një vdekje në Kukës, dëshmitari D ka përdorur fjalinë në vijim: “po, kemi kuptuar (për vdekjen) pasi jemi larguar nga burgu lidhur me atë që kishte ndodhur.”<sup>23</sup> Përdorimi i fjalës burg u bë pa u provokuar dhe në mënyrë vullnetare nga ana e dëshmitarit i cili më parë në tërë dëshminë tij kishte mohuar se ai ishte mbajtur i ndaluar kundër vullnetit të tij. Kur ai u ballafaqua nga kryetari i trupit gjykues lidhur me përdorimin e fjalës ‘burg’, dëshmitari D mohoi përsëri se ai kishte qenë në burg: “Jo, nuk kam qenë në burg. Kam qenë aty për të punuar dhe kam qenë i lirë.”<sup>24</sup> Dëshmitari D është ballafaquar gjithashtu me faktin se tre dëshmitarë të tjerë kishin dëshmuar lidhur me [REDACTED]  
[REDACTED], së bashku me [REDACTED], ishin rrahur, detyruar të punonin, kishin ardhur tek dhoma ku ishin të ndaluar dëshmitarët e tjerë dhe ishin ankuar se ishin rrahur. Dëshmitari D mohoi duke thënë se asgjë nga kjo nuk është vërtetë.<sup>25</sup> Dëshmitari D u sfidua nga Kryetari i Trupit Gjykues lidhur me dëshminë e tij se edhe pse ai nuk ishte në burg dhe ishte i lirë të largohej, ai nuk u largua sepse kishte frikë të bënte një gjë të tillë. Dëshmitari D u përgjigj se “Nuk kishim ku të shkonim dhe nuk kishim asgjë për të ngrënë. Nuk kishim asgjë dhe ishim të detyruar të qëndronim aty.” Kur ai u sfidua lidhur me përdorimin e fjalës ‘i detyruar’ dhe nga kush,

<sup>23</sup> Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P205.

<sup>24</sup> Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P220.

<sup>25</sup> Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P222-230.




dëshmitari D u përgjigj 'nga askush. Ne thjesht vetë kemi qëndruar aty.'<sup>26</sup> Trupi Gjykues nuk ka absolutisht asnjë hezitim në refuzimin e dëshmimeve të dëshmitarit D dhe E si të pasakta dhe të pavërteta. Atyre nuk u jepet peshë dhe nuk konsiderohet se dëshmia e tyre minon apo zvogëlon dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të cilat janë pranuar.

52. Dëshmitari C nuk ka mundur të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor. Pasi që Kryetari i Trupit Gjykues u konsultua me të gjitha palët, përfshirë secilin avokat mbrojtës dhe secilin prej të pandehurve, palët u pajtuan se deklarata e dëshmitarit C mund të lexohej në procesverbal.<sup>27</sup> Është e qartë nga procesverbali i marrjes së saj në pyetje se dëshmitarja C nuk ka dashur të kujtojë në detaje ngjarjet traumatike dhe është përpjekur të distancohet sa më shumë që është e mundur nga këto kujtime. Në një analizë të gjerë, tregimi i saj përputhej me tregimin e përgjithshëm të dhënë nga dëshmitarë të tjerë lidhur me keqtrajtimin, rrahjet dhe gjëra të tilla të ngjashme në kampin e Kukësit, edhe pse ajo nuk ishte plotësisht koherente përse u përket detajeve siç janë koha dhe datat. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se mbrojtja nuk ka pasur mundësi të marrë në pyetje dëshmitaren C. Për këtë arsye, trupi gjykues i ka dhënë deklaratave të saj një peshë të zvogëluar të duhur. Asnjë i pandehur nuk është dënuar vetëm si rezultat i dëshmisë së dëshmitares C e cila duhet të kuptohet vetëm si mbështetje e përgjithshme e tregimeve të dhëna nga dëshmitarë të tjerë në këtë lëndë.
53. Dëshmia e dëshmitarit K është trajtuar me kujdes nga Trupi Gjykues. Ai ka kaluar kohë në kampin e Kukësit dhe atë të Cahanit. Në përgjithësi ai mbështet në një mënyrë praninë e dëshmitarëve të tjerë në kohën dhe vendin që kanë deklaruar ata dëshmitarë të tjerë dhe për përdorim dhune të caktuar. Por, duhet gjithashtu të konstatohet se dëshmitari K nuk pohon ekzistimin e kushteve të ndalimit kaq të rënda apo keqtrajtim siç bëjnë dëshmitarë të tjerë në këtë lëndë. Më tej, përse i përket çështjes specifike të dëgjimit të të shtënave në Kukës (ngjarja që ka çuar në vdekjen e [REDACTED]), dëshmitari K në dëshminë e tij të dhënë me gojë mohoi të ketë dëgjuar këto të shtëna dhe kur ai u ballafaqua me deklaratat e tij të mëparshme kundërthënëse, përgjigjet e tij ishin ekuivoqe dhe sipas mendimit të trupit gjykues, evazive. Mund të jetë që në fakt dëshmitari K është trajtuar më mirë se dëshmitarë të

<sup>26</sup> Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P239-242.

<sup>27</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, fq34.




tjerë dhe për këtë arsye ai jep një tregim që është më pak intensiv sesa ai i dhënë nga dëshmitarë të tjerë, apo, mund të jetë që dëshmitari K ishte një dëshmitar ngurrues dhe më evaziv se dëshmitarë të tjerë. Për këtë arsye Trupi Gjykses arrin në përfundimin se pesha që duhet ti jepet dëshmitarit K është e zvogëluar në masë të madhe. Dëshmia e tij ku ai mbështet dëshmitarë të tjerë merret parasysh. Nuk ka prova të drejtpërdrejta nga dëshmitari K që cilat mund të minojnë rrënjësisht dëshmitarë të tjerë.

## V. VLERËSIMI I PROVAVE: Gjetjet Faktike

54. Bazuar në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor, Gjykata konsideron si të vërtetuara faktet të cilat janë detajuar në këtë pjesë. Provat që mbështesin secilin fakt janë inkorporuar në përshkrimin e vetë faktit si dhe të shënuara në fusnotat.
55. Rrethanat e përgjithshme të pranishme në Kosovë në kohën relevante janë përshkruar në detaj më sipër. Për të bërë një përmbledhje, UÇK-ja dhe forcat serbe ishin angazhuar në një konflikt të armatosur të brendshëm dhe ndërkombëtar dhe UÇK-ja kishte vendosur kampe në Kukës dhe Cahan, Shqipëri, të cilët janë përdorur, *inter alia*, për të mbajtur të ndaluar dhe për të marrë në pyetje shqiptarë etnikë nga Kosova të dyshuar për bashkëpunim me forcat serbe.

### *Kampet e UÇK-së në Kukës, Shqipëri*

56. Në vitin 1999, UÇK-ja kishte kthyer një fabrikë në Kukës në kamp ushtarak. Në mënyra të ndryshme dhe në rrugë të ndryshme, të gjithë dëshmitarët janë larguar nga shtëpitë e tyre në Kosovë dhe kanë kaluar kufirin për në Shqipëri si rezultat i drejtpërdrejtë i konfliktit. Ndërsa disa kanë arritur vullnetarisht në kampin e UÇK-së, të tjerë janë sjellë aty të detyruar nga ushtarët e UÇK-së.
57. Në vitin 1999, dëshmitari A ishte duke punuar në [REDAKTUAR] kur familja e tij është larguar nga Kosova për shkak të luftës. Ai ishte rrugës për të vizituar familjen e tij në Shqipëri kur ai ka arritur në Durrës me anije nga Italia me datë 14 maj 1999. Në momentin e arritjes, një djalë i ri i është afruar dëshmitarit A, ka kërkuar të shohë pasaportën e tij dhe e ka shoqëruar atë tek një veturë që ishte duke pritur. Në makinë



gjendeshin dy burra të tjerë, njëri prej të cilëve është identifikuar dëshmitarit A nga pasagjerë të tjerë si “Haki Drenica”. Dëshmitari A është vendosur në makinë dhe fillimisht është dërguar diku në Kukës ku atij i janë bërë pyetje lidhur me mbështetjen e tij për luftën. Ai është mbajtur i ndaluar aty, i mbyllur me çelës në një dhomë me një roje, për rreth katër ditë dhe pastaj është dërguar me makinë në kampin e UÇK-së në Kukës.<sup>28</sup> Tregimi i dëshmitarit A mbështetet nga dëshmitari H në atë se gjatë kohës kur ai ishte i ndaluar dëshmitari A i ka treguar dëshmitarit H të njëjtën gjë që dëshmitari A tregon tani në gjykatë.<sup>29</sup>

58. Dëshmitari B [REDACTED] janë dëbuar nga [REDACTED] nga policia serbe në fillim të muajit maj.<sup>30</sup> Ata janë dërguar bashkë me dëshmitarin C në kufirin me Shqipërinë. Ata kanë kaluar kufirin dhe kanë udhëtuar vullnetarisht në Kukës ku kanë arritur me apo rreth datës 14 maj 1999.<sup>31</sup> Në Kukës, dëshmitari B dhe [REDACTED] kanë pasur për qëllim që të paraqiten në shtab të UÇK-së për të marrë uniforma dhe për tu mobilizuar. Ata janë dërguar në shtab të UÇK-së nga Refki Qenaj.<sup>32</sup>
59. Dëshmitari B, dëshmitari C dhe [REDACTED] kanë arritur në shtab, është dashur të presin për tu intervistuar dhe gjatë kësaj kohe ata janë vendosur në një depo ku UÇK-ja mbante uniforma dhe ushqim.<sup>33</sup> Ata janë mbajtur në depo për tre ditë,<sup>34</sup> të ruajtur nga një person me uniformë.<sup>35</sup> Pastaj ka arritur policia ushtarake e UÇK-së me shenjë dalluese në krah dhe me rrypa të bardhë. Ata i kanë lidhur duart dëshmitarit B, [REDACTED], dhe dëshmitarit C, dhe i arrestuan.<sup>36</sup> Ata janë mbajtur të ndaluar në depo edhe për 24 orë shtesë, me duar të lidhura dhe të ruajtur nga roje sigurie të

<sup>28</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P2-3, 10-32.

<sup>29</sup> Dëshmitari H, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 31 Mars 2011, P43-47.

<sup>30</sup> Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq3; Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq2.

<sup>31</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P1-3; 23 mars 2011, P8-14; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq3.


<sup>32</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor 16 March 2011, fq7-10; Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, Q6-9; Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq2-4.

<sup>33</sup> Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq3.

<sup>34</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 March 2011 p11; Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, fq8; Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, fq6.

<sup>35</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq4.

<sup>36</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq11; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq3.



armatosur.<sup>37</sup> Pastaj dëshmitari B [REDACTED] janë dërguar në një dhomë ndërsa dëshmitari C është dërguar në një dhomë tjetër.<sup>38</sup>

60. Dëshmitari D dhe dëshmitari E jetonin [REDACTED] në vitin 1999. Ata janë larguar nga Kosova për shkak të luftës dhe kanë kaluar kufirin për në Shqipëri. Në maj të vitit 1999, ata u arrestuan nga tre ushtarë të UÇK-së me uniforma nën pretendimin se ata ishin policë serbë. Dëshmitari D dhe dëshmitari E u intervistuan së bashku në shtab të UÇK-së në Kukës dhe u pyetën ndër të tjera nëse ishin oficerë të policisë.<sup>39</sup> Pastaj ata u dërguan në depo.<sup>40</sup>
61. Dëshmitari F punonte si [REDACTED] kur ai është larguar nga Kosova me familjen e tij. Ai ka arritur në Kukës rreth datës 28 apo 29 prill 1999. Ata qëndronin në një kamp refugjatësh kur një ditë, në mes të muajit maj, Xhemshit Krasniqi dhe një ushtar tjetër i UÇK-së kanë ardhur dhe i kanë thënë dëshmitarit F se ai duhej të dërgohej në shtab të UÇK-së për tu intervistuar.<sup>41</sup>
62. Dëshmitari G ishte [REDACTED] deri në vitin 1988. Ai ishte gjithashtu [REDACTED]. Në vitin 1999, dëshmitari G ishte i papunë dhe jetonte [REDACTED]. Kur filloi lufta ai u bë [REDACTED]. Me datë 11 maj 1999, i gjithë fshati u dëbua nga shtëpitë e tyre nga autoritetet e qeverisë serbe dhe së bashku kanë udhëtuar në Kukës, Shqipëri. Me ose rreth datës 15-17 maj 1999, në Kukës, Xhemshit Krasniqi dhe dy ushtarë të tjerë të UÇK-së, të veshur me uniforma të zeza kanë kërkuar me emër dëshmitarin G duke i thënë atij se ai duhej të vinte për një 'bisedë informative.' Ata e sollën atë në ish fabrikën në shtab të UÇK-së ku ushtarët e UÇK-së akuzuan dëshmitarin G se kishte dëbuar fshatarët nga shtëpitë e tyre, se kishte armë dhe se ishte mik dhe bashkëpunëtor i serbëve. Dëshmitari G u detyrua të shkruajë një deklaratë lidhur me këtë. Pas intervistës, ai u informua se duhej të qëndronte në kamp


<sup>37</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 12; 21 mars 2011, fq7-8; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq4.

<sup>38</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P16-17; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, p. 3.

<sup>39</sup> Dëshmitari E, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P41-49; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P181-189, 230-231.

<sup>40</sup> Dëshmitari E, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P4-33; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill, P109-141.

<sup>41</sup> Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P14-15, 22-28; 28 mars 2011, P43.



derisa UÇK-ja të mund të përfundonte hetimin ndaj tij dhe ai u dërgua në një dhomë tjetër.<sup>42</sup>

63. Dëshmitari H ishte i punësuar si [REDAKTUAR] 1999 kur ai u detyrua të dilte në pension nga autoritetet e qeverisë serbe.<sup>43</sup> Ai shkoi në Shqipëri. Me datë 18 maj 1999, dëshmitari H ishte në Durrës, Shqipëri, kur katër burra me uniforma të policisë ushtarake të UÇK-së e detyruan atë të hynte në makinë duke i drejtuar armën. Në fillim ata e dërguan atë në bunkerët ushtarakë në Ramanak dhe pastaj rreth datës 21 maj 1999 në kampin e UÇK-së në.<sup>44</sup> Në Durrës, ata e kishin detyruar atë të veshë një uniformë të zezë të policisë ushtarake të UÇK-së sepse djali i dëshmitarit H kishte lajmëruar rrëmbimin e tij në polici.<sup>45</sup> Dëshmitari H kishte akoma të veshur uniformën e zezë kur ai arriti në Kukës.<sup>46</sup>

#### ***Kushtet e Përgjithshme të Jetesës së të Ndaluarve në Kampin e UÇK-së në Kukës***

64. Dëshmitari A, Dëshmitari B, Dëshmitari C, Dëshmitari D, Dëshmitari E, Dëshmitari F, Dëshmitari G, Dëshmitari H dhe [REDAKTUAR] ishin të gjithë të ndaluar në kampin e UÇK-së në Kukës në tre vende të ndryshme, në kushtet në vijim.

#### ***Dëshmitari C Në Burgosje në Vetmi(Izolim)***

65. Kur Dëshmitarja C është nxjerrë nga depoja ajo është mbyllur me çelës në një dhomë të vogël rreth 2x2 metra. Dyshemeja ishte e pashtuar dhe brenda ishte një dyshek shumë i hollë por nuk kishte mobilje. Kishte një dritare me përmasa të një fletë A4 me hekura. Në dhomë nuk kishte ndriçim.<sup>47</sup>
66. Jashtë dhomës kishte roje. Ushqimi është siguruar një apo dy herë në ditë si dhe ujë. Dëshmitarja C nuk është lejuar asnjëherë të largohet nga dhoma për ushtrime dhe nuk

<sup>42</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 2-6.


<sup>43</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P156.

<sup>44</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P1-21.

<sup>45</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P40-41.

<sup>46</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P41.

<sup>47</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq. 6-7; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 April 2009, fq. 4; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P16-17.



i lejohej të dilte në ajër të pastër. Nga tualeti i cili gjendej shumë afër dhomës vinte erë e keqe. Dëshmitarja C duhej të kërkonte leje që të dërgohej në tualet nga rojet.<sup>48</sup>

67. Dëshmitarja C është mbajtur në këtë dhomë për rreth një muaj. Gjatë kësaj kohe, dëshmitarja C nuk është lejuar asnjëherë të lahet apo të pastrohet dhe nuk ka pasur rroba të pastra.<sup>49</sup>

*Dhoma e Improvizuar me Tavan të Ulët*

68. Kur Dëshmitari A është sjellë në kampin e Kukësit, në fillim ushtarët e UÇK-së i kanë mbajtur ata të ndaluar në një dhomë të vogël, me përmasa rreth 2 x 2 metra, ku ai është mbyllur me çelës dhe ruajtur me roje.<sup>50</sup> Brenda ishin dy batanije, dyshekë të vjetër sfungjeri dhe shishe të mbushura me urinë të lëna nga personat që kishin qenë aty më parë.<sup>51</sup>
69. Dëshmitari A është mbajtur i ndaluar vetëm në këtë dhomë për rreth 2-3 ditë, deri rreth mesnatës me apo rreth datës 20 maj 1999 kur dëshmitari H është sjellë në dhomë.<sup>52</sup> Kur arriti, dëshmitari H kishte akoma të veshur uniformën e zezë të policisë ushtarake të UÇK-së të cilën ai ishte detyruar të vishte në Durrës.<sup>53</sup>
70. Dhoma kishte tavan të ulët dhe aty brenda një person nuk mund të qëndronte drejt në këmbë.<sup>54</sup> Dëshmitari H ka përshkruar këtë dhomë si qeli burgu ‘e sajuar e rastit’ apo ‘e improvizuar’ me përmasa rreth 2.5x 2-3 metra.<sup>55</sup> Nuk kishte mobilje dhe nuk kishte

<sup>48</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq. 6-7; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq. 6-8.

<sup>49</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 dhjetor 2009, fq. 14-15; Raport mbi Procesverbalin e Marrjes në pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, fq. 6.

<sup>50</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P34-38; 10 qershor 2011, P37-39.


<sup>51</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P35.

<sup>52</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor 09 qershor 2011, P36-37, 41; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P18-27.

<sup>53</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P47; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P40-41.

<sup>54</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P37-38; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 March 2011, P26.

<sup>55</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P22-25.



rrymë.<sup>56</sup> Nuk kishte dritare.<sup>57</sup> Dëshmitari A dhe dëshmitari H kanë fjetur në këto sfungjerë të hollë në dysheme të shtruar me beton.<sup>58</sup>

71. Rreth tre ditë pasi që dëshmitari H ka arritur, dëshmitari A dhe dëshmitari H janë zhvendosur nga kjo dhomë e improvizuar në një dhomë tjetër ku dëshmitari B, dëshmitari D, dëshmitari E, dëshmitari E, dëshmitari F, dëshmitari G, [REDACTED] dhe një mashkull i panjohur Rom mbaheshin të ndaluar së bashku.<sup>59</sup>

### Dhoma Kryesore e Ndalimit

72. Dëshmitari A, dëshmitari B, dëshmitari D, dëshmitari E, dëshmitari F, dëshmitari G, dhe dëshmitari H janë mbajtur të gjithë në të njëjtën dhomë në periudha kohore kur ata ishin të gjithë të ndaluar në të njëjtën dhomë. Të gjithë këta dëshmitarë kanë mbështetur njëri tjetrin në tregimin e tyre lidhur me këtë dhomë ndalimi. Kushtet e jetesës gjatë ndalimit ishin të ashpra dhe të përshkruara nga dëshmitari H, të tilla sa “as kafshët apo shtazët nuk do të qëndronin aty.”<sup>60</sup>
73. Pasi që janë mbajtur të ndaluar fillimisht në depo për katër ditë, dëshmitari B dhe [REDACTED] janë dërguar në një dhomë bashkë me dëshmitarin D, dëshmitari E, dhe një mashkull të panjohur Rom.<sup>61</sup> Në një kohë më vonë, dëshmitari A, dëshmitari F, dëshmitari G dhe dëshmitari H janë sjellë gjithashtu në këtë dhomë.<sup>62</sup> Sepse, përveç dëshmitarëve, janë sjellë brenda dhe jashtë edhe njerëz të tjerë në periudha të njëjta

<sup>56</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P26-27 & 42.

<sup>57</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P41.


<sup>58</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P35; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P174-176.

<sup>59</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P82-89; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, P30-39; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P69-74.

<sup>60</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 April 2011, P82.

<sup>61</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 13; Dëshmitari E, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P95; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P171-172.

<sup>62</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P7-8; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, p. 13; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P66-68; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P2-26; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 7; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P69-74.



kohore; numri total i personave të ndaluar në dhomë gjatë një dite ka qenë mes shtatë dhe trembëdhjetë persona.<sup>63</sup>

74. Dhoma ishte jashtëzakonisht e vogël, veçanërisht duke pasur parasysh numrin e të ndaluarve të cilët mbaheshin aty së bashku. Përsa u përket numrave të vërtetë, është e njohur vështirësia për të përshkruar me saktësi masat dhe distancat. Ajo që është e rëndësishme dhe e qartë është se përshtypja e përgjithshme e dhomës ishte se ajo kishte një hapësirë të vogël dhe të kufizuar dhe shumë e mbipopulluar.<sup>64</sup> Dera e dhomës ishte e mbyllur me çelës.<sup>65</sup> Gjithashtu, të ndaluarit brenda nuk lejoheshin të flisnin me njëri tjetrin.<sup>66</sup>
75. Në dhomë nuk kishte asnjë mobilje dhe dyshemeja ishte prej betoni. Kishte 2 apo 3 dritare me shufra hekuri por pa xham.<sup>67</sup> Temperatura ishte “tmerrësisht nxehtë” brenda dhomës.<sup>68</sup> Disa të ndaluar, si dëshmitari A dhe dëshmitari B, kanë fjetur në dyshemenë prej betoni, ndërsa të tjerë si dëshmitari H kishin një sfungjer 2 cm të trashë.<sup>69</sup> Dëshmitari G dhe dëshmitari F kanë fjetur në thasë gjumi.<sup>70</sup> Pasi që kanë fjetur në dyshemenë prej betoni për rreth një javë, disave të ndaluar u janë dhënë batanije të holla për të fjetur, megjithatë këto batanije janë hequr përsëri pas një

<sup>63</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P4-9, 89 dhe 95; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 16; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 7; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P69.

<sup>64</sup> Dëshmitarët hamendësuan se dhoma mund të ketë qenë e përmasave nga 3 x 4 metra deri në 5 x 6 metra. Shih Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P44; Dëshmitari B, 16 mars 2011, fq. 14; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P38; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 7; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P82.

<sup>65</sup> Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P52.


<sup>66</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 14; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P64.

<sup>67</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P45, 54-58; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 14 dhe 15; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill, Q163; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P50-52, 66-68; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 8; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P82, 174-176.

<sup>68</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P59.

<sup>69</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P46-47; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 15; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P163-164; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 7-8; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P82, 174-176.

<sup>70</sup> Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P45-49; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 7.



jave.<sup>71</sup> Pas vrasjes së të ndaluarit [REDACTED], të ndaluarve u janë dhënë disa batanije dhe sfungjerë.<sup>72</sup>

76. Dhoma e ndalimit nuk është pastruar asnjëherë përveç se nga vetë të pandehurit.<sup>73</sup> Nuk kishte dushe dhe të ndaluarit nuk mund të pastroheshin.<sup>74</sup> Dëshmitari B është lejuar të pastrohet vetëm një herë me ujë të ftohtë jashtë në oborr gjatë ndalimit të tij në Kukës nga përafërsisht data 14 maj deri me datë 17 qershor 1999, dhe vetëm sepse ai ishte i mbuluar me gjak nga keqtrajtimi.<sup>75</sup> Dëshmitari A ka mundur të pastrohet vetëm një herë gjatë ndalimit të tij, jashtë në oborr me dy kova uji.<sup>76</sup> Dëshmitari F ka mundur të pastrohet në një barakë në oborr.<sup>77</sup> Dëshmitari D, dëshmitari E dhe dëshmitari G kanë pasur qasje në ujë për tu larë jashtë përafërsisht një herë në tre ditë por kjo ishte për shkak të punës së detyruar që ata bënë duke shkarkuar kamionë duke iu dhënë mundësinë atyre të dalin nga dhoma çdo ditë ndryshe nga të ndaluarit e tjerë.<sup>78</sup>
77. Të ndaluarit nuk kishin mundësi të ndërronin rrobat me rroba të pastra gjatë ndalimit të tyre me përjashtim të dëshmitarit F i cili një herë ka marrë ndërresa të pastra nga familja e tij.<sup>79</sup>
78. Tuelalet gjendej jashtë, rreth 50 metra larg dhomës, mes ndërtesës ku mbaheshin të ndaluarit dhe depos.<sup>80</sup> Të ndaluarit është dashur të kërkojnë leje për të shkuar në tualet

<sup>71</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 15; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P40-51.

<sup>72</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P47.

<sup>73</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars, fq. 14; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P38-39.

<sup>74</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P84-86.

<sup>75</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 16; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P1.

<sup>76</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P64-65.

<sup>77</sup> Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P59.

<sup>78</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 8.

<sup>79</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P64-65; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 March 2011, p. 15; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P60-63; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P84-86.

<sup>80</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P35-36, 44; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor 16 mars 2011, fq. 16; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 8, Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 April 2011, P82-88, 144.

dhe gjatë kësaj kohe ata shoqëroheshin dhe ruheshin nga ushtarë.<sup>81</sup> Dëshmitari A ngacmohej shpesh nga ushtarë të UÇK-së kur ai shkonte apo kthehej nga tualeti në atë masë sa ai përpiquej të shmangte shkuarjen në tualet.<sup>82</sup>

79. Edhe pse kishte disa mospërputhje në dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm lidhur me sasinë e saktë të ujit që ata kanë marrë gjatë ndalimit të tyre, pesha e provave verteton se furnizimi me ujë ishte i parregullt dhe jo në bazë ditore. Gjithë të ndaluarit në dhomë duhej të bashkë ndanin ujin që iu jepej dhe t'a kursenin atë.<sup>83</sup>
80. Gjithashtu, furnizimi me ushqim për të ndaluarit bëhej në mënyrë të parregullt dhe në sasi të pamjaftueshme.<sup>84</sup> Si rezultat i kësaj të ndaluarit kanë pësuar humbje peshe të madhe. Dëshmitari A ka humbur 17 kg gjatë ndalimit të tij në kamp,<sup>85</sup> dhe dëshmitari B ka rënë në peshë gjatë ndalimit nga 77-78 kg në 40-45 kg.<sup>86</sup>
81. Për shkak të punës së detyrueshme për shkarkimin e kamionëve dëshmitari D, dëshmitari E, dhe dëshmitari G nuk kanë ngrënë në dhomë me të ndaluarit e tjerë por me ushtarët e UÇK-së.<sup>87</sup>
82. Ndërsa shumica e të pandehurve mbaheshin të mbyllur me çelës në një dhomë gjithë ditën, dëshmitari D, dëshmitari E dhe dëshmitari G detyroheshin të punonin për orë të gjata në depo çdo ditë, duke shkarkuar kamionë me furnizime për UÇK-në. Orari i tyre i punës fillonte herët në mëngjes dhe zgjaste deri në çdo kohë prej orës 22:00 deri

<sup>81</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 June 2011, Q49; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 28 March 2011, P155; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 March 2010, fq. 8; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 April 2011, Q82-88, 144.

<sup>82</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P35-36, 49-53.


<sup>83</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P51-53; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 15-16; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P122; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P54-56; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P84-86.

<sup>84</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P61; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 16; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P57-58; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P82-83.

<sup>85</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P62.

<sup>86</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 March 2011, fq. 16.

<sup>87</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 8.



01:00.<sup>88</sup> Dëshmitari D dhe E janë detyruar gjithashtu të pastrojnë tualetet e përbashkëta në orët e natës.<sup>89</sup>

83. Të gjithë dëshmitarët kanë kaluar një sasi kohe domethënëse të ndaluar në këto kushte. Dëshmitari A është mbajtur në kampin e Kukësit për rreth një muaj nga ose rreth datës 14 maj deri në apo rreth datës 18 qershor 1999.<sup>90</sup> Dëshmitari B është mbajtur përafërsisht një muaj, nga ose rreth datës 14 maj deri rreth datës 16 qershor 1999<sup>91</sup> deri me 19 qershor 1999<sup>92</sup>. Dëshmitari D dhe dëshmitari E janë mbajtur në kamp përafërsisht një muaj.<sup>93</sup> Dëshmitari F është mbajtur i ndaluar përafërsisht një muaj.<sup>94</sup> Dëshmitari G është mbajtur në kamp përafërsisht 3 javë, duke filluar nga apo rreth datës 15-17 maj 1999.<sup>95</sup> Dëshmitari H është mbajtur në kamp përafërsisht nga data 21 maj deri me 01 qershor 1999.<sup>96</sup>

#### **Torturat e Dëshmitarëve A, B, C, D, E, H, dhe [REDACTED] me datë 19 maj 1999**

84. Një natë, apo rreth natës së datës 19 maj 1999, dëshmitari A, dëshmitari B, dëshmitari C, dëshmitari D, dëshmitari E, dëshmitari H dhe [REDACTED] janë sjellë në një dhomë tjetër që i ngjante një 'zyre', ku ata u rrahën rëndë ndërsa merreshin në pyetje nga Sabit Geci dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Ndërsa data e saktë nuk mund të vërtetohet në mënyrë konkrete dhe ngjarja mund të ketë ndodhur mes datës 19 maj 1999 dhe 22 maj 1999, fakti i rëndësishëm, i cili vërtetuar në mënyrë konkrete, është fakti se ngjarja ka ndodhur. Për këtë arsye Gjykata përdor termin "me apo rreth datës 19 maj 1999" për këtë incident.

<sup>88</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 June 2011, Q20-25; Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P145-151, 165; Dëshmitari E, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P57-60, 66-68; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 6; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, Q79-80, 140.

<sup>89</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P23-25; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 mars 2011, P80-81, dhe 139-141.

<sup>90</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P3, 18-20.

<sup>91</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 14; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P1-3; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P8-14.


<sup>92</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P209.

<sup>93</sup> Dëshmitari D, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P142; Dëshmitari E, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 07 prill 2011, P38.

<sup>94</sup> Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P21.

<sup>95</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit në Prokurori (Dëshmitari G), 04 mars 2010, fq. 5-6.

<sup>96</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P21 dhe 28.



85. Këtë natë, të ndaluarit janë marrë një nga një nga dhoma ku ata ishin rregullisht të ndaluar dhe janë sjellë në një dhomë tjetër e cila gjendej në katin përdhës e cila ngjante si zyrë.<sup>97</sup> Aty ishte një tavolinë, karrige dhe një shtrat në zyrë.<sup>98</sup>
86. Brenda zyrës gjendeshin shumë ushtarë të UÇK-së, përfshirë Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi, Osman Kryeziu dhe Pjeter Shala (i njohur gjithashtu si “komandant Ujku”).<sup>99</sup> Disa ishin me uniforma të UÇK-së dhe të tjerë me rroba civile.<sup>100</sup>
87. Dëshmitari H është sjellë në zyrë i pari.<sup>101</sup> Kur ka hyrë në zyrë, dëshmitari H është goditur menjëherë nga dy prej ushtarëve.<sup>102</sup> Sabit Geci, i cili ishte i ulur në një shtrat, ka bërë pyetje dëshmitarit H lidhur me identitetin e tij dhe se nga ishte.<sup>103</sup> Edhe ushtarë të tjerë kanë pyetur dëshmitarin H lidhur me identitetin e tij.<sup>104</sup> Dëshmitari H ka protestuar kundër pretendimeve dhe Sabit Geci e ka qëlluar atë në fytyrë.<sup>105</sup> Xhemshit Krasniqi ka goditur me një shkop dëshmitarin H në shpinë dhe në bërrylin e majtë.<sup>106</sup> Pastaj Pjetër Shala dhe ushtarët e tjerë të UÇK-së filluan të godasin dëshmitarin H në të gjitha pjesët e trupit, përfshirë në shpinë, shpatulla dhe gjoks.<sup>107</sup> Xhemshit Krasniqi goditi gjithashtu dëshmitarin H në kokë me tytë të armës.<sup>108</sup> Si rezultat, dëshmitari H pësoi një lëndim në kokë nga i cili rridhte gjak, dhe erdhi një

<sup>97</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49-50; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P33; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P 53, 58-59; Dëshmitari F, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P64.

<sup>98</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P61-63.

<sup>99</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49-54; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 17, Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P48; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P65-70, 79-80.

<sup>100</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P69; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 18; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P56-57; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P138.

<sup>101</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P53-58, 119; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P56.

<sup>102</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P99.

<sup>103</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P99-100, 122, 124.


<sup>104</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P120-121.

<sup>105</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P99-100, 125-126; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P111-113.

<sup>106</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P99-100, 123, 127; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P28-33.

<sup>107</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P127; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P13-15.

<sup>108</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P130-135.



doktor për të fashuar plagën.<sup>109</sup> Në një moment, dëshmitari H humbi vetëdije dhe e sollën në vete duke i hedhur një kovë me ujë.<sup>110</sup> Megjithatë, rrahjet vazhduan pas kësaj.<sup>111</sup> Gjithashtu Xhemshit Krasniqi ka fikur cigare në gjoks dhe sup të dëshmitarit H.<sup>112</sup> Akuzat ndaj dëshmitarit H vazhduan gjatë rrahjes. Sabit Geci e akuzoi atë për vrasjen e 100 ushtarëve të UÇK-së dhe përdhunimin e 20-30 grave.<sup>113</sup> Pjesëtarë të tjerë të UÇK-së e akuzuan atë se ishte oficer i policisë në vitin 1998, se kishte djegur shtëpi shqiptarësh dhe përdhunuar gra shqiptare.<sup>114</sup>

88. Sabit Geci erdhi personalisht bashkë me policë ushtarakë të UÇK-së të cilët kishin veshur rripa të bardhë për të sjellë dëshmitarin B dhe [REDACTED] nga dhoma e ndalimit në zyrë.<sup>115</sup> Dëshmitari H ishte në zyrë kur ata u sollën aty dhe ishte rrahur rëndë.<sup>116</sup> Ai e kishte kokën të mbështjellë me fasho dhe ishte i mbuluar me gjak.<sup>117</sup> Dëshmitari B pa se megjithëse ai ishte lënduar dëshmitari H vazhdonte të goditej, me shufër hekuri dhe një shkop bejsbolli i mbuluar me gomë, nga Pjetër Shala dhe Xhemshit Krasniqi,<sup>118</sup> si dhe nga Sabit Geci me paterica.<sup>119</sup> Në një moment të caktuar, Sabit Geci dhe një ushtar tjetër i UÇK-së hodhën kripë mbi fytyrën dhe plagët e dëshmitarit H.<sup>120</sup>
89. Në një pikë, edhe dëshmitari C u soll në zyrë nga ushtarë të UÇK-së dhe pa dëshmitarin B dhe [REDACTED] të cilët po i rrihnin me shufra metali dhe shkopinj bejsbolli ndërsa merreshin në pyetje nga UÇK-ja.<sup>121</sup> Edhe dëshmitari H, i cili ishte në

<sup>109</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 20; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P128-136; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P6.

<sup>110</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 19; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P137-138; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P1-3.

<sup>111</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P139-140.

<sup>112</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P11-12, 34.

<sup>113</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P124.

<sup>114</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 20; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P53.

<sup>115</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 16-17; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P20-24.

<sup>116</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 18-19; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P49-54.


<sup>117</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 18.

<sup>118</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 19.

<sup>119</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 19.

<sup>120</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 20.

<sup>121</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P72-75; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 24 dhe 26-27; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars



dhomë ka parë shumë ushtarë të UÇK-së duke rrahur rëndë dëshmitarin B dhe [REDACTED], “me çfarë kishin”.<sup>122</sup>

90. Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe Osman Kryeziu bënë pyetje dëshmitarit B, të tilla si, kush e kishte dërguar atë në Shqipëri dhe nëse ai po spiunonte UÇK-në për serbët.<sup>123</sup> Gjithëashtu, dëshmitarit B iu bënë shumë pyetje lidhur me [REDACTED] dhe lidhur me [REDACTED] që jetonin dhe punonin atje dhe ai u akuzua se kishte një rol në vdekjen e komandant Petritit dhe Pal Palucaj.<sup>124</sup> Dëshmitari B mohoi këto akuza dhe pastaj Sabit Geci, Pjeter Shala, Xhemshit Krasniqi, dhe një ushtar tjetër i UÇK-së filluan ta keqtrajtojnë atë. Fillimisht Sabit Geci detyroi Pjeter Shalën të godasë dëshmitarin B, dhe pastaj shumë nga ushtarët e tjerë të UÇK-së e goditën atë me shufra hekuri dhe shkopinj bejsbolli.<sup>125</sup> Në një moment të caktuar, Sabit Geci goditi dëshmitarin B në kokë me një pistoletë.<sup>126</sup> Dëshmitari B humbi vetëdije më shumë se një herë gjatë këtyre rrahjeve.<sup>127</sup>
91. Dëshmitari A është sjellë i fundit në zyrë.<sup>128</sup> Kur ai hyn, e sheh se të ndaluarit tjerë ishin rrahur tashmë dhe Xhemshit Krasniqi ishte ende duke i goditur.<sup>129</sup> Në këtë çast Sabit Geci ishte i ulur në shtrat dhe nuk merrte pjesë në rrahjen fizike të të ndaluarve.<sup>130</sup> Dëshmitari A sheh se Dëshmitari B dhe [REDACTED] ishin rrahur më keq se ai. Ishin të gjakosur dhe rriheshin me shkopinj nga ushtarët e UÇK-së. Ushtarët e UÇK-së e bënë me radhë por ishte kryesisht Xhemshit Krasniqi ai i cili i rrihte ata. Dëshmitari B dhe [REDACTED] bërtisnin, ushtarët e UÇK-së vinin kripë në plagët e tyre<sup>131</sup> dhe futën kokën e Dëshmitarit B në një kovë me ujë.<sup>132</sup>

2011, P24; Raport mbi Marrjen në Pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, p. 4; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P 52.

<sup>122</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P44 dhe 135-136.

<sup>123</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 21; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P67-68.

<sup>124</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 22-24.

<sup>125</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 21-22; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P72-74.

<sup>126</sup> Eitnes B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 22; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 24 mars 2011, P100-102.

<sup>127</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, fq. 24-25.


<sup>128</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49

<sup>129</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49, 66

<sup>130</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49, 52, 77-78.

<sup>131</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P56-58; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 22-23.

<sup>132</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 22-23.



92. Pasi është rrahur Dëshmitari B, ata e nxorën atë jashtë zyrës në korridor ku ushtarët e UÇK-së i vënë një thikë në fyt.<sup>133</sup> Gjatë kohës në korridor Dëshmitari B dëgjon Dëshmitarin C dhe [REDACTED] që bërtiste brenda në zyrë derisa ata ishin duke u rrahur.<sup>134</sup> Dëshmitari B ishte në korridor për afërsisht 30 minuta.<sup>135</sup>
93. Në zyrë Xhemshit Krasniqi dhe ushtarët e UÇK-së goditnin Dëshmitarin C me duar. Dëshmitari C akuzohej se i ka kënduar [REDACTED] Arkanit [REDACTED] derisa ka punuar në një kafene.<sup>136</sup> Dëshmitari C është goditur me shkopinj plastik derisa ka humbur vetëdijen.<sup>137</sup> Kur ajo rimerr vetëdijen, ajo prapë goditet dhe i bëhen pyetje lidhur me shoqërinë e saj me Dëshmitarin B dhe [REDACTED] dhe nëse ata ishin spiun të Serbëve.<sup>138</sup> Ata përpiqen të detyrojnë Dëshmitarin C të deklarojë se Dëshmitari B dhe [REDACTED] janë bashkëpunëtorë të Serbisë.<sup>139</sup>
94. Dëshmitari A është detyruar të z bathë këpucët e tij.<sup>140</sup> Pjetër Shala rreh Dëshmitarin A dhe e godet atë në duar deri në atë shkallë që atij gati i bie të fikët.<sup>141</sup> Dëshmitari H e sheh Dëshmitarin A duke u rrahur keq, duke përfshirë Sabit Gecin i cili e godiste me grusht dhe me shkop gome.<sup>142</sup> Dëshmitari H e ka parë Sabit Gecin, Xhemshit Krasniqin dhe Pjetër Shalën duke keqtrajtuar Dëshmitarin A.<sup>143</sup> Dëshmitari H e ka parë Sabit Gecin duke goditur me shuplakë në fytyrë Dëshmitarin A dhe duke përdorë shkopin mbi pëllëmbët e duarve.<sup>144</sup> Pas 10-15 minutash rrahje Dëshmitari A tha “Po më bie të fikët” dhe Sabit Geci pastaj thotë “Mjaft” dhe ata ndalojnë rrahjen e Dëshmitarit A.<sup>145</sup>

<sup>133</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 25

<sup>134</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 25-27; Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P76-79.

<sup>135</sup> Dëshmitari B, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 26.

<sup>136</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P72.

<sup>137</sup> Raporti mbi Procesverbalin e Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, faqe 4.

<sup>138</sup> Raporti mbi Procesverbalin e Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit Viktimës (Dëshmitari C), 09 prill 2009, faqe 4; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P146-147.

<sup>139</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P65-67

<sup>140</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P49 & 52.


<sup>141</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P51-54.

<sup>142</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P44, 50, 114, 133.

<sup>143</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P47.

<sup>144</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P50.

<sup>145</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P52-53; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor 10 qershor 2011, P182-183;



95. Dëshmitari A ka parë po ashtu Dëshmitarin H duke u rrahur rëndë me shufra gome dhe bishta druri të sëpatës.<sup>146</sup> Derisa Dëshmitari H ishte duke u rrahur ai pyetej pse nuk ka dhënë dorëheqje nga puna më herët dhe është akuzuar se është në shoqëri me Arkanin.<sup>147</sup>
96. Dëshmitari B llogarit se rrahjet kanë zgjatë deri rreth orës 6 në mëngjes sepse kishte filluar drita e diellit të mëngjesit.<sup>148</sup> Pas rrahjeve, të ndaluarit janë marr nga zyra dhe janë kthyer në dhomën e ndalimit një nga një.<sup>149</sup> Dëshmitari A u kthye në gjendje të keqe, ai mezi ecte dhe e kishte dorën e ënjtur.<sup>150</sup> Dëshmitari B dhe ██████████ ishin sjellë pas në një gjendje tepër të keqe dhe ankoheshin për dhembje në qafë, kokë, shpinë, duar dhe këmbë.<sup>151</sup> ██████████ ishte sjellë në dhomë nga ushtarë të UÇK-së pasi që ai nuk mund të ecte. Asnjëri nga ta nuk mori ndonjë trajtim mjekësor për lëndimet e tyre.<sup>152</sup>

#### ***Cenimi i Integritetit Trupor të Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H dhe ██████████***

97. Veç marrjes në pyetje dhe rrahjes së përshkruar më lartë me apo rreth 19 Majit 1999, ka patur dhe rrahje tjera të shumta dhe shpeshta të të ndaluarve gjatë kohës në robëri në kampin e UÇK-së në Kukës. Secili nga dëshmitarët, me përjashtim të Dëshmitarit D dhe Dëshmitarit E, i kanë përshkruar të rrahurat që kanë marr nga ushtarët e UÇK-së, gjatë kohës kur dëshmitarë tjerë apo të ndaluarit që kanë qëlluar në dhomë janë rrahur po ashtu.

<sup>146</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P59-62.

<sup>147</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P72.


<sup>148</sup> Dëshmitari B, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 25, 27-28.

<sup>149</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P82; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P57-58.

<sup>150</sup> Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P60 & 133.

<sup>151</sup> Dëshmitari A, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P82-85; Dëshmitari H, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P61-64.

<sup>152</sup> Dëshmitari B, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 28; Dëshmitari B, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P82-84.



98. Rrahjet mund të ndodhnin në dhomën e ndalimit<sup>153</sup> apo një i ndaluar mund të nxirrej nga dhoma në një vend tjetër dhe të rrihej atje.<sup>154</sup> Dëshmitari F përshkruan të ndaluarit duke u rrahur “në mënyrën më shtazarake.”<sup>155</sup>

#### Dëshmitari A

99. Dëshmitari A ishte rrahur disa herë në dhomën e ndalimit dhe kishte pësuar shumë dhimbje dhe lëndime si pasojë e këtyre rrahjeve.<sup>156</sup> Gjatë rrahjes, Dëshmitari B ka dëgjuar Sabit Gecin të pyet Dëshmitarin A pyetje lidhur me [REDACTED], si për shembull, “pse merr mall nga Serbia dhe e sjell në Kosovë?”<sup>157</sup>
100. Dëshmitari A përshkruan po ashtu shembuj tjerë të sjelljes kriminale të tillë si për shembull robërit detyroheshin të rriheshin me njëri tjetrin dhe detyroheshin të qëndrojnë në pozita stresi si për shembull periudha kohore të gjata në një këmbë në një nxehtësi të jashtëzakonshme duke i shkaktuar atij t’i bie të fikët dy herë.<sup>158</sup> Megjithatë është konstatuar nga Trupi Gjykyes se asnjë dëshmitar tjetër nuk përshkruan këto hollësi specifike dhe se pesha që mban kjo dëshmi është shumë e kufizuar.

#### Dëshmitari B dhe [REDACTED]

101. Dëshmitari B i është nënshtruar keqtrajtimit shumë herë.<sup>159</sup> Në mbremje me apo rreth 20 Majit 1999, Xhemshit Krasniqi dhe ushtarë tjerë të UÇK-së kanë rrahur Dëshmitarin B, [REDACTED] dhe të ndaluar tjerë në një dhomë me grila hekuri, shkopinj policie, armë dhe grushte.<sup>160</sup> Pas kësaj, ka patur së paku tri raste tjera ku Dëshmitari B është rrahur nga ushtarë të UÇK-së në dhomë ku ai ishte ndaluar. Sabit

<sup>153</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P95; Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 Qershor 2011, P10, 16, 69, 74-79, 184; Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P219-233, 228-247.

<sup>154</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P49-50; Dëshmitari H, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P68, 75-78.

<sup>155</sup> Dëshmitari H, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 31 mars 2011, P36.


<sup>156</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P10, 16, 69, 74-79, 184; Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P219-223.

<sup>157</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P225-226.

<sup>158</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, faqe 17 P91-94; Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, faqe 8 Q60.

<sup>159</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 33.

<sup>160</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 31-32; Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P88-92, 95-96.



Geci ishte i përfshirë në njërin prej këtyre rasteve.<sup>161</sup> Ekziston një konflikt në mes Dëshmitarit B dhe Dëshmitarit F lidhur me vendin e saktë të rrahjes së pësuar nga B-ja dhe ██████████. Dëshmitari B sugjeron se rrahjet kanë ndodhur në dhomën e njëjtë me dëshmitarët tjerë ndërsa Dëshmitari F sugjeron se B-ja dhe ██████████ janë dërguar te një vend tjetër për t' rrahur.<sup>162</sup> Trupi Gjykses konsideron se konflikte të vogla të tilla nuk e zvogëlojnë besueshmërinë e plotë të provave për arsyet siç vijojnë. Së pari, elementi thelbësor që secili dëshmitar provonte të përshkruaj ishte fakti i rrahjeve dhe ndikimi mbi viktimat e rrahjeve të tilla. Çështjet siç janë vendi dhe koha janë ndihmëse të elementit kryesor, do të thotë rrahjet. Me kalimin e kohës, kujtesa e çështjeve ndihmëse pashmangshmërisht zbehet. E dyta, pasi që është e qartë se kanë ndodhur disa rrahje, ca kanë mundur të ndodhin në dhomën e njëjtë dhe të tjerat në vende tjera. Me të vërtetë Dëshmitari B qartë ka deklaruar se nganjëherë ai rrihej në dhomë dhe nganjëherë në korridor.<sup>163</sup> E treta vrulli kryesor i marrjes në pyetje të Dëshmitarit B ka të bëjë me çfarë ka ndodhë dhe kur, me pak eksplorim se ku. Prandaj në konkludim të kësaj çështjeje, ndërsa pranojmë se ka një mospajtim në shpjegim sa i përket vendit të ngjarjeve në mes Dëshmitarëve B dhe F, është nxjerr si përfundim se ky është një dallim i vogël e cila nuk e minon cilësinë e përgjithshme të shpjegimeve të tyre.

#### Dëshmitari D dhe Dëshmitari E

102. Gjatë tre ditëve të para kur Dëshmitari B ishte ndaluar në depo, ai kishte parë Dëshmitarin Dëshmitari B:, Dëshmitarin E dhe një mashkull Rom të panjohur duke bërtitur derisa ishin duke u rrahur nga policia ushtarake e UÇK-së.<sup>164</sup>
103. Dëshmitari D dhe Dëshmitari E dhe ██████████ janë rrahur gjithashtu në disa raste derisa në dhomën e ndalimit.<sup>165</sup> Dëshmitari B ka parë Sabit Gecin personalisht në një rast duke rrahur të ndaluarit ██████████.<sup>166</sup> Njëri nga të ndaluarit ██████████ nuk ka mundur të

<sup>161</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P110-112.


<sup>162</sup> Shiko shënimet 160 dhe 161 më lartë për referenca lidhur me shpjegimin e Dëshmitarit B. Shiko Procesverbalin e Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P63-76 lidhur me shpjegimin e Dëshmitarit F.

<sup>163</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P110.

<sup>164</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 mars 2011, faqe 11-12; 21 mars 2011, P231.

<sup>165</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P228-247.

<sup>166</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P121 & 233.



flas kurrë pa u goditur, pasi që kishte një ushtarë të UÇK-së që dukej se nuk i donte njerëzit [REDACTED].<sup>167</sup>

104. Dëshmitari D dhe Dëshmitari E janë rrahur gjithashtu derisa ishin duke punuar, duke shkarkuar ngarkesat e mauneve në depo.<sup>168</sup>

#### Dëshmitari F

105. Dëshmitari F ishte keqtrajtuar në dy raste të ndara<sup>169</sup>. Në rastin e parë, pasi është ndaluar në një dhomë për 2-3 javë, Dëshmitari F ishte goditur në sy.<sup>170</sup> Kjo ka ndodhur në dhomën e ndalimit dhe të ndaluarit tjerë kanë qenë të pranishëm dhe ata janë goditur gjithashtu.<sup>171</sup> Ushtarët e UÇK-së pyetën po ashtu edhe Dëshmitarin F pyetje lidhur me identitetin e tij dhe se ku ka punuar, pasi që ishin të shqetësuar se ai ishte bashkëpunëtor i Serbëve. Pasi ai u tregoi atyre se ishte i punësuar si [REDACTED], ata a thirrën atë “tradhtar” dhe “spiun”.<sup>172</sup>
106. Rasti i dytë ishte kur Dëshmitari F ishte detyruar të kthehet me fytyrë nga muri dhe ishte goditur në shpinë.<sup>173</sup> Dukej sikur të isha goditur me shkop gome të policisë.<sup>174</sup> Si pasojë ai nuk ka mundur të lëviz shpinën fare.<sup>175</sup>

#### Dëshmitari H

107. Dëshmitari H ishte rrahur herë pas here kur ushtarë të panjohur të UÇK-së vinin në dhomën e ndalimit natën vonë dhe e rrihnin atë dhe të ndaluar tjerë në duar me shkopinj gome.<sup>176</sup>

<sup>167</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P40.

<sup>168</sup> Dëshmitari H, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P80-81.

<sup>169</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, Q7-10; Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P27-51, P158-159.

<sup>170</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P27-51

<sup>171</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P49-50.


<sup>172</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P39-44,0158-159.

<sup>173</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P27-49.

<sup>174</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P53.

<sup>175</sup> Dëshmitari F, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 28 mars 2011, P56.

<sup>176</sup> Dëshmitari H, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 04 prill 2011, P68-69, 77.



Rrahjet e të Ndaluarve të Tjerë

108. Me apo rreth 20 Maj 1999 rreth mesditës, Sabit Geci ka hyrë në dhomë të ndalimit ku Dëshmitari B ishte i ndaluar me [REDACTED] dhe disa persona tjerë. Geci ishte me dy Policë Ushtarak të UÇK-së, dhe sollën në dhomë tre ushtarë të UÇK-së të arrestuar.<sup>177</sup>
109. Të tre ushtarët e UÇK-së ishin sjellë brenda sepse kishin lëshuar vijën e frontit. Sabit Geci dhe ushtarë tjerë të UÇK-së nga Njësia Speciale të veshur me uniforma të zeza rrahën të tre ushtarët e arrestuar deri kur atyre u ra të fikët. Njëri theu shkopin në kokën e njërit pre tyre. Në mu këtë rast ata rrahën të ndaluarit që tashmë ishin në dhomë – në veçanti Dëshmitarin B, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, burrin e panjohur Rom, dhe ty të ndaluar tjerë.<sup>178</sup> Sipas Dëshmitarit B ata “i kanë rrah për vdekje” të gjithë.<sup>179</sup>
110. Dëshmitari A përshkruan edhe një incident tjetër të tillë, kur katër ushtarë të FARK-ut (vëllezërit Ademi) u sollën brenda dhe u rrahën nga Sabit Geci dhe ushtarë tjerë të UÇK-së.<sup>180</sup>
111. Dëshmitari B gjithashtu përshkruan incidente tjera të dhunës që ai ka parë gjatë kohës sa ishin të ndaluar; Një i ndaluar – një burrë i madh me mustaqe nga Suhareka që ishte akuzuar se është spiun – ishte keqtrajtuar në dhomë nga Xhemshit Krasniqi i cili e “e rrahu për vdekje” së bashku me disa ushtarë tjerë të UÇK-së.<sup>181</sup> Një i ndaluar tjetër – një burrë nga Malisheva të cilit iu gjet një librezë e SPS/PSS dhe prandaj është konsideruar spiun – ishte rrahur dhe kishte të çara thike në këmbët e tij.<sup>182</sup>

<sup>177</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 Mars 2011, faqe 28-29.


<sup>178</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 Mars 2011, P62-65; Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 24 Mars 2011, P103-105;

<sup>179</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 16 Mars 2011, faqe 28

<sup>180</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 Qershor 2011, P96-97.

<sup>181</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 Mars 2011, P248-249.

<sup>182</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 Mars 2011, P251-253.



112. Pas vdekjes së [REDAKTUAR] (përshkruar më poshtë) rrahjet ishin më të rralla. Megjithatë ato ndodhen edhe disa herë.<sup>183</sup>

### Dëshmitari C

113. Dëshmitari C gjithashtu i është nënshtruar keqtrajtimit të rëndë.

114. Derisa akoma fillimisht i ndaluar në depo, Dëshmitari C ishte zgjuar nga gjumi në mëngjesin e 3-të ku ka parë [REDAKTUAR] duke u rrahur nga tre persona me shtaga dhe shkopinj. Gjatë rrahjes UÇK bënte pyetje lidhur me atë se si Dëshmitari B, Dëshmitari C dhe [REDAKTUAR] kishin ardhur në Kukës. Ata gjithashtu qëlluan me shuplakë dhe shkelmuan Dëshmitarin C, duke e pyetur lidhur me njohjen e saj me Dëshmitarin B dhe [REDAKTUAR].<sup>184</sup>

115. Kur janë nxjerrë nga depoja, Dëshmitari C ishte ndarë nga të tjerët dhe ishte ndaluar vetëm në një dhomë. Gjatë kësaj kohe ajo gjithashtu i është nënshtruar keqtrajtimit të rëndë. Gjatë ndalimit të saj Dëshmitari C do të merrej në pyetje nga ushtarë të ndryshëm të UÇK-së gati çdo ditë.<sup>185</sup> Ata pyesnin lidhur me Dëshmitarin B dhe [REDAKTUAR], dhe lidhur me shoqërimin e tyre me Dëshmitarin C, sepse UÇK-ja dyshonte se ata bashkëpunonin me Serbët. Këto marrje në pyetje përfshinin dhunë, rrahje dhe keqtrajtim.<sup>186</sup> Në një rast ata rrahën Dëshmitarin C me një thikë apo shkop metali, dhe në një rast tjetër Dëshmitari C u rrah në pavetëdije. Në një moment Dëshmitari C ishte çuar nga dy ushtarë të armatosur të UÇK-së [REDAKTUAR]. Si pasojë Dëshmitari C ka pësuar lëndime dhe dëmtime të përhershme.<sup>187</sup> Gjatë ndalimit të saj Dëshmitari C ka mundur të dëgjoj britmat e burrave çdo ditë.<sup>188</sup>

### ***Marrja në Pyetje dhe Akuzat***

<sup>183</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, Q91; Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P204-207.


<sup>184</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 Dhjetor 2009, faqe 4-5.

<sup>185</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 Dhjetor 2009, faqe 8.

<sup>186</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 Dhjetor 2009, faqe 9.

<sup>187</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 Dhjetor 2009, faqe 8-13; Raporti mbi Marrjen në Pyetje Deklarata e Dëshmitarit (Dëshmitari C), 09 prill 2009, faqe 4-5, 7).

<sup>188</sup> Procesverbal i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari C), 17 Dhjetor 2009, faqe 9.



116. Veç pyetjeve të veçanta dhe akuzave të cilat UÇK-ja i ka parashtruar kundër të ndaluarve të caktuar që u përshkruan në pjesën më lartë, ka patur dhe incidente tjera që kanë ndodhë ku janë bërë akuzime nga UÇK-ja kundër një të ndaluar apo një marrje në pyetje tjetër apo intervistë e një të ndaluar. Këto marrje në pyetje ishin të ndërlidhura me akuzimet e bëra nga UÇK-ja kundër të ndaluarit, shpesh për shkak të lidhjes së perceptuar me autoritetet Serbe apo njerëzit Serb.
117. Të ndaluarit herë pas here nxirreshin nga dhoma individualisht për t'u marr në pyetje. Dëshmitari G ishte marr në pyetje tre herë. Gjatë secilës intervistë ai akuzohej për dëbimin e bashkëfshatarëve të tij nga shtëpitë e tyre, për zotërimin e një arme dhe e të qenit mik dhe bashkëpunëtor me Serbët.<sup>189</sup> Intervistat bëheshin kryesisht natën vonë, si për shembull 23:00 dhe në mesnatë.<sup>190</sup> Persona tjerë që mbaheshin akuzoheshin se janë bashkëpunëtorë të Serbëve pasi ata punonin në [REDACTED].<sup>191</sup>
118. Dëshmitari A ishte akuzuar nga ushtarët e UÇK-së për përfshirjen në vrasjen e “Vëllezërve Gërvalla”.<sup>192</sup> Për më tepër ai është detyruar të shkruaj autobiografinë e tij.<sup>193</sup>
119. Dëshmitari H ishte arrestuar nga UÇK-ja sepse ai kishte punuar si [REDACTED] Kosovë dhe ushtarët e UÇK-së e kishin marr në pyetje atë lidhur me pse ai nuk kishte dhënë dorëheqje me [REDACTED] kur ata kishin dhënë dorëheqje.<sup>194</sup>
120. Dëshmitari D dhe Dëshmitari E mbaheshin të ndaluar për shkak të një pretendimi se ata ishin pjesë e një njësie paramilitare e cila luftonte me Serbët.<sup>195</sup>

### Vrasja e [REDACTED]

121. [REDACTED] kishte pasur aksident trafiku rreth gashtë muaj para majit të vitit 1999 ku theu gjashtë brinjë të thyer dhe plagë që është dashur të qepeshin. Në kohën e

<sup>189</sup> Proceverbal i Prokurorisë i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari G), 04 mars 2010, faqe 7-10.

<sup>190</sup> Proceverbal i Prokurorisë i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari G), 04 mars 2010, faqe 9.


<sup>191</sup> Proceverbal i Prokurorisë i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari G), 04 mars 2010, faqe 12.

<sup>192</sup> Proceverbal i Prokurorisë i Dëgjimit të Dëshmitarit (Dëshmitari G), 04 mars 2010, faqe 9.

<sup>193</sup> Dëshmitari A, Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 09 qershor 2011, P81.

<sup>194</sup> Dëshmitari A, Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 10 qershor 2011, P26-31.

<sup>195</sup> Dëshmitari B, Proceverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P212-213.



arrestimit të tij, ndalimit dhe rrahjes në Kukës, lëndimet e përmendura nuk i ishin shëruar.<sup>196</sup>

122. Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve A, B dhe F, është vërtetuar se [REDACTED] ka vdekur derisa ka qenë i ndaluar në kampin e Kukësit më apo rreth datës 5 qershor 1999 rreth orës 14:00-14:45 si rezultat i plagës së shkaktuar me armë zjarri në këmbë.<sup>197</sup> Plaga rezultoi nga një episod keqtrajtimi të rëndë që filloi në mbrëmje, një apo dy netë para se të vdiste.
123. Atë mbrëmje, Dëshmitari B është nxjerrë nga dhoma e ndalimit dhe është vendosur në një dhomë tjetër pa derë që gjendej përballë korridorit nga dhoma e ndalimit. Të pranishëm ishin Xhemshit Krasniqi dhe disa ushtarë të tjerë të UÇK-së me një kasetofon të vogël.<sup>198</sup> UÇK-ja është përpjekur të detyrojë Dëshmitarin B të pranojë fajin dhe t'a regjistrojë këtë në audio-kasetë dhe kur ai refuzoi të bënte një gjë të tillë, e rrahën.<sup>199</sup> Dikur, Dëshmitari B u detyrua të vishte jelek anti-plumb dhe të qëndronte te muri ku pastaj e qëlluan duke e bërë që të alivanosej.<sup>200</sup>
124. Me t'i ardhur vetëdija sërish, UÇK-ja e ktheu Dëshmitarin B në dhomën e ndalimit (ku po mbaheshin dëshmitarët A, D, E, F, një [REDACTED] i panjohur dhe [REDACTED]) dhe e nxorri [REDACTED] nga dhoma për ta dërguar në anën tjetër të korridorit.<sup>201</sup> Dëshmitari B dëgjoi të shtëna dhe britmat e [REDACTED] dhe besoi se ai ishte vvarë.<sup>202</sup> Mirëpo, [REDACTED] u kthye sërish në dhomën e ndalimit në orët e hershme të mëngjesit dhe i tha Dëshmitarit B se UÇK-ja kishte shtënë drejt tij dhe ai ishte alivanosur.<sup>203</sup>

<sup>196</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 mars 2011, faqe 10; Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 24 mars 2011, Q24-26; Raporti i deklaratës së dëshmitarit viktimë (Dëshmitari C), 9 prill 2009, faqe 4.

<sup>197</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars

2011, P159-165, 174-202; 24 March 2011, P30, 39-40; Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P100-103; Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 10 qershor 2011, P1-4, 131; Dëshmitari F, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 28 mars 2011, P77-97.

<sup>198</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P122-129.


<sup>199</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P129-131.

<sup>200</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P129-138.

<sup>201</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P139-149; Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 10 qershor 2011, P3-6; Dëshmitari F, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 28 mars 2011, P77-80.

<sup>202</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 March 2011, P150.

<sup>203</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P153-156.



125. Në ditën e njëjtë, Xhemshit Krasniqi erdhi në dhomën e ndalimit dhe u tha Dëshmitarit B dhe [REDACTED] “njëri prej jush do të mbijetojë sonte, por jo të dy.”<sup>204</sup>
126. Atë mbrëmje erdhën ushtarë të UÇK-së në dhomën e ndalimit dhe morrën Dëshmitarin B dhe [REDACTED]. I vendosën në dhomën përballë korridorit, atë pa derë.<sup>205</sup> Sërish, ushtarët e UÇK-së u përpoqën të detyrojnë Dëshmitarin B dhe [REDACTED] të pranojnë fajin duke i regjistruar në audio-kasetë, i akuzuan për përfshirje në vrasjen e Komandant Petritit dhe i morrën në pyetje lidhur me [REDACTED] në Kosovë.<sup>206</sup> UÇK-ja i rrahu me shkopinj gome, duke i lënduar në brinjë dhe duke i goditur në fytyrë me armë automatike.<sup>207</sup> Një ushtar i UÇK-së ka shtënë me pistoletë TT në këmbën e majtë, mu mbi gishtërinjtë e Dëshmitarit B nga një distancë prej 50-70 cm.<sup>208</sup>
127. Pastaj edhe një ushtar tjetër i UÇK-së [pretendohet të jetë Xhemshit Krasniqi, por Trupi Gjykses nuk solli deri te ndonjë gjetje specifike faktike lidhur me identiten e ushtarit të UÇK-së në fjalë] shtiu me armë automatike drejt [REDACTED], duke e goditur me një deri në tre plumba nën gjurin e majtë, duke i shkaktuar gjakderdhje të rëndë.<sup>209</sup> Pavarësisht nga këto lëndime, ushtarët e UÇK-së vazhduan të keqtrajtojnë brutalisht Dëshmitarin B dhe [REDACTED] përgjatë natës e madje edhe në orët e hershme të mëngjesit, madje edhe pasi që i kthyen të dy në dhomën e ndalimit.<sup>210</sup>
128. Dëshmitari B kërkoi që të sillet një mjek për [REDACTED] dhe një mjek u soll ta kontrollonte brenda në dhomën e ndalimit. Mjeku nuk ia doli të ndalte gjakderdhjen nga plaga, shkaktuar me armë zjarri dhe rekomandoi që të sillet [REDACTED] në

<sup>204</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P157-159.

<sup>205</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P159-160.


<sup>206</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P161, 175.

<sup>207</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P161; Dëshmitari A dëshmoi se me kthimin e tij në dhomën e ndalimit, Dëshmitari B e informoi se ishte shtënë me revolver, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P109.

<sup>208</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 March 2011, P161-165, 169-173. Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P108-109; Dëshmitari F, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 28 mars 2011, P100-104; DFM Raporti i ekzaminimit fizik të Dëshmitarit B nga Dr. Marek Gasior datuar 2 mars 2011; DFM Raporti i Ekzaminuesit Mjekësor mbi ekzaminimin e Dëshmitarit B datuar 10 nëntor 2010.

<sup>209</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P123, 174-179; ZPZHML Raporti i autopsisë MA09216 [REDACTED] nga Dr. Marek Gasior datuar 18 gusht 2009.

<sup>210</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P179-189.



spitalin e Kukësit.<sup>211</sup> Mirëpo, një masë e tillë, e cila mbase ka mundur t'i shpëtojë [REDACTED] jetën u mohua nga ushtarët e pranishëm të UÇK-së.<sup>212</sup> Të ndaluarit e tjerë, veçanërisht Dëshmitari D dhe Dëshmitari E u përpoqën t'i ndihmojnë [REDACTED].<sup>213</sup> Por, disa orë më vonë, rreth orës 14:00, [REDACTED] vdiq në dhomën e ndalimit.<sup>214</sup>

129. Trupi Gjykses vë re se Dëshmitari D dhe Dëshmitari E e mohuan këtë incident. Këta jo vetëm që dëshmuan se nuk kanë qenë dëshmitarë të vdekjes së [REDACTED], por poashtu pretenduan se nuk kanë dijeni se dikush është keqtrajtuar gjatë qëndrimit në kamp. Siç u sqarua më lart, duke u mbështetur në versionet e dëshmitarëve A, B dhe F, Trupi Gjykses nuk konsideroi dëshmitë e Dëshmitarit D dhe Dëshmitarit E si të besueshme.
130. Dëshmitari A është pyetur shkurt lidhur me vdekjen e [REDACTED] gjatë marrjes në pyetje, dhe ky mbështet versionin e Dëshmitarit B sa u përket detaleve në vijim: një apo dy netë para vdekjes së tij, [REDACTED] është nxjerrë nga dhoma e ndalimit dhe është rrahur. U dëgjua një e shtënë. Kur [REDACTED] u kthye në dhomën e ndalimit, ai ishte i plagosur nën gju dhe kishte gjakderdhje. Erdhi mjeku dhe e kontrolloi [REDACTED], mirëpo ai vdiq.<sup>215</sup> Dëshmitari F poashtu mbështeti versionin e dëshmisë së Dëshmitarit B si në vijim: [REDACTED] nuk ishte në dhomën e ndalimit kur u dëgjuan të shtëna nga dhoma ngjitur. [REDACTED] është kthyer në dhomën e ndalimit në mëngjes me plagë afër gjurit dhe kishte gjakderdhje. Dëshmitari B kërkoi një mjek, i cili erdhi dhe kontrolloi [REDACTED], mirëpo Bisaku vdiq dy apo tre ditë më vonë në dhomën e ndalimit.<sup>216</sup>
131. Trupi Gjykses vë re se Dëshmitari A dhe Dëshmitari F dëshmuan se Dëshmitari B ishte brenda dhomës së ndalimit në kohën kur u dëgjua e shtëna, e cila besohet se e ishte në drejtim të [REDACTED], ndërsa Dëshmitari B dëshmoi se ka qenë së bashku me [REDACTED] në dhomën tjetër dhe se ishte dëshmitar i së shtënës. Kjo papërputhshmëri mund të sqarohet pa u cenuar besueshmërinë e përgjithshme të

<sup>211</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P190.


<sup>212</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P190-191.

<sup>213</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P194.

<sup>214</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P 191-199.

<sup>215</sup> Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P100-107.

<sup>216</sup> Dëshmitari F, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 28 mars 2011, P77-99.



këtyre dëshmitarëve. Gjatë periudhës në fjalë ndodhën disa incidente keqtrajtim, dhe vërtetë, Dëshmitari B dhe [REDACTED] kanë qenë të përfshirë në dy incidente të shtënash për dy ditë konsektive. Në incidentin e parë, Dëshmitari B ishte brenda dhomës së ndalimit me Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin F kur [REDACTED] është nxjerrë jashtë dhe janë dëgjuar të shtëna në afërsi, ndërsa në incidentin e dytë, që të dy, Dëshmitari B dhe [REDACTED] kanë qenë së bashku jashtë dhomës së ndalimit. Prandaj është e mundshme që në kujtesën e dëshmitarëve, disa detaje lidhur me incidentin e keqtrajtimit të një dite më parë të jenë konfuzuar me detallet e keqtrajtimit të ditës tjetër.

### ***Kampi i UÇK-së në Cahan të Shqipërisë***

132. UÇK-ja themeloi një kamp të dytë ushtarak në Cahan të Shqipërisë dhe këtu u ndaluan civilët. Në kohëra të ndryshme, të gjithë pesë të pandehurit kanë qenë të pranishëm dhe kishin një rol në kampin në Cahan. Secili i ndaluar arriti në kampin Cahan në mënyrë dhe rrugë të ndryshme.
133. Dëshmitari [REDACTED] ishte përkrahës i LDK-së dhe Ibrahim Rugovës që nga vitet e hershme të 1990.<sup>217</sup> [REDACTED]  
[REDACTED].<sup>218</sup> Në fillim të prillit 1999, [REDACTED] ishte duke punuar në Kroaci.<sup>219</sup> Me të filluar bombardimi i NATO-s në Kosovë, familja e [REDACTED] iku nga Kosova për në Shqipëri.<sup>220</sup> [REDACTED] udhëtoi në Shqipëri në kërkim të familjes së tij dhe në mbrëmjen e 12 prillit 1999, arriti në Krume.<sup>221</sup> Në mes të natës, 8-10 persona të veshur me uniformë, të maskuar dhe të armatosur me armë trokitën në derën e tij dhe e informuan se familja e tij po e priste në një xhami afër.<sup>222</sup> Ata e dërguan [REDACTED] në xhaminë ku ishte i pranishëm Sabit Geci.<sup>223</sup> Geci u prezantua dhe deklaroi se është “shef i policisë sekrete të UÇK-së.”<sup>224</sup> Sa i përket [REDACTED], Sabit Geci deklaroi “e kemi personin e duhur sepse ai është përkrahës i Rugovës” dhe “a mund të të shpëtojë

<sup>217</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P56.

<sup>218</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P92-95; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P67.

<sup>219</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P5-6.


<sup>220</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P9.

<sup>221</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P9-17.

<sup>222</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P21-25.

<sup>223</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P26-29.

<sup>224</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P29, 38-39.



Rugova tani?”<sup>225</sup> Sabit Geci dhe Haki Hajdari dërguan [REDACTED] dhe dy shqiptarë të tjerë të Kosovës me veturë në kampin e UÇK-së në Cahan.<sup>226</sup> [REDACTED] vuri re se ishin kazerma ushtarake dhe se të pranishëm kishte rreth 100-150 ushtarë të UÇK-së.<sup>227</sup>

134. Deri më 17 shtator 1990, Dëshmitari M ishte i punësuar si [REDACTED]. Më [REDACTED], së bashku me 100 të punësuar të tjerë, Dëshmitari M dha dorëheqje nga ky post. Më 1999, Dëshmitari M ishte i papunësuar.<sup>228</sup> Rreth katër ditë pasi NATO filloi fushatën, ushtria serbe dëboi Dëshmitarin M dhe familjen e tij nga shtëpia e tyre. Fillimisht udhëtuan për në Rozhaje të Malit të Zi, dhe pastaj në fshatin Skallure afër Durrësit të Shqipërisë. Dhjetë ditë më vonë, më apo rreth datës 16 prill 1999, një njeri u erdhi në derë në mbrëmje dhe u prezantua si anëtar i SHIK-ut. Kishte edhe dy persona të tjerë me të duke pritur në veturë. Ky person e informoi Dëshmitarin M se duhet të shkonte me të në Durrës. Dëshmitari M pranoi dhe pasi që hyri në veturën e tyre dhe vetura u nis, ata i thanë se nuk ishin SHIK, por UÇK. Pastaj Dëshmitari M u dërgua në Hotel Drenica.<sup>229</sup>
135. Në Hotel Drenica, Dëshmitari M u mor në pyetje nga një ushtar i UÇK-së, për të cilin më vonë mësoi se ishte Xhemshit Krasniqi.<sup>230</sup> Gjatë marrjes në pyetje, Xhemshit Krasniqi ishte i armatosur me armë.<sup>231</sup> Dëshmitari M u akuzua se është spiun dhe nga ai u kërkuan emrat e bashkëpunëtorëve serbë.<sup>232</sup> Ushtarët e UÇK-së konfiskuan patentë shoferin e Dëshmitarit M, letërnjoftimin, unazën, orën dhe paratë e gatshme.<sup>233</sup> Pastaj, i prangosur, u dërgua në kampin ushtarak të UÇK-së në Kukës.<sup>234</sup> Pas disa minutave, UÇK-ja solli edhe një person tjetër të prangosur (Dëshmitarin K) në veturë.<sup>235</sup>

<sup>225</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P58-59.

<sup>226</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P41-47, 60.

<sup>227</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P60.

<sup>228</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P19-22.

<sup>229</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P1-10.

<sup>230</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P11-14.


<sup>231</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P11-14.

<sup>232</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P11-17.

<sup>233</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P16.

<sup>234</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P23-29.

<sup>235</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P30-35.



136. Dëshmitari K u largua nga Kosova së bashku me familjen e tij dhe disa bashkëfshatarë të tjerë për shkak të konfliktit. Ai arriti në Durres të Shqipërisë më apo rreth datës 30 mars 1999. Atje jetoi në një kamp refugjatësh afër plazhit për rreth 12 ditë.<sup>236</sup> Dy persona të veshur me rroba civile, të cilët i kishin thënë se janë UÇK, i kishin thënë Dëshmitarit K poashtu se duhej të shkonte me ta për t'u përgjigjur në ca pyetje. Fillimisht ai u soll në Hotel Drenica në Durres për një natë, ku iu shtruan pyetje nga një person që pretendonte të jetë gjykatës hetues.<sup>237</sup> Pas kësaj, Dëshmitari K u soll në Kukës ku u mbajt për afërsisht tre ditë.<sup>238</sup> Dëshmitari K së bashku me Dëshmitarin M u transportuan jashtë kampit në Kukës.<sup>239</sup>
137. Prej Kukësit Dëshmitari K dhe Dëshmitari M fillimisht u dërguan me veturë në Krume. Gjatë udhëtimit, ushtarët e UÇK-së i kishin thënë Dëshmitarit M se do ta vrisnin.<sup>240</sup> U ndalën shkurt në Krume ku Haki Hajdari, i cili u prezantua si "Komandant Drenica" udhëzoi ushtarët e UÇK-së të dërgonin Dëshmitarin K dhe Dëshmitarin M në Cahan.<sup>241</sup> Pastaj Dëshmitari K dhe Dëshmitari M u dërguan me veturë në kampin e UÇK-së në Cahan.<sup>242</sup> Ishte kjo më apo rreth datës 17 prill 1999.<sup>243</sup>
138. Dëshmitari N po jetonte në [REDAKTUAR] më 1999.<sup>244</sup> Ai dhe e shoqja e tij ishin anëtarë të [REDAKTUAR].<sup>245</sup> Dëshmitari N dha dorëheqje nga ky post në mes të prillit të vitit 1999 dhe u largua nga shtëpia e tij së bashku me familjen e tij për shkak se të gjithë shqiptarët e Kosovës po largoheshin nga fshati dhe ai tanimë nuk ndihej më i sigurt.<sup>246</sup> Familja udhëtoi në Shkoder të Shqipërisë ku qëndruan në një fabrikë duhani dhe pas dhjetë ditëve Dëshmitari N ishte thirrur që të merret në pyetje nga tre ushtarë të UÇK-së.<sup>247</sup> Pjesëtarët e UÇK-së e rrahën dhe e pyetën për punësimin e tij dhe [REDAKTUAR] dhe Dëshmitari

<sup>236</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P9-16.

<sup>237</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P18-22.

<sup>238</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P22-24.

<sup>239</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P24-28.

<sup>240</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P33.

<sup>241</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P33.

<sup>242</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P24-28; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P30-35.


<sup>243</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P98-100.

<sup>244</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P1-11.

<sup>245</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P12-17.

<sup>246</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P9-11, 22-25.

<sup>247</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P26-35.



N thirri policinë shqiptare, e cila e arrestoi dhe e ndaloi atë për 24 orë.<sup>248</sup> Me t'u liruuar, Dëshmitari N u kthye në fabrikë dhe pas mesnate arritën pjesëtarë të UÇK-së dhe e arrestuan.<sup>249</sup>

139. Fillimisht UÇK-ja dërgoi Dëshmitarin N në stacionin e policisë shqiptare ku u mbajt deri në mëngjes, pastaj në selinë e UÇK-së në Kukës ku u mbajt për disa orë dhe pas kësaj në Krume.<sup>250</sup> Në Krume, Dëshmitari N ishte rrahur nga tre ushtarë të UÇK-së, të cilët e transportuan deri aty dhe i shtruan pyetje lidhur me familjen e tij dhe pyetën pse nuk ka dhënë dorëheqje nga puna që më parë.<sup>251</sup> Natën, rreth orës 21:00, Dëshmitari N u transferua në kampin në Cahan.<sup>252</sup>

### ***Kushtet e përgjithshme të jetesës për të ndaluarit në kampin e UÇK-së në Cahan***

140. Që të gjithë, Dëshmitari K, Dëshmitari M, Dëshmitari N dhe [REDACTED] janë mbajtur në dhomën e njëjtë të ndalimit në kampin në Cahan. I pari që u soll aty ishte [REDACTED], i cili mbeti i vetëm në dhomë për shtatë ditët e para.<sup>253</sup> Pastaj Dëshmitari K dhe Dëshmitari M u sollën në dhomë.<sup>254</sup> Rreth tre jave më vonë, u soll edhe Dëshmitari N dhe pastaj edhe Dëshmitari O.<sup>255</sup> Derisa këta të ndaluar ishin rregullisht në dhomën e ndalimit, kohë pas kohe u sollën edhe persona të tjerë dhe në një moment, në dhomë ishin deri në 17 persona edhe pse kjo nuk ishte për një kohë të gjatë.<sup>256</sup>
141. Dhoma ishte e vogël dhe e ngushtë, rreth 2x2.5-2.7 metra me një dritare që shkaktonte mjaft rrymim ajri për shkak të xhamit të thyer.<sup>257</sup> Si rezultat i kësaj, brenda në dhomë ishte shumë ftohtë.<sup>258</sup> Dera gjithnjë ishte e mbyllur me çelës.<sup>259</sup>

<sup>248</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P36-44.

<sup>249</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P44-52.

<sup>250</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P44-66.

<sup>251</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P67-72.

<sup>252</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P69, 73-77.

<sup>253</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P124 dhe 129.

<sup>254</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P163-164; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q33, 47, 58, 249-250.


<sup>255</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P128, 170-171; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q83.

<sup>256</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P173-174, 181.

<sup>257</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P98, 123, 175-178; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 Maj 2011, P108-109; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P35-38, 61; Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, faqe 15.

<sup>258</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P61.

<sup>259</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, Q157; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q116; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P110.



142. Në dhomë rridhte aq shumë ujë dhe shi saqë dyshemeja ishte shumë e lagur.<sup>260</sup> Gjatë tre ditëve të para të Dëshmitarit K në dhomë, dyshemeja ishte aq e lagur saqë të ndaluarit nuk mund të shtriheshin për të fjetur.<sup>261</sup> Pas kësaj, një shtresë plastmasi u është dhënë të ndaluarve për të vendosur në dysheme.<sup>262</sup>
143. [REDAKTUAR] flinte në dysheme të betonuar në dhomën e ndalimit, mbi një sfungjer 1 cm të trashë.<sup>263</sup> Ai nuk ishte pajisur me asnjë batanije dhe natën mbulohej me xhaketën e tij.<sup>264</sup> Më vonë, pas ardhjes së të ndaluarve të tjerë, janë sjellë disa batanije.<sup>265</sup> Sidoqoftë, kushtet e fjetjes u përshkruan nga Dëshmitari K si “shumë të rënda.”<sup>266</sup> Dëshmitari K, Dëshmitari M dhe [REDAKTUAR] mblihdeshin së bashku për t’u ngrohur natën, duart e Dëshmitarit K dhe [REDAKTUAR] gjithnjë kanë qenë të lidhura.<sup>267</sup> Në të vërtetë, duart e [REDAKTUAR] kanë qenë të lidhura me njëra-tjetrën për dhjetë ditë.<sup>268</sup>
144. Kishte shumë mospërputhje në mes të dëshmimeve të dëshmitarëve lidhur me çështjen e qasjes në ujë gjatë ndalimit të tyre dhe prandaj nuk është arritur deri te ndonjë përfundim i qartë për këtë çështje. [REDAKTUAR] dëshmoi se kur kërkohet, uji u sillej në dhomën e ndalimit.<sup>269</sup> Dëshmitari M dëshmoi duke thënë se askush nuk kishte guxim të kërkonte ujë dhe se kishin pak qasje në ujë, i cili merrej nga një burim uji që gjendej afër nevojtores.<sup>270</sup> Dëshmitari N dëshmoi duke thënë se janë pajisur me ujë në shishe, mirëpo siç duket, ai po thoshte se ky ujë nuk ishte i pijshëm.<sup>271</sup>
145. Ushqimi u sillej kur edhe vetë ushtarët e UÇK-së hanin ushqimin e tyre.<sup>272</sup>

<sup>260</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 Maj 2011, P108-110; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P109.

<sup>261</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P110-114.

<sup>262</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P110-114.

<sup>263</sup> [REDAKTUAR], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P153-154.

<sup>264</sup> [REDAKTUAR], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P155.

<sup>265</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P108; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P59 dhe 65.

<sup>266</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P231.

<sup>267</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P59-65.

<sup>268</sup> [REDAKTUAR], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P110.

<sup>269</sup> [REDAKTUAR], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P156.

<sup>270</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P144, 150-152, 191-195.

<sup>271</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, Q250-251; procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2011, P169-170.

<sup>272</sup> [REDAKTUAR], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P158-159.



146. Nevojtorja gjendej jashtë dhomës, në fushë dhe kundërmonte mjaft.<sup>273</sup> Të ndaluarit merrnin leje për të shkuar në nevojtoje në mëngjes dhe pasdite.<sup>274</sup> Mirëpo, nuk kanë pasur mundësi të shkonin në nevojtoje rregullisht dhe natën, disa të ndaluar urinonin në shishe plastike.<sup>275</sup> Sipas Dëshmitarit M, të ndaluarit pyetnin “100 herë” që të lejoheshin të shkonin një herë në nevojtoje.<sup>276</sup>
147. Nuk kishte asnjë mundësi që të ndaluarit të laheshin apo pastroheshin.<sup>277</sup> [REDACTED] ishte rruar vetëm një herë për pesë javë ndalim dhe ishte pastruar vetëm një herë për rreth nëntë javë ndalim.<sup>278</sup> Dëshmitari K ishte rruar vetëm një herë për tetë javë ndalim.<sup>279</sup> Të ndaluarit asnjëherë nuk janë pajisur me rrobe të tjera të pastra.<sup>280</sup>
148. Nuk është ofruar asnjë trajtim mjekësor, madje as kur Dëshmitari [REDACTED] u lëndua nga rrahjet<sup>281</sup> edhe pse duhet cekur se Dëshmitari K deklaroi se u janë dhënë barërat sa herë që kanë pasur nevojë.<sup>282</sup>
149. [REDACTED] ishte ndaluar për afërsisht nëntë javë, nga 12 prilli deri më 20 qershor 1999.<sup>283</sup> Dëshmitari K ishte ndaluar për rreth dy muaj.<sup>284</sup> Dëshmitari M ishte ndaluar në Cahan për rreth gjashtë ditë.<sup>285</sup> Dëshmitari N është ndaluar për mbi një muaj.<sup>286</sup>

**Cenim i integritetit trupor të [REDACTED] më 12 prill 1999**

150. [REDACTED] është sjellë nga Kruma në kampin e UÇK-së në Cahan me veturën që voziti Haki Hajdari. Edhe Sabit Geci ishte në veturë. Gjatë vozitjes, Sabit Geci i dha

<sup>273</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, Q144; Dëshmitari K, 16 maj 2011, P108.

<sup>274</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P118.

<sup>275</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q119; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P66, 111-113, 141.

<sup>276</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P190.

<sup>277</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P160; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P120.

<sup>278</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P160.

<sup>279</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P120-122.

<sup>280</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P121.

<sup>281</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P159.


<sup>282</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P219.

<sup>283</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, Q12, 17-26, 122, 232.

<sup>284</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P78.

<sup>285</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P73; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q54 dhe 79; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P183.

<sup>286</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P156.



një shuplakë [REDACTED] dhe i tha “ke jetuar mjaft, ke pasur jetë të mirë.”<sup>287</sup> Me të arritur në kampin e Cahanit, Sabit Geci deklaroi “do të asgjësojmë gjithë [REDACTED] [REDACTED].”<sup>288</sup> Sabit Geci i dha një shuplakë [REDACTED] dhe e goditi edhe me patericë.<sup>289</sup>

151. [REDACTED] ishte vendosur në një dhomë me Sabit Gecin, Riza Alijajn (i njohur si “Komandant Hoxha”) dhe me dikë të quajtur “Fatmir”.<sup>290</sup> Haki Hajdari po hynte dhe po dilte nga dhoma.<sup>291</sup> Sabit Geci deklaroi se [REDACTED] duhet të tërhiqet apo t’ia linte [REDACTED] dhe kërcënoi “ne të gjithë do t’ju vrasim”.<sup>292</sup> Sabit Geci i dha një shuplakë [REDACTED] dhe e goditi me patericë. Riza Alija filloi të godiste [REDACTED] me shkop apo me një copë druri dhe të paktën një herë e goditi në mjekër.<sup>293</sup> Gjatë kësaj rrahje, [REDACTED] kishte gjakderdhje të rëndë dhe u paralizua.<sup>294</sup> Dikur, [REDACTED] humbi vetëdijen dhe Fatmiri e solli në vete duke i hedhur një kovë me ujë.<sup>295</sup> Me të ardhur [REDACTED] në vete, ai dëgjoi Sabit Gecin duke i thënë Riza Alijajt se duhet t’ia jepnin [REDACTED] SHIK-ut që ta ekzekutonte.<sup>296</sup> Sabit Geci poashtu tha se duhet të kërkojnë [REDACTED] “te porta e verdhë” për t’ia vrarë.<sup>297</sup> Në atë kohë, [REDACTED] po qëndronte në një shtëpi që kishte një portë të verdhë.<sup>298</sup> Sabit Geci po ashtu tha se tanimë kishin vrarë Ahmet Krasniqin, Enver Malokun dhe Sabri Hamitin.<sup>299</sup> Pastaj [REDACTED] ishte dërguar në një dhomë tjetër.<sup>300</sup>

152. Kur Dëshmitari K dhe Dëshmitari M u sollën në fillim në dhomën e ndalimit, ata vunë re se tanimë [REDACTED] ishte keqtrajtuar rëndë, kishte gjak në këmbë për shkak të lëndimit aty dhe një plagë tjetër në kokë. Fytyrën, kokën dhe duart i kishte përplot mavijosje.<sup>301</sup>

<sup>287</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P41-47, 48-55, 60.

<sup>288</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P60.

<sup>289</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P60.

<sup>290</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P61-68.

<sup>291</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P102.

<sup>292</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P69.

<sup>293</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P69-70.

<sup>294</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P70, 78-79.

<sup>295</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P80-81.

<sup>296</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P82, 98.

<sup>297</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P83.

<sup>298</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P83-89.

<sup>299</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P83 dhe 105.

<sup>300</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P98.

<sup>301</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q59-62; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P35-39, 107; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P165.



153. Sipas Dëshmitarit K, Sabit Geci hynte në dhomën ku po mbaheshin dhe e shtyente [REDACTED] me patericë.<sup>302</sup> Siç duket, kishte mjaft dashaligësi nga Sabit Geci drejt [REDACTED] dhe Geci akuzonte [REDACTED] për përfshirje në vdekjen e kunatit të tij.<sup>303</sup>
154. Dëshmitari N dëshmoi duke thënë se kur në fillim u dërgua në dhomën e ndalimit në kampin në Cahan (gjë e cila ndodhi rreth javës së parë të majit të vitit 1999), ai pa që [REDACTED] ishte rrahur rëndë dhe se kishte të çara dhe mavijosje në kokë.<sup>304</sup> [REDACTED] i tha Dëshmitarit N se e kishte rrahur Sabit Geci.<sup>305</sup>
155. Dëshmitarit N po ashtu u kujtua se [REDACTED] kërcënohej verbalisht nga UÇK-ja derisa ishte në dhomën e ndalimit.<sup>306</sup> Herën e parë që Dëshmitari N pa Sabit Gecin, Geci erdhi në dhomën e ndalimit, u tha të ndaluarve se do të kalbeshin aty dhe kërcënoi veçanërisht [REDACTED].<sup>307</sup> Herën e dy që Dëshmitari N pa Sabit Gecin, ky i fundit erdhi në dhomën e ndalimit dhe kërcënoi [REDACTED] duke përmendur portën e verdhë në [REDACTED] ku po jetonte i [REDACTED].<sup>308</sup>

### *Tortura më 3 maj 1999 e Dëshmitarit N*

156. Kur u soll Dëshmitari N në kampin në Cahan, ai iu dorëzua Haki Hajdarit (i njohur si “Haki Drenica”), Sali Rexhepit dhe Shaban Hotit dhe u dërgua në bodrum ku e rrahën dhe e morrën në pyetje.<sup>309</sup> [Dëshmitari dëshmoi se Xhavit Halili ishte ai që e solli aty dhe udhëzoi të tjerët që ta marrin në pyetje, por pasi që nuk është i pandehur në këtë shqyrtim kryesor, Trupi Gjykues nuk gjeti ndonjë gjetje specifike faktike sa i përket identitetit të tij. Haki Hajdari, Sali Rexhepi dhe Shaban Hoti së bashku me ushtarë të tjerë të panjohur të UÇK-së i lidhën duart Dëshmitarit N, i larguan çorapet dhe e rrahën në shputa të këmbëve me shkopinj druri derisa ky vuri re se kishte humbur vetëdijen.<sup>310</sup> Pasi që erdh në vete, e rrahën sërish për rreth një orë.<sup>311</sup> Gjatë dy episodeve të rrahjeve, UÇK-ja duke përfshirë tre të pandehurit i shtroi pyetje

<sup>302</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q77.

<sup>303</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P69-71, 182-183.

<sup>304</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P127-133.

<sup>305</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P132-133.

<sup>306</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P129.


<sup>307</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P150-152.

<sup>308</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P194-201.

<sup>309</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P76-83.

<sup>310</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P82-88.

<sup>311</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P87.



Dëshmitarit N lidhur me punësimin e tij, përfshirjen e tij [REDACTED], detaje për organizatën [REDACTED], dhe praninë e ushtarakëve serbë në [REDACTED].<sup>312</sup>

157. Pas kësaj rrahjeje dhe marrje në pyetje, Dëshmitari N u soll në dhomën e ndalimit, në kat të dytë ku po mbaheshin [REDACTED], Dëshmitari K dhe Dëshmitari O.<sup>313</sup> Dëshmitari K dhe [REDACTED] dëshmuan se Dëshmitari N ishte rrahur para se të sillej në dhomën e ndalimit dhe kishte lëndime të dukshme.<sup>314</sup> [REDACTED] ka dëgjuar britmat e Dëshmitarit N para se të sillej ky i fundit në dhomë dhe ishte edhe dëshmitar i vazhdimit të rrahjes së tij derisa u futën në dhomë.<sup>315</sup> Ushtarët e UÇK-së vetëm lëshuan Dëshmitarin N te këmbët e [REDACTED] dhe Dëshmitarit K.<sup>316</sup> Arsyeja e dhënë për këtë trajtim ishte se Dëshmitari N kishte marrë pjesë në një takim të partisë politike [REDACTED].<sup>317</sup>

#### ***Tortura më 9 maj 1999 e Dëshmitarit N***

158. Dëshmitari N konfirmoi se është rrahur për herë të dytë, pra 8-9 ditë pas rrahjes së parë, edhe pse nuk është i sigurt kur saktësisht ka qenë kjo.<sup>318</sup> Ai është dërguar në katin poshtë qelisë së ndalimit dhe është rrahur nga një person që kishte të veshur uniformë të zezë të UÇK-së. Në moment të caktuar, Dëshmitari N duket se sugjeron se personi përgjegjës për rrahjen e tij të dytë ishte një ushtarë femër, por më vonë thotë se ishte ushtar mashkull.<sup>319</sup> Në këtë rast, Dëshmitari N është rrahur me pushkë druri (apo model të drunjte pushke) derisa dy apo tre ushtarë të tjerë të UÇK-së qëndronin duke shikuar.<sup>320</sup>
159. Pas dhënies së kësaj dëshmie, Dëshmitari N u ballafaqua nga prokurori me deklaratën e tij të mëparshme dhënë prokurorit më 10-16 mars 2010, ku kishte deklaruar se është rrahur nga një njeri me uniformë të zezë UÇK-je me një copë druri që i ngjasonte një

<sup>312</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P89-99.

<sup>313</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P117-126.

<sup>314</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P83-84; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P170-172, 196-200.

<sup>315</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P170-172, 196-200.


<sup>316</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P83-84.

<sup>317</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P84-86.

<sup>318</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P158 -162; procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit 10-16 March 2010, p28.

<sup>319</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, Q159-160, 163.

<sup>320</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, Q158-167.



pushke dhe se Sali Berisha, Shaban Hoti dhe një person i tretë, i panjohur ishin të pranishëm dhe i shtroheshin pyetje derisa po rrahej.<sup>321</sup> Prokurori poashtu ballafaqoi Dëshmitarin me një paragraf nga deklarata e tij e mëparshme dhënë prokurorit më 2 dhjetor 2010, ku lidhur me rrahjen e dytë ai ka thënë, “kësaj rradhe, më rrahu një person i panjohur. Por më kujtohet që Sali Berisha dhe Shaban Hoti ishin të pranishëm dhe më shtronin pyetje derisa ky tjetri më rrihte.” Në këto paragrafë, Dëshmitari N mohon të ketë parë Haki Drenicën (Haki Hajdarin) gjatë rrahjes së dytë.<sup>322</sup> Në përgjigje ndaj këtij ballafaqimi, Dëshmitari N u përgjigj duke thënë se i kujtohen që të dy rastet kur është rrahur dhe se në rastin e dytë, Sali Berisha, Shaban Hoti dhe Haki Drenica ishin të pranishëm, por nuk qëndruan për të parë rrahjen, vetëm erdhën dhe shkuan.<sup>323</sup> Me t’u ballafaquar akoma më shumë nga ana e prokurorit lidhur me çështjen se cilët ishin të pranishëm, kishte kundërshtime në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshminë të dhënë me gojë gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me çështjen se a e ka parë Dëshmitari N Haki Drenicën gjatë kësaj rrahjeje, Dëshmitari N u përgjigj se “më kujtohet mirë se kam qenë i rrahur keq, jam tmerruar dhe thjeshtë nuk ua ta rikujtoj”<sup>324</sup> dhe “i pashë këta dy [duke iu referuar Sali Berishës dhe Shaban Hotit] në dhomë, por ishte shumë errësirë dhe nuk kam mundur të përcaktoj me saktësi kush tjetri.”<sup>325</sup>

160. Pastaj Dëshmitari N vazhdoi të japë një përshkrim të detalizuar të rrahjes që iu nënshtrua ai, përfshirë rrahjen nëpër këmbë, marrjes në pyetje gjatë rrahjes dhe si pasojë e rrahjes, e lëshoi këmbë dhe është dashur të ekzaminohej nga mjeku, kishte dhimbje dhe enjtje në fytyrë dhe kishte ngjyrën “bojë e kaltër shkrimi”<sup>326</sup>. Duhet vënë re se në asnjë fazë të procedurës, Dëshmitari N nuk sugjeron se ndonjëherë ka qenë i pranishëm ndonjë dëshmitar tjetër i rrahjes së dytë.
161. Për shkak të deklaratave jokoherente dhe konfuze lidhur me detalet e asaj që ndodhi në këtë rast, provat përcaktojnë vetëm se Dëshmitari N vërtetë i është nënshtruar edhe një rrahjeje tjetër më apo rreth 9 maj 1999. Mirëpo, nuk mund të bëhet ndonjë gjetje

<sup>321</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 Maj 2011, P168; procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, 10-16 mars 2010 faqe 28.


<sup>322</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 Maj 2011, P168; procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, 02 dhjetor 2010, faqe 4.

<sup>323</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P168.

<sup>324</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P169.

<sup>325</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P171.

<sup>326</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P172-179.



tjetër faktike sa i përket këtij incidenti, si për shembull, kush ka qenë i pranishëm, kush kreu rrahjen dhe a e morri dikush në pyetje Dëshmitarin N gjatë rrahjes, dhe nëse po, atëherë kush.

**Cënimi i integritetit trupor të dëshmitarëve K, M, N, O dhe [REDACTED]**

162. Gjatë kohës së ndalimit të tyre në kampin në Cahan, të gjithë Dëshmitari K, Dëshmitari M, Dëshmitari N, Dëshmitari O dhe [REDACTED] iu nënshtruan rrahjeve dhe keqtrajtimeve të ndryshme më shumë se një herë.
163. Gjatë kohës së ndalimit të [REDACTED] në kamp, ai iu nënshtrua dy rrahjeve të rënda nga Riza Alija.<sup>327</sup> Në episodin e parë, [REDACTED] kërkoi leje nga roja për të shkuar në nevojtorë. Duart akoma i kishte të lidhura së bashku.<sup>328</sup> Derisa [REDACTED] po kthehej nga nevojtorja, Riza Alija filloi ta rrihte me këpucë të rëndë.<sup>329</sup> [REDACTED] ra në tokë dhe humbi vetëdijen.<sup>330</sup> Me të ardhur në vete, [REDACTED] ndjeu dhimbje në gjithë trupin dhe kishte gjak të freskët në fytyrë.<sup>331</sup>
164. Në episodin e dytë, [REDACTED] sërish po kthehej nga nevojtorja në dhomën e ndalimit kur Riza Alija filloi t'a rrihte.<sup>332</sup>
165. Përpos këtyre dy episodeve me rrahje të rënda, [REDACTED] kohë pas kohe iu nënshtrua rrahjeve më pak të rënda shkaktuar nga ushtarët e tjerë të UÇK-së gjatë kohës kur po shkonte dhe po kthehej nga nevojtorja.<sup>333</sup> [REDACTED] i shtroheshin pyetje gjatë kohës që po e rrihnin, pyetej se kush ishte dhe se çfarë pune kishte. Në një moment të caktuar, ishte udhëzuar të shkruante arsyen pse UÇK-ja e arrestoi.<sup>334</sup>
166. Dëshmitari K konfirmoi se në fillim të qëndrimit të tyre në ndalim, disa të ndaluar rriheshin gjatë rrugës për në nevojtorë.<sup>335</sup> Kur është sjellë Dëshmitari N në dhomën e

<sup>327</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P126, 130-146.

<sup>328</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P132.

<sup>329</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P132-135.

<sup>330</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P136.


<sup>331</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P136-137.

<sup>332</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P141.

<sup>333</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P147-152.

<sup>334</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P207-208.

<sup>335</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P211-212.



ndalimit, pra diku në ditët e para të majit të vitit 1999, ai pa që [REDACTED] ishte “i tmerruar” dhe se ishte rrahur. Kishte prerje dhe mavijosje të kuqe në kokë.<sup>336</sup>

167. Në fillim kur u dërguan Dëshmitari K dhe Dëshmitari M në kampin në Cahan më apo rreth datës 16 prill 1999, u janë dorëzuar dy policëve të UÇK-së dhe Riza Alijajt.<sup>337</sup> Ata menjëherë filluan të goditnin dhe të grushtonin Dëshmitarin K dhe Dëshmitarin M.<sup>338</sup> Riza Alija po i godiste me një shufër hekuri dhe vazhdoi t’i rrihte derisa këta vrapuan një katë shkallë dhe u futen në dhomën e ndalimit.<sup>339</sup> Dëshmitari M është rrahur më shumë se Dëshmitari K gjatë rrugës për në dhomën e ndalimit.<sup>340</sup>
168. [REDACTED] veç ishte brenda në dhomën e ndalimit kur arritën Dëshmitari K dhe Dëshmitari M dhe kur pa Riza Alijajn duke i rrahur .<sup>341</sup> Në atë kohë, Dëshmitari K, Dëshmitari M dhe [REDACTED] i kishin duart e lidhura.<sup>342</sup> Riza Alija vazhdoi t’a rrihte Dëshmitarin K and Dëshmitarin M brenda në dhomën e ndalimit për pothuajse edhe dy minuta, duke i goditur të paktën gjashtë deri në shtatë herë.<sup>343</sup> Dëshmitari M është rrahur aq keq sa që humbi vetëdijen dhe ra në dysheme.<sup>344</sup> Edhe [REDACTED] po ashtu është goditur të paktën një herë prej një ushtari të UÇK-së.<sup>345</sup> Gjatë kësaj rrahjeje, ushtarët e UÇK-së ofendonin të ndaluarit dhe i quanin “spiunë”.<sup>346</sup> Ky është i vetmi incident gjatë së cilit është rrahur Dëshmitari K.<sup>347</sup>
169. Më vonë gjatë kësaj ditë, Dëshmitari K dhe Dëshmitari M ishin dërguar poshtë për t’u intervistuar. Haki Hajdari po priste në dhomën e marrjes në pyetje dhe u prezantua si

<sup>336</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P127-131.

<sup>337</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P24-30, 43.

<sup>338</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P31-33; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P35.

<sup>339</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P35; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P31-42, 47, 199-201, 253.

<sup>340</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, Q57.

<sup>341</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 Maj 2011, P33 dhe 58; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P163-169, 186-19; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P38.

<sup>342</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P36-39.


<sup>343</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, Q33-41; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 Maj 2011, Q191; Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P41.

<sup>344</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P35.

<sup>345</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P36.

<sup>346</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P40.

<sup>347</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P46; [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P192.



komandant i të gjithë ushtarëve.<sup>348</sup> Haki Hajdari fillimisht filloi të merrte në pyetje Dëshmitarin K, por ndaloi kur kuptoi që Dëshmitari K punonte në [REDACTED].<sup>349</sup>

170. Pastaj Haki Hajdari filloi të intervistojë Dëshmitarin M.<sup>350</sup> Riza Alija ishte i pranishëm kur filloi marrja në pyetje.<sup>351</sup> Haki Hajdari pyeti Dëshmitarin M për arsyen pse është bërë “spion” dhe i kërkoi emrat e bashkëpunëtorëve serbë.<sup>352</sup> Haki Hajdari i dha një laps dhe një letër dhe e udhëzoi që të jepte deklaratë me shkrim.<sup>353</sup> Në një moment të caktuar gjatë intervistimit të Dëshmitarit M, Dëshmitari K ishte larguar nga dhoma.<sup>354</sup>
171. Kur ishte sjellë Dëshmitari N në dhomën e ndalimit, pra rreth javës së parë të muajit maj, ai pa që [REDACTED], Dëshmitari K dhe Dëshmitari O ishin rrahur para se të vinte ai. Kishin mavijosje nëpër kokë dhe ishin të enjtur.<sup>355</sup>
172. Edhe Dëshmitari N iu nënshtrua keqtrajtimit më tutje. Sipas Dëshmitarit K, Dëshmitari N shpesh ishte keqtrajtuar në dhomën e ndalimit dhe “kushdo që vinte në dhomë e godiste” përfshirë edhe Riza Alijajn.<sup>356</sup> Si rezultat i keqtrajtimit, Dëshmitari N kishte vështirësi në lëvizje dhe nuk mund të qëndronte siç duhet në këmbë.<sup>357</sup>
173. Më apo rreth datës 25 apo 26 maj 1999, Shaban Hoti dhe Riza Alija kishin hyrë në dhomë dhe kishin sjellur me vete edhe një femër. Riza Alija qëndroi te dera derisa Shaban Hoti ishte brenda në dhomë. Riza Alija udhëzoi femrën të rrihte të ndaluarit dhe pastaj Riza Alija dhe Shaban Hoti shikuan derisa femra rrahu [REDACTED] dhe Dëshmitarin N me një shkop.<sup>358</sup>
174. [REDACTED] dëgjoji britmat e Dëshmitarit O para se të sjellej në dhomën e ndalimit. Me t’u sjellë brenda, Dëshmitari O kishte lëndime nga rrahja dhe këmbët i kishte shumë

<sup>348</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P48-49.

<sup>349</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P50.

<sup>350</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P50-51; Dëshmitari M, 19 maj 2011, P42-45.

<sup>351</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P44.

<sup>352</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P42-45.

<sup>353</sup> Dëshmitari M, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 19 maj 2011, P48-50; Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P50-51.


<sup>354</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P50-51.

<sup>355</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P127-131.

<sup>356</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P87-92.

<sup>357</sup> Dëshmitari N, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 maj 2011, P197-199.

<sup>358</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P201-202, 225-228, 265.



të mavijosura.<sup>359</sup> Dëshmitari O i tha [REDACTED] se Riza Alija dhe të tjerët e kishin rrahur pasi që e kishin akuzuar se i është bashkangjitur FARK-ut.<sup>360</sup>

175. Sipas Dëshmitarit K, Riza Alija i keqtrajtonte dhe i rrihte të ndaluarit kur vinin në fillim në kamp.<sup>361</sup>

**“Gjykimi” i [REDACTED] dhe Dëshmitarit N**

176. Rreth datës 20 maj 1999, [REDACTED] i është treguar një akuzë me shkrim nga anëtari i UÇK-së Sali Rexhepi (i njohur si “Sali Berisha”). Akuza shkruante si në vijim “adhurues i Kryetarit Rugova, personit që organizon përqindjen (*shënim i përkthyesit: si në origjinal*) falas për Kosovën. Shok i Ahmet Krasniqit, i cili po vriste në Tiranë, vëllai i [REDACTED], udhëheqës të [REDACTED], dhe shok i shtatë vëllezërve.”<sup>362</sup> Pastaj [REDACTED] dhe Dëshmitari N u dërguan nga Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi në një gjykatë në Kukës dhe u vendosën në dhoma të ndryshme.<sup>363</sup>

177. Një gjykatës hyri në dhomën në të cilën ishte [REDACTED], lexoi akuzën me shkrim kundër tij dhe pastaj foli me [REDACTED].<sup>364</sup> Ai i tha se sa i përket atij, [REDACTED] është i lirë.<sup>365</sup> Gjykatësi liroi edhe Dëshmitarin N.<sup>366</sup>

178. Kur erdhën Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi për të marrë [REDACTED] dhe Dëshmitarin N, atyre u tha një zyrtar i policisë në gjykatë se [REDACTED] dhe Dëshmitari N duhen liruar.<sup>367</sup> Haki Hajdari hezitoi paksa dhe vendosi të mos lironte [REDACTED] dhe Dëshmitarin N, por t’i kthente në kampin e UÇK-së në Cahan.<sup>368</sup> Me t’u kthyer në dhomën e ndalimit, Dëshmitari K u ngushëllua shumë ngase Riza Alija i kishte thënë atij se UÇK-ja kishte ekzekutuar [REDACTED] dhe Dëshmitarin N.<sup>369</sup>

<sup>359</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P182, 203.

<sup>360</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P204-206.

<sup>361</sup> Dëshmitari K, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 maj 2011, P107.

<sup>362</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P209-210.

<sup>363</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P209-P213.

<sup>364</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P213-214.


<sup>365</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P214.

<sup>366</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P214

<sup>367</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P214-215.

<sup>368</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P214-216.

<sup>369</sup> [REDACTED], procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P218-219.



## VI. VLERËSIMI I PROVAVE: identifikimi i të pandehurve

179. Të gjithë të pandehurve, përpos Shaban Hotit u është referuar me nofka që kanë përdorur në kohët përkatëse dëshmitarët. Mirëpo, identiteti dhe pozita e secilit të pandehur është përcaktuar me anë të provave.

### *Identifikimi i Sabit Gecit në kampin e UÇK-së në Kukës*

180. Dëshmitari A njohu Sabit Gecin para arrestimit të tij dhe para ndalimit të tij në Kukës, ai poashtu e identifikoi përmes rradhitjes së fotografive.<sup>370</sup> Dëshmitari A rikujtoi se si Sabit Geci erdhi në dhomën e parë ku po mbahej Dëshmitari A (atë me tavan të ulët) 1-2 ditë pas vendosjes së tij aty. Ai kishte të veshur uniformë, ishte i armatosur me armë dhe ishte me paterica. Edhe pse njihnin njëri-tjetrin nga më parë, Geci u prezantua me emër dhe deklaroi se ishte “komandanti”.<sup>371</sup>
181. Dëshmitari B njohu Sabit Gecin në kampin në Kukës për shkak se që të dy kishin qenë në [REDAKTUAR] së bashku.<sup>372</sup> Dëshmitari B identifikoi Sabit Gecin nëpërmjet rradhitjes së fotografive në Zyrën e Prokurorit Publik më 23 tetor 2009.<sup>373</sup> Dëshmitari B ka qenë [REDAKTUAR] nga viti 1992 deri në fund të vitit 1995 dhe gjatë kësaj kohe, ai dhe Sabit Geci ishin në [REDAKTUAR] e njëjta për të paktën një vit.<sup>374</sup> Për herë të fundit, Dëshmitari B pa Sabit Gecin në Kukës një ditë para se të vdiste [REDAKTUAR] dhe ai kishte dëgjuar se Geci kishte qenë i përfshirë në një aksident trafiku 3-4 ditë më vonë.<sup>375</sup>
182. Që të dy, Dëshmitari A dhe Dëshmitari B rikujtuan se në Kukës, Sabit Geci kishte nofkën “Qopa” që do të thotë “Sakati”.<sup>376</sup>

<sup>370</sup> Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 10 qershor 2011, P85; EULEX NJHKL Raporti i Procedurës identifikuese me anë të fotografive (Dëshmitari A) datuar 27 tetor 2009.

<sup>371</sup> Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P39-44; Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 21 mars 2011, P254-258; Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 23 mars 2011, P33-34.


<sup>372</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 mars 2011, faqe 17.

<sup>373</sup> Raporti i Procedurës identifikuese me anë të fotografive (Dëshmitari B) datuar 23 tetor 2009.

<sup>374</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 mars 2011, faqe 17; procesverbal i shqyrtimit kryesor, 24 mars 2011, P51-54, 59.

<sup>375</sup> Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 24 mars 2011, P40 dhe 42.

<sup>376</sup> Dëshmitari A, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 qershor 2011, P99; Dëshmitari B, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 16 mars 2011, faqe 17.



183. Gjatë intervistimit të tij nga ana e prokurorit më 2010, Dëshmitari G deklaroi se në vitin 1999 Sabit Geci kishte paterica në kampin në Kukës.<sup>377</sup> Flokët e thinjura i mbante të krehura pas.<sup>378</sup> Dëshmitari G identifikoi Sabit Gecin nga rradhitja e fotografive.<sup>379</sup>
184. Dëshmitari H për herë të parë mësoi emrin Sabit Geci derisa ishte në dhomën e ndalimit me Dëshmitarin A.<sup>380</sup> Ai pa Gecin vetëm dy herë: gjatë natës kur u torturua i gjithë grupi (19 maj 1999) dhe gjatë ditës kur u lirua nga paraburgimi (1 qershor 1999).<sup>381</sup> Nuk duket se është bërë ndonjë përpjekje për të bërë procedurën e identifikimit me fotografi për Dëshmitarin H.
185. Trupi Gjykues poashtu vë re se në fjalën e tij përfundimtare, Sabit Geci pohoi praninë në kampin në Kukës, edhe pse e kufizoi praninë në dy herë nga 10 dhe 20 minuta dhe pohoi të ketë parë dëshmitarët A dhe B.<sup>382</sup> Në fakt, ai pohoi se kishte hyrë në një qeli ku ishte Dëshmitari A dhe kishte deklaruar “unë jam Sabit Geci”.<sup>383</sup>
186. Dëshmitari C dhe Dëshmitari F nuk ia dolën të identifikojnë Sabit Gecin përmes rradhitjes me fotografi. Në rastin e Dëshmitarit C, siç u sqarua më lart, për shkak të truamave fizike dhe psikike që ka përjetuar ajo në ndalim, rrahjet dhe ████████ në kampin në Kukës, Dëshmitari C i ka larguar këto nga kujtesa e saj sa më shumë që ka mundur. Sa i përket kësaj, pesha e pamundësisë që këta dy dëshmitarë të identifikojnë Sabit Gecin në fotografi zvogëlohet nga identifikimet pozitive nga Dëshmitarët A, B, dhe G dhe nga pohimi i vetë Sabit Gecit. Trypi Gjykues lirisht arrin te përfundimi se prania e Sabit Gecit në kampin në Kukës është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe se referimet e dëshmitarëve Sabit Gecit për incidentet janë të sakta.

<sup>377</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G), 4 mars 2010, faqe 10.

<sup>378</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G), 4 mars 2010, faqe 11.


<sup>379</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G), 4 mars 2010, faqe 11; Procedura për identifikim përmes fotografive (Dëshmitari G) datuar 4 mars 2010.

<sup>380</sup> Dëshmitari H, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 31 mars 2011, Q91-93; procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 prill 2011, P97.

<sup>381</sup> Dëshmitari H, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 31 mars 2011, P21 dhe 28; procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 prill 2011, P148-149, 155.

<sup>382</sup> Sabit Geci, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 korrik 2011, faqe 7-8.

<sup>383</sup> Sabit Geci, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 korrik 2011, faqe 8.



## *Pozita dhe Kompetenca e Sabit Gecit në kampin e UÇK-së në Kukës*

187. Dëshmitari A pa Sabit Gecin në fillim kur ishte arrestuar dhe pastaj dy apo tre herë në kampin e Kukësit. Dëshmitari A beson se Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci ishin komandantët me gradën më të lartë të pranishëm në kamp, ndonëse Krasniqi ishte komandant i kampit.<sup>384</sup>
188. Dëshmitari B pa Sabit Gecin për herë të parë në ditën e pestë të ndalimit të tij në kampin e Kukësit, kur ai ishte marrë nga depoja dhe ishte vendosë në një dhomë.<sup>385</sup> Ai nuk mund të mban në mend numrin e përgjithshëm të rasteve ku kishte parë Gecin gjatë gjithë ndalimit të tij në Kukës, megjithatë beson se ishte pesë apo gjashtë herë.<sup>386</sup> Në takimin e parë Geci i thotë Dëshmitarit B se ai ishte “udhëheqës me gradë shumë të lartë” dhe ishte e qartë se Geci kishte pushtet në atë kohë, askush nuk mund t’i kundërvihet atij<sup>387</sup> dhe se ishte shumë i njohur gjatë luftës. Dëshmitari B besonte se Geci i përkiste njësisë speciale apo policisë ushtarake të UÇK-së. Ai kishte të veshur uniformë Amerikane dhe çizme.<sup>388</sup>
189. Kur Geci prezantoi veten si komandant, ai nuk tha se cilën njësi ai komandonte.<sup>389</sup> Dëshmitari B mund të shihte se Geci kishte kompetencë t’i jep urdhra tjerëve, dhe ishte për shkak të kësaj dhe për shkak se Geci ishte ai që merrte në pyetje të ndaluarit, Dëshmitari B kuptoi se Geci ishte komandant i të dyjave, policisë ushtarake dhe zbulimit.<sup>390</sup> “E vërteta ishte se Sabit Geci ishte burri kryesor atje dhe fjala e tij ishte ligj.”<sup>391</sup> Dëshmitari B përshkruan të jetë rrahur dhe keqtrajtuar në disa raste. Sabit Geci nuk ishte i pranishëm në secilin incident dhe ishte përshkruar nga Dëshmitari B si “ishte ai që jepte urdhra”.<sup>392</sup> Dëshmitari B kishte përshtypjen se të dy Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi ishin ata që u jepnin urdhra ushtarëve të tjerë të UÇK-së për të rrahur apo për të ndaluar rrahjen e të ndaluarve. Njëri apo tjetri ishte gjithmonë i

<sup>384</sup> Dëshmitari A, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 19 qershor 2011, P69-70.

<sup>385</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P20.

<sup>386</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P23.

<sup>387</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P254-258.


<sup>388</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P32-35.

<sup>389</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P44, Q47.

<sup>390</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P44-47.

<sup>391</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 23 mars 2011, P131.

<sup>392</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P110-112.



pranishëm në dhomë gjatë rrahjeve.<sup>393</sup> Dëshmitari B kishte poashtu përshtypjen se në bazë të sjelljes së Sabit Gecit, mënyrës se si ai trajtonte ushtarët e tjerë, dhe se si këta reagonin ndaj tij, se nuk kishte oficer me gradë më të lartë në Kukës se sa Sabit Geci.<sup>394</sup> Ai kishte pushtet dhe askush nuk mund t'i kundërvihet.<sup>395</sup> Sipas Dëshmitarit B, policia ushtarake e UÇK-së e cila ka kryer rrahjet ka mundur të hyjë në dhomën e ndalimit vetëm kur ka qenë e shoqëruar nga Sabit Geci ose Xhemshit Krasniqi, dhe ata rrihnin të ndaluarit nën urdhër të Gecit apo Krasniqit.<sup>396</sup>

190. Sipas Dëshmitarit G, Sabit Geci ishte anëtar i shërbimit të sigurisë në UÇK. Edhe pse kishte komandant të shtabit, Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci ishin përgjegjës për çdo gjë që ndodhte në shtab.<sup>397</sup> Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi kishin shumë autoritet, madje edhe mbi të gjithë të burgosurit.<sup>398</sup>
191. Edhe pse Trupi Gjykes nuk mund të përcaktojë me saktësi gradën e saktë të Sabit Gecit, provat në tërësi e bëjnë të qartë se ai ka qenë anëtar i lartë i UÇK-së dhe se ka pasur autoritet mbi ushtarët nën të.

### ***Identifikimi i Sabit Gecit në kampin e UÇK-së në Cahan***

192. ████████ për herë të parë takoi Sabit Gecin në një xhami në Krumë të Shqipërisë.<sup>399</sup> Geci ishte me paterica dhe u prezantua si “Sabit Geci, Shef i Policisë Sekrete të Policisë”.<sup>400</sup> ████████, i cili ishte i vetmi palë e lënduar/viktimë që ka dhënë dëshmi në sallë të gjykimit, ia doli të identifikojë Sabit Gecin në sallë të gjykimit.<sup>401</sup> Për më tepër, gjatë fjalës së tij përfundimtare, Sabit Geci pranoi të ketë qenë i pranishëm një herë në kampin në Cahan dhe të ketë hyrë në një dhomë ku gjendej ████████ dhe të ketë pasur një bisedë me të.<sup>402</sup>

<sup>393</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P236-247.

<sup>394</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P 254-258.

<sup>395</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P255-258.

<sup>396</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P228-234, 239-247.

<sup>397</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G), 4 mars 2010, faqe 10.


<sup>398</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në prokurori (Dëshmitari G), 4 mars 2010, faqe 12.

<sup>399</sup> ████████, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P29, 34-40.

<sup>400</sup> ████████, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P29, 37-40.

<sup>401</sup> ████████, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 4 maj 2011, P266-268.

<sup>402</sup> Sabit Geci, procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 korrik 2011, faqe 8-9.



193. Dëshmitari K ka takuar Sabit Gecin për herë të parë në kampin e UÇK-së në Cahan. Ai përshkroi Sabit Gecin si person me trup të fuqishëm dhe me paterica.<sup>403</sup> Sabit Geci nuk i kishte treguar Dëshmitarit K emrin e tij, megjithatë Dëshmitari K ia kishte marrë vesh emrin atij nga të tjerët, përfshirë edhe nga [REDACTED].<sup>404</sup>
194. Dëshmitari N nuk e kishte njohur Sabit Gecin para vitit 1999, megjithatë ai e kishte parë atë dy herë në kampin e Cahanit. Herën e parë, e cila ishte 3-4 ditë pasi Dëshmitari N ishte rrahur për herë të parë (më apo rreth datës 03 maj 1999), Geci kishte të veshur një kostum sportiv, ishte futur në dhomën e ndalimit dhe kishte deklaruar emrin e tij.<sup>405</sup> Dëshmitari N përshkroi Sabit Geci si jo shumë të madh, me peshë mesatare, me flokë të krehura nga lart dhe prapa, dhe i mbështetur në paterica.<sup>406</sup>
195. Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve mbi Sabit Gecin dhe pranimit nga vetë Sabit Geci, Gjykata është siguruar se ai ka qenë i pranishëm në kampin e Cahanit në kohë të caktuara gjatë kohës relevante.

### ***Pozita dhe Autoriteti i Sabit Gecit në Kampin e UÇK-së në Cahan***

196. [REDACTED] ka dëshmuar se dy personat civilë të cilët u arrestuan dhe u dërguan në Cahan me të, u lanë të lirë nga Sabit Geci.<sup>407</sup> [REDACTED] kishte kuptuar se Geci ishte shefi i policisë kryesore të UÇK-së.<sup>408</sup> Afërsisht rreth fundit të majit 1999, Riza Alija i kishte thënë [REDACTED] se ai kishte folur me Sabit Gecin në Kukës dhe se personat e ndaluar nuk duhet të rriheshin më.<sup>409</sup> Atëherë trajtimi i personave të ndaluar u përmirësua dhe ata nuk u rrahën më.<sup>410</sup> Sabit Geci erdhi në kampin e Cahanit afërsisht gjashtë javë pas ndalimit të [REDACTED] dhe kishte pyetur personat e ndaluar

<sup>403</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P72-74.

<sup>404</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P 241-243.

<sup>405</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P134-136, 141-148.


<sup>406</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P 144.

<sup>407</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P117-118.

<sup>408</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P119.

<sup>409</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P222.

<sup>410</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P222.



se si ishin.<sup>411</sup> Kur kishin qenë të ndaluar së bashku, [REDACTED] i kishte thënë Dëshmitarit K se ai ishte arrestuar në bazë të urdhrit të Sabit Geci.<sup>412</sup>

197. Dëshmitari K ka parë Sabit Gecin në kampin e Cahanit disa herë, ndoshta dy ose tre herë.<sup>413</sup> Dëshmitari N ka parë Sabit Gecin në kamp dy herë. Hera e parë është përshkruar më lart. Herën e dytë, Sabit Geci është futur në dhomën e ndalimit dhe ka patur veshur uniformë ushtarake dhe ka deklaruar se ai ishte “komandanti i UÇK-së”.<sup>414</sup> Dëshmitari N ka përshkruar Sabit Geci si “person me përgjegjësi” dhe kur Geci ishte i pranishëm askush tjetër nuk fliste.<sup>415</sup>

### *Identifikimi i Riza Alijat si “Komandant Hoxha”*

198. Gjatë shqyrtimit kryesor, kur u morrën të dhënat personale nga Gjykata, Riza Alija deklaroi se nuk ka pseudonim.<sup>416</sup> Megjithatë, kur u pyet për të dhënat e tij personale gjatë Seancës për Konfirmim të Aktakuzës, Riza Alija konfirmoi se ai njihej si “Komandant Hoxha” nga ana e ushtarëve të cilët ai kishte trajnuar gjatë luftës.<sup>417</sup>
199. Dëshmitari [REDACTED] nuk e kishte njohur Riza Alijan para se t’a shihte atë në kampin e UÇK-së.<sup>418</sup> [REDACTED] dëshmoi se Riza Alija ishte prezantuar si “Komandant Hoxha” dhe se kishte dëgjuar gjithashtu ushtarë të tjerë të UÇK-së duke iu drejtuar Alijat me emrin “Komandant Hoxha”.<sup>419</sup> [REDACTED] i janë treguar fotografi për identifikim të Riza Alijat dy herë: 14 dhe 16 qershor 2010. Herën e parë ai kishte dështuar të identifikonte Riza Alijan, dhe herën e dytë ai kishte arritur të identifikonte Aliajn dhe e kishte identifikuar atë si “Komandant Hoxha”. [REDACTED] është pyetur për këtë nga avokati mbrojtës i Alijat, i cili kishte vërejtur se [REDACTED] kishte deklaruar se e shihte fytyrën e Hoxhës edhe kur ishte në gjumë por ai kishte dështuar që t’a veçonte atë gjatë procedurës së parë të identifikimit. Për këtë arsye trupi gjykues e konsideron identifikimin e Alijat si Hoxha ekuivok, megjithatë është vërejtur se

<sup>411</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P225.

<sup>412</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P64-66.

<sup>413</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P75.

<sup>414</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P136 & 152, 194-195.


<sup>415</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P213-215.

<sup>416</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 14 mars 2011, p. 4.

<sup>417</sup> Procesverbali i Konfirmimit të Aktakuzës, 22 tetor 2010, p.2.

<sup>418</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 05 maj 2011, P228.

<sup>419</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 05 maj 2011, P201-203.



identifikimi i tij është përforcuar disi kur ai identifikoi “Komandant Hoxhën” në sallën e gjykimit si Riza Alija.<sup>420</sup>

200. Sipas Dëshmitarit K, “Komandant Hoxha” e quante veten kështu kurse ushtarët e tjerë të UÇK-së i adresoheshin atij thjesht si “Hoxha”.<sup>421</sup> Dëshmitari K përshkroi “Komandant Hoxhën” si person i gjatë, afërsisht 40 vjeç, fizikisht i fuqishëm.<sup>422</sup> Komandant Hoxha vinte në dhomën e ndalimit “shumë shpesh”.<sup>423</sup> Dëshmitari K pa Riza Alijan pas luftës dhe u shoqërua me të disa kohë dhe bisedoi me të.<sup>424</sup>
201. Dëshmitari M identifikoi Riza Alijan si “Komandant Hoxha” përmes një procedure identifikimi me fotorenditje.<sup>425</sup>
202. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor së datës 20 korrik 2011, Avokati Mbrojtës Kollqaku i tërhoqi vëmendjen Trupit Gjykses mbi fotografitë të cilat ishin konfiskuar nga shtëpia e Riza Alijat gjatë një bastisje së kryer më datë 23 qershor 2010 dhe parashtruar si prova nga Prokurori më datë 04 maj 2011. Secila fotografi ka shënime të shkruara me dorë nga mbrapa ku përfshihen emrat, mbiemrat dhe pseudonimin “Hoxha”. Avokati Kollqaku deklaroi së pari se mbrojtja ka konfirmuar saktësinë e datave të cilat tregonin datën kur ishte bërë secila fotografi. Gjatë një diskutimi të mëtejshëm mbi vërtetësinë dhe saktësinë e shkrimit me dorë të shënimeve mbrapa fotografive, Prokurori e pranoi këtë dhe Avokati Kollqaku dhe Riza Alija u pajtuan në dukje me referencën “Hoxha” në lidhje me Riza Alijan.<sup>426</sup> Riza Alija pastaj nuk u pajtua se ai njihej si “Commander Hoxha”.
203. Më vonë, gjatë së njëjtës seancë, mbrojtja parashtrroi si provë një dokument nënshkruar nga Azem Sylja dhe që kishte vulën e Ministrinë e Mbrojtjes, e cila ka për qëllim të përshkruajë aktivitetet e Riza Alijat në UÇK-ë gjatë luftës.<sup>427</sup> Në titullin e

<sup>420</sup> [REDAKTUAR], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P266-268.

<sup>421</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P29, 45, 252.

<sup>422</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 Maj 2011, Q44.

<sup>423</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 May 2011, Q203.

<sup>424</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 May 2011, Q217-218.

<sup>425</sup> Raporti mbi Identifikimit përpiluar nga NJHKL e EULEX-it (Dëshmitari M) 18 qershor 2010

<sup>426</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 20 korrik 2011, p. 8-10.

<sup>427</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 20 korrik 2011, p. 12-13, 15.



këtij dokumenti, emri “Hoxha” shfaqet pranë emrit të Riza Alijat. Gjithashtu në përmbajtjen e dokumentit bëhen referenca të ndryshme pseudonimit “Hoxha”.

204. Në lidhje me të gjitha këto që u thanë më lart, dhe duke patur parasysh se Riza Alija ka pranuar qartë gjatë procedurës për konfirmim se gjatë luftës ai njihej si “Hoxha”, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se referencat e bëra “Hoxhës” në fotografitë dhe dokumentet në lidhje Riza Alijan, dhe se ky ishte emri me të cilin Riza Alija njihej nga ushtarët e tjerë të UÇK-së dhe nga Dëshmitarët gjatë periudhës kohore relevante.

### ***Pozita dhe Autoriteti i i Riza Alijat në Kampin e UÇK-së në Cahan***

205. Është përcaktuar qartë se Riza Alija ishte përgjegjës për trajnimin e ushtarëve të UÇK-së në kampin e Cahanit. Të dy, edhe [REDAKTUAR] dhe Dëshmitari M kanë dëshmuar për këtë, dhe vetë Alija e konfirmoi këtë kur mori në pyetje [REDAKTUAR].<sup>428</sup> Niveli i autoritetit apo komandës që ai kishte në kamp ishte më pak e qartë.
206. Sipas [REDAKTUAR], Sali Rexhepi (gjithashtu i njohur edhe si Sali Berisha) ishte komandanti i burgut të Cahanit, por Riza Alija “nuk e lëshonte shkopin”, që do të thotë se Alija kishte gjithmonë në dorë një shkop dhe e përdorte atë kundër njerëzve aty.<sup>429</sup> Ndërsa Riza Alija ishte përgjegjës për trajnimin e ushtarëve të UÇK-së “dhe pretendohet se ai mbante rregullin aty brenda në cilësinë komandantit”, [REDAKTUAR] perceptonte se Riza Alija sillej si komandanti i burgut.<sup>430</sup> [REDAKTUAR] mendonte se Riza Alija ishte poshtë Sabit Gecit në hierarki, se ishte Geci ai që udhëzonte Alijan nëse të rrihte apo të ndërpriste rrahjen e personave të ndaluar.<sup>431</sup>
207. Dëshmitari K deklaroi gjithashtu se Sali Rexhepi ishte një komandant i cili kishte pozitë më të lartë në kampin e Cahanit sesa Riza Alija dhe se ai mund të ushtronte ndikim mbi Alijan.<sup>432</sup>


<sup>428</sup> Riza Alija, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 05 maj 2011, p. 39; [REDAKTUAR], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P260; Dëshmitari M, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 19 maj 2011, P128-130.

<sup>429</sup> [REDAKTUAR], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P237-239.

<sup>430</sup> [REDAKTUAR], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, Q260; Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 05 maj 2011, P201.

<sup>431</sup> [REDAKTUAR], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P222, 261-262.

<sup>432</sup> Dëshmitari K, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 16 maj 2011, P101-107.



208. Në bazë të Dëshmitarit M, Riza Alija trajnonte ushtarët e UÇK-së dhe ai ishte komandanti i tyre. Alija udhëzonte ata që t'u jepnin personave të ndaluar batanije dhe ushtarët e zbatonin urdhrin e tij.<sup>433</sup>

***Identifikimi i Haki Hajdarit si “Haki Drenica” në kampin e UÇK-së në Cahan***

209. Haki Hajdari konfirmoi se ai njihej me pseudonimin “Drenica” kur u morën të dhënat e tij personale gjatë shqyrtimit kryesor.<sup>434</sup> Gjatë fjalës së tij përfundimtare avokati i tij konfirmoi faktin se Haki Hajdari ishte anëtar i UÇK-së dhe i pranishëm në kampin e Cahanit.<sup>435</sup>

210. Gjatë shqyrtimit kryesor Dëshmitarët gjithashtu kanë identifikuar pozitivisht Haki Hajdarin si Haki Drenica. [REDACTED] i është kërkuar të identifikojë Haki Drenicën në sallën e gjyqimit dhe ai ka treguar me gisht Haki Hajdarin.<sup>436</sup> Dëshmitari M ka dëshmuar se Haki Hajdari është prezantuar si “komandant Drenica”, dhe më vonë i kishte thënë se ai quhej “Haki Drenica”.<sup>437</sup> Dëshmitari N përshkroi “Haki Drenicën” si më i madh se ai, pak i shëndoshë, dhe jo më i madh në moshë. Ai e dinte se Haki Drenica kishte punuar në një fabrikë baruti në Skenderaj dhe se ai ishte nga Drenica.<sup>438</sup> Dëshmitari N kishte dëgjuar ushtarë të tjerë të UÇK-së duke iu drejtuar atij me emrin “Haki Drenica” dhe atij i kishin thënë gjithashtu edhe të burgosurit e tjerë se ky ishte emri i tij.<sup>439</sup> Për më tepër, Dëshmitari N identifikoi Haki Hajdarin si “Haki Drenica” në një rradhitje fotografish.<sup>440</sup>

211. Trupi Gjyqësor konkludon se identifikimi i Haki Hajdarit si Haki Drenica dhe prania e tij në kampin e Cahanit është vërtetuar nga provat.

<sup>433</sup> Dëshmitari M, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 19 maj 2011, P128-130.

<sup>434</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, p. 3.

<sup>435</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 25 July 2011, p. 11-14.


<sup>436</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P266-268.

<sup>437</sup> Dëshmitari M, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 19 maj 2011, P33 & 43.

<sup>438</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P108-112.

<sup>439</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P113-116 dhe p.16; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit gjatë një Hetimi Paraprak pranë PSRK (Dëshmitari N), 02 dhjetor 2010, p.4.

<sup>440</sup> Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit gjatë një Hetimi Paraprak dhe Procedurë Identifikimi pranë PSRK (Dëshmitari N) i datës 02 dhjetor 2010.



### ***Identifikimi i Shaban Hotit në Kampin e UÇK-së në Cahan***

212. [REDACTED], pala e vetme e dëmtuar /viktima që ka dëshmuar personalisht në gjykatë, arriti të identifikonte pozitivisht Shaban Hotin në Sallën e Gjykimit.<sup>441</sup>
213. Dëshmitari N përshkroi Shaban Hotin si i gjatë dhe i hollë, i cili në kohën e ngjarjeve nuk ishte as 40 vjeç.<sup>442</sup> Dëshmitari N dëshmoi se ai kishte mësuar nga vetë i pandehuri, si dhe nga ushtarë të UÇK-së dhe të burgosur të tjerë në kamp, emrin “Shaban Hoti” dhe faktin se ai ishte nga fshati Polac.<sup>443</sup> Gjatë shqyrtimit kryesor Shaban Hoti konfirmoi se ai është nga fshati Polac.<sup>444</sup> Dëshmitari N identifikoi saktë Shaban Hotin përmes një rradhitje fotografike.<sup>445</sup>
214. Trupi Gjykses gjen se provat vërtetojnë identifikimin e Shaban Hotin si anëtar të UÇK-së i cili ishte i pranishëm në kampin e Cahanit.

## **VII. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE**

### ***Sabit Geci lidhur me Ngjarjet në Kampin e UÇK-së në Kukës***

215. Sabit Geci akuzohet për katër vepra penale krimesh lufte lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në kampin e Kukësit, të paraqitura hollësisht në gjetjet faktike më lart.
216. Siç është përcaktuar më lart, parakushtet nga Konventat e Gjenevës dhe Protokolli Shtesë II janë përcaktuar dhe nuk do të përsëriten më këtu. Neni 3 i Përbashkët parasheh mbrojtje të “personave që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive gjatë armiqësive”. Provat vërtetojnë se Dëshmitari A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] ishin të gjithë persona civilë kur u arrestuan dhe ndaluan nga UÇK-ja. Baza për këtë

<sup>441</sup> [REDACTED], Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P266-268.

<sup>442</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P100-104.

<sup>443</sup> Dëshmitari N, Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 23 maj 2011, P111, 113-116 dhe p.16; Procesverbali i Dëgjimit të Dëshmitarit gjatë një Hetimi Paraprak (Dëshmitari N), 02 dhjetor 2010, p.4.

<sup>444</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, p. 4.

<sup>445</sup> Raport mbi Procedurën e Identifikimit Fotografik nga NJHKL të EULEX (Dëshmitari N) i datës 17 janar 2011.




ndalim lidhej me statusin e tyre perceptuar si “spiunë” apo “bashkëpunëtorë të serbëve” megjithatë nuk është paraqitur asnjë provë për të vërtetuar se ndonjë prej Dëshmitarëve ka marrë pjesë aktive në konfliktin që po zhvillohej. Këto ishin më tepër pretendime të paqarta, të paqëndrueshme dhe jo adekuate të cilat nuk janë gjë tjetër veç pretendime të pavërtetuara të UÇK-së të cilat janë përdorur nga UÇK-ja si justifikim për të ndaluar dhe keqtrajtuar Dëshmitarët. Thjesht fakti se cilido Dëshmitar mund të ketë patur fqinjë apo shokë të etnisë serbe para vitit 1999, ose që mund të ketë qenë i punësuar si nëpunës civil për një kohë më të gjatë sesa kosovarë shqiptarë të tjerë nuk përbën ndonjë provë pjesëmarrjeje në konflikt dhe pa dyshim nuk heq statusin e personit të mbrojtur nën Konventat e Gjenevës.

### Akuza 1 kundër Sabit Geci – Trajtimi çnjerëzor

217. Akuza 1 ngarkon Sabit Gecin për kryerjen e një krimi lufte, për shkak të trajtimit çnjerëzor të civilëve të ndaluar në kampin e Kukësit në lidhje me kushtet e jetesës së ndalimit të tyre. Ai akuzohet si bashkëkryerës, së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së të cilët nuk janë palë në këtë lëndë, në cilësinë e anëtarit të UÇK-së me pozitë komanduese.
218. TPNJ ka përcaktuar trajtimin çnjerëzor si “veprim apo mosveprim i qëllimshëm, ai është një veprim i cili, i vlerësuar objektivisht, është i qëllimshëm dhe i rastësishëm, i cili shkakton dëm mendor apo vuajtje fizike apo lëndim apo përbën sulm të rëndë të dinjitetit njerëzor [...]. Për këtë arsye, trajtimi çnjerëzor është trajtim i qëllimshëm i cili nuk përputhet me parimet themelore të njerëzimit, dhe formon ombrellën nën të cilën bie pjesa e mbetur e listës së “shkeljeve të rënda” në Konventat e Gjenevës. Për këtë arsye, aktet të cilat karakterizohen në Konventat dhe Komentaret si çnjerëzore, ose të cilat nuk përputhen me parimet e njerëzimit, përbëjnë shembuj të veprimeve të cilat mund të karakterizohen si trajtim çnjerëzor.”<sup>446</sup> Trajtimi çnjerëzor mund të manifestohet në një numër të pafund mënyrash, kufizuar vetëm nga imagjinata e errët e njerëzimit. Një mënyrë e tillë e trajtimit çnjerëzor është dhe kushtet e jetesës ku janë detyruar të vuajnë personat e ndaluar. Për të përcaktuar nëse kushtet e jetesës janë aq të këqija sa të përbëjnë trajtim çnjerëzor duhet të analizohen edhe karakteristikat

<sup>446</sup> TPNJ, Aktgjykimi *Celebici (Delalic et al.)*, 16 nëntor 1998, para. 543




konkrete të ndalimit edhe vuajtjet psikike dhe mendore që ka pësuar personi i ndaluar. Kushtet e jetesës së ndalimit duhet të jenë “të tilla që të shkaktojnë të ndaluarve vuajtje të rënda psikike dhe fizike” dhe në këtë mënyrë për bëjnë “sulm të rëndë ndaj dinjitetit të të ndaluarve”.<sup>447</sup> Për më tepër, periudha kohore gjatë të cilës këto kushte janë mbajtur pa ndonjë përmirësim mund të jetë tregues se ato janë imponuar qëllimisht.<sup>448</sup>

219. Provat vërtetojnë se kushtet e ndalimit ishin të fëlliqura dhe të tmerrshme. Dhoma kryesore e ndalimit në të cilën janë mbajtur thuajse gjithë Dëshmitarët ishte jashtëzakonisht e vogël dhe e pamjaftueshme duke patur parasysh numrin e personave të ndaluar. Personat e ndaluar flinin në dysheme betoni, dysheme e pambuluar, ndonjëherë pa batanije kur këto u hiqeshin si formë ndëshkimi kolektiv për shkak të bashkëpunimit të tyre të pretenduar. Uji ishte me pakicë dhe nuk sigurohej rregullisht. Edhe ushqimi jepej në sasi të vogla dhe në mënyrë të parregullt. Dëshmitarë të ndryshëm kanë humbur shumë peshë për shkak të ushqimit të varfër dhe të papërshtatshëm i cili u është dhënë gjatë javëve të ndalimit. Kushtet higjienike pothuajse nuk ekzistonin me mundësi të kufizuar për të përdorur nevojtoeren dhe pa patur mundësi për t’u larë apo ndërruar rrobat. Personat e ndaluar janë mbajtur në kushte të fëlliqura, të papërshtatshme, dhe siç janë përshkruar nga një Dëshmitar, për kafshë.
220. Përveç kushteve të vështira fizike shtohet dhe fakti i rrahjeve që ndodhnin dhe frekuenca e këtyre rrahjeve gjë e cila do të thotë se personat e ndaluar jetonin në një frikë të vazhdueshme të dhunës së mëtejshme dhe vdekjeje. Një gjendje e tillë frike, e cila ka zgjatur me javë pa asnjë tregues nëse dhe kur ata do të liheshin të lirë nga ndalimi, i është shtuar trajtimi çnjerëzor i Dëshmitarëve dhe i është shtuar vuajtjeve që ata kanë duruar.
221. Më tej provat vërtetojnë se Sabit Geci ishte anëtar i UÇK-së me rol komandues, brenda asaj që është përshkruar nga disa Dëshmitarë si “Policia Ushtarake”. Natyra e

<sup>447</sup> TPNJ, *Limaj et al.*, Aktgjykimi I Gjykatës, 30 nëntor 2005, para. 289

<sup>448</sup> *Ibid*




saktë e këtij roli dhe grada që ka patur Geci nuk janë të qarta, por në fakt nuk ka as nevojë të jenë. Fakt është se ai vetë ka përshkruar veten para Dëshmitarëve të ndryshëm si komandant, apo që ka patur komandën e policisë ushtarake, dhe ai është soll në mënyrë të tillë që tregonte posedim autoriteti nga ana e tij dhe ushtarët rreth tij reagonin kundrejt udhëzimeve të tij në mënyrë të tillë që tregonin se ata ia njihnin të drejtën që kishte për të dhënë udhëzime dhe detyrimin që ata kishin për t'iu bindur këtyre udhëzimeve. Një numër Dëshmitarësh përshkruajnë shembuj specifikë të rasteve individuale ku Geci ka dhënë udhëzime dhe të tjerët i kanë zbatuar ato. Pra, Sabit Geci jo vetëm ka marrë pjesë në mënyrë aktive në një numër rrahjesh të Dëshmitarëve, ai ka patur një shkallë të caktuar autoriteti dhe kontrolli mbi ushtarët e tjerë të UÇK-së të cilët ishin përgjegjës për kushtet e përditshme të jetesës të personave të ndaluar.

222. Trupi Gjykses konsideron se Sabit Geci ka kryer në bashkëkryerje, dhe është penalisht përgjegjës për, Akuzal (Krime Luftë kundër Popullatës Civile) për shkak të pjesëmarrjes së tij të përgjithshme gjatë ndalimit, keqtrajtimit dhe marrjes në pyetje të Dëshmitarëve civilë në kushte ekstreme fizike dhe psikologjike të cilat përbënin trajtimin çnjenjësor.

#### Akuza 2 Kundër Sabit Gecit - Tortura


223. Akuza 2 akuzon Sabit Gecin për kryerje të një krimi luftë si bashkëkryerës duke qenë anëtar i UÇK-së me pozitë komanduese duke torturuar Dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] afërsisht rreth datë 19 maj 1999.
224. Çështje të zbatimit të përgjithshëm të cilat janë përcaktuar tashmë lidhur me Akuzën 1 nuk do të përsëriten më këtu dhe do vazhdohet më tej.
225. Konventa e KB-a Kundër Torturës përcakton torturën si “çdo veprim me anë të të cilit personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhimbje apo vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë informacione apo pohime për t'a dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë ka kryer apo



dyshohet se ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në çfarëdolloj diskriminimi, kur dhembjet apo vuajtjet e tilla nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen apo pëlqimin e tij.”<sup>449</sup>


226. Provat vërtetojnë se më datë apo rreth datës 19 maj 1999, në Kukës ndodhi një rrahje masive e Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED]. Nuk ishte më pak se një orgji e paramenduar, qëllimshme, dhunë sadiste kryer nga Sabit Geci dhe të tjerët në cilësinë e tyre zyrtare si ushtarë të UÇK-së. Viktimat u rrahën masivisht, dhe në mënyrë të paramenduar u dërguan në vendin me qëllim që ata të ishin të detyruar të shikonin dhe dëgjonin dhunën që po shkactohej mbi të tjerët ndërkohë që ata po prisnin rradhën. Një gjë e tillë u shkaktoi personave të ndaluar dhembje dhe vuajtje të rënda, fizike dhe mendore. Gjatë kësaj dhune, u bë një marrje në pyetje e tejzgjatur në lidhje me përfshirjen e Dëshmitarëve në ngjarjet e kaluara në lidhje me konfliktin, lidhjet me serbët dhe aktivitetet si spiunë. Pra qëllimi ishte që të nxirreshin pohime dhe informata nga Dëshmitariët dhe t’i ndëshkonin ata për aktivitete të menduara si simpatizantë apo bashkëpunëtorë të serbëve.
227. Megjithëse Geci vetë mund të luante vetëm një rol të kufizuar në shkaktimin e dhunës për shkak të lëndimeve dhe paaftësisë së tij, megjithatë ai ka luajtur rolin fizik më të madh që mund të luante. Për më tepër, ai luajti rol kyç në marrjen në pyetje gjatë së cilës u kërkuan nga viktimat informacione mbi bashkëpunëtorë të dyshuar dhe pohime të krimeve të pretenduara.
228. Trupi Gjykses përcakton se Sabit Geci ka bashkëkryer, dhe është penalisht i përgjegjshëm për, Akuza 2 (Krime Luftë Kundër P Civile) për shkak të pjesëmarrjes së tij aktive në rrahjet dhe marrjen në pyetje të Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] rreth datës 19 maj 1999 e cila përbën aktin e torturës.

<sup>449</sup> Neni 1



Akuza 3 kundër Sabit Gecit – Cënimi i Integritetit Trupor

229. Akuza 3 akuzon Sabit Gecin për kryerjen e një krimi lufte, si bashkëpunëtor në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së që kishte pozitë komanduese, sepse ka cënuar integritetin trupor të Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] gjatë rasteve të ndryshme rrahjesh dhe keqtrajtimesh mes prillit dhe 03 qershorit 1999.
230. Më lart është pëshkruar përcaktimi i përgjithshëm i trajtimit çnjerëzor. Rrahjet dhe keqtrajtimi të shkaktuara qëllimisht të cilat janë aq të dhunshme dhe të rënda sa që vuajtja fizike dhe mendore që u shkaktohet viktimave përbëjnë një sulm të rëndë ndaj personit dhe dinjitetit të tyre dhe shkojnë në nivelin e trajtimit çnjerëzor duke i cënuar integritetin trupor. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me trajtimin çnjerëzor në mënyrën e kushteve të rënda të jetesës të cilat janë trajtuar në një akuzë ndaras.
231. Incidente të shumta rrahjesh dhe keqtrajtimesh të tjera që pësuan Dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] janë vërtetuar individualisht në gjetjet faktike dhe nuk do të përsëriten këtu. Frekuenca dhe intensiteti i këtyre rrahjeve përbëjnë cënim të integritetit trupor të viktimave. Për më tepër, në tërësi ato demonstrojnë se përdorimi i dhunës kundër personave të ndaluar në Kukës nuk ishte incident i vetëm torture kufizuar vetëm në datën 19 maj 1999, torturë përshkruar më lart në Akuzën 3. Në fakt, një keqtrajtım i tillë ishte një model i përcaktuar, sistematik, i vazhdueshëm, pa shkak dhe dhunë e pajustificueshme, me Gecin që luante rol kryesor drejtues.
232. Sabit Geci ishte i pranishëm në disa prej këtyre rrahjeve ku morri pjesë në mënyrë aktive. Prania e tij fizike nuk është domosdoshmërisht e nevojshme në secilin dhe çdo incident dhune për gjetjen e përgjegjësisë penale individuale për shkak të pozitës së tij më të lartë komanduese (përshkruar më lart hollësisht). Si person në pozitë me autoritet, kryerja nga ana e tij të veprimeve të dhunshme kundër disa personave të ndaluar përbënte leje dhe miratim të veprimeve të ngjashme të dhunës ushtruar kundër personave të ndaluar nga ushtarë të tjerë të UÇK-së nën ndikimin e Gecit.



233. Trupi Gjykses konsideron se Sabit Geci ka kryer në bashkëkryerje, dhe është penalisht i përgjegjshëm për Akuzën 3 (Krime Luftë kundër Popullatës Civile) për shkak të pjesëmarrjes së tij aktive, fizikisht dhe përmes miratimit të heshtur, në rrahjet dhe keqtrajtimin e Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H dhe [REDACTED] gjatë rasteve të ndryshme mes prillit dhe 03 qershorit 1999, që përbëjnë çënime të integritetit trupor.

#### Akuza 4 Kundër Sabit Gecit – Vrasja e Killing [REDACTED]

234. Akuza 4 ngarkon Sabit Gecin për kryerjen e një krime lufte, si bashkëkryerës në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së që mbante pozitë komanduese, vrasjen e [REDACTED] [REDACTED] më apo rreth datës 05 qershor 1999.


235. Trupi Gjykses nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse Sabit Geci ishte i pranishëm kur kanë shtënë mbi [REDACTED] dhe vdekjes së tij. Dëshmitari B dëshmoi se ai kishte parë Sabit Gecin në korridor jashtë dhomës ku kishte ndodhur incidenti me jelekun anti-plumb.<sup>450</sup> Dëshmitari B deklaroi gjithashtu se ai kishte parë Sabit Gecin duke u larguar nga zona pas të shtënave, dhe se kjo kishte qenë hera e fundit që ai e kishte parë atë në kampin e Kukësit.<sup>451</sup> Asnjë Dëshmitar nuk ka mundur të konfirmojë praninë e Sabit Gecit gjatë kohës së vdekjes së [REDACTED] apo menjëherë pas vdekjes së tij. Për më tepër, është përcaktuar se më datë 03 qershor 1999, Sabit Geci është shtruar në spital në Tiranë si pasojë e një aksidenti trafik.<sup>452</sup> Për këtë arsye, nuk është vërtetuar deri në standardin penal të të provuarit se Sabit Geci ka qenë i pranishëm në kampin e Kukësit gjatë natës kur [REDACTED] është qëlluar apo ditën në vijim kur ai vdiq.

236. Gjithashtu nuk është provuar se Sabit Geci ka marrë pjesë në vrasjen e [REDACTED]. Fakti se nuk mund të provohet se ai ishte fizikisht i pranishëm gjatë incidentit nuk përjashton automatikisht përgjegjësinë e tij penale. Dhe në fakt Prokurori pretendoi se

<sup>450</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P126-133

<sup>451</sup> Dëshmitari B, Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 21 mars 2011, P160-168

<sup>452</sup> Certifikatë Mjekësore e Qendrës Spitalore Universitare Ushtarake Tiranë (shih Listën e Dokumenteve të Pranuara, para 46 pika 10 lart).



Sabit Geci ishte penalisht përgjegjës duke u mbështetur në përgjegjësinë e tij për mbajtjen e [REDACTED] (dhe të tjerëve) të ndaluar në kampin e Kukësit dhe pra duke i patur në dispozicion për torturë, rrahje dhe keqtrajttime të tjera në rrethanat ku Sabit Geci duhet të kishte parashikuar se një dhunë e tillë mund të kishte çuar në vdekjen e një prej apo më shumë personave të ndaluar, përfshirë [REDACTED].


237. Nëse vdekja e [REDACTED] erdhi si rezultat i një rrahjeje tipike e keqtrajtimit i cili ndodhte rregullisht në kampin e Kukësit (siç është përshkruar më lart), argumenti i Prokurorisë mund të ketë qenë bindës. Megjithatë, në rrethanat ku mënyra e vrasjes, gjatë së cilës [REDACTED] ishte detyruar të vishte një jelek anti-plumb pas së cilës u qëllua mbi të, është aq shumë e pazakontë dhe krejtësisht jashtë standardit të rrahjeve tipike, nuk mund të pranohet se Sabit Geci mund të kishte parashikuar sjelljen kriminale e cila çoi deri në vdekjen e [REDACTED].
238. Për këtë arsye, Trupi Gjykses liron Sabit Gecin nga Pika 4 e Akuzës së kësaj Aktakuze.

### ***Përsa i përket Ngjarjeve në Kampin e UÇK-së në Cahan***

239. Të katër të pandehurit akuzohen për akuza të ndryshme krime lufte në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në kampin e Cahanit të cilat janë përshkruar më lart në gjetjet faktike. Gjetjet faktike dhe konkludimet ligjore përcaktuar më lart në lidhje me elementët e përbashkët të krimeve të luftës nuk do të përsëriten dhe janë të përfshira këtu.

### **Trajtimi çnjerëzor i të Ndaluarve (Kushtet e Jetesës)**


240. Aktakuza akuzon Riza Alijan (Akuza 1) dhe Haki Hajdarin (Akuza 1) për kryerjen e një krimi lufte përmes trajtimit çnjerëzor të civilëve të ndaluar në kampin e Cahan përsa i përket kushteve të jetesës së ndalimit të tyre.



241. Provat vërtetojnë se kushtet në kampin e Cahanit ishin të rënda, megjithëse ato ishin shumë më pak të tilla se në kampin e Kukësit. Një numër Dëshmitarësh kanë nxjerrë në pah se kushtet ku ata janë mbajtur, në veçanti përsa i përket ushqimit, nuk ishin aq shumë të ndryshme nga kushtet e tjerëve të cilët ishin të pranishëm në Cahan përfshirë ushtarët. Nuk ka prova humbje të madhe peshe apo shenja të tjera privimi siç ka qenë rasti me personat e ndaluar në kampin e Kukësit. Faktorët kryesorë të ankesës ishin fakti i ndalimit *per se* dhe frika e vazhdueshme e rrahjeve të mëtejshme sesa kushtet e jetesës.
242. Trupi Gjykes konsideron se ka prova të pamjaftueshme për të cilësuar kushtet në Cahan si trajtim çnjerëzor brenda përkufizimit të krimeve të luftës dhe liron Riza Alijan nga pika 1 e Akuzës dhe Haki Hajdarin nga pika 1 e Akuzës.

Cënimi i Integritetit Trupor të [REDACTED] më datë 12 prill 1999


243. Aktakuza akuzon Sabit Gecin dhe Riza Alijan për kryerjen e një krimi lufte në bashkëveprim për cënimin e integritetit trupor të [REDACTED] (më parë i njohur si “Dëshmitari L”) rreth datës 12 prill 1999 në kampin e Cahanit (listuar në Aktakuzë si Akuza 5 kundër Sabit Gecit dhe Akuza 2 kundër Riza Alijat).
244. [REDACTED] ka dhënë një raport të qartë, koherent dhe të hollësishëm të rrahjeve të pësuar në duart e Sabit Gecit dhe Riza Alijat, siç është përshkruar më lart në gjetjet faktike. Roli primar i Sabit Gecit ishte që të drejtonte marrjen në pyetje, në veçanti mbi lidhjet e [REDACTED] me [REDACTED], megjithëse Geci mori pjesë drejtpërdrejt duke e goditur me shuplaka [REDACTED] dhe duke e goditur atë me patericë. Sabit Geci gjithashtu gjente kënaqësi kur i shkaktonte mizori mendore të pajustificueshme kur i thoshte [REDACTED] se ai do të ekzekutohej dhe se Geci do të kujdesej edhe për ekzekutimin e [REDACTED]. Kjo ishte e qëllimshme dhe padyshim ai arriti të krijonte një frikë reale dhe të konsiderueshme tek [REDACTED] për vdekjen e tij shumë të shpejtë.



245. Roli i Riza Alijat në këtë rrahje ishte shumë më i thjeshtë. Ndërsa Sabit Geci ishte truri i këtij aktiviteti, Riza Alija ishte thjesht forca, muskujt. Ishte Riza Alija ai i cili ka bërë shumicën e rrahjeve të egra duke përdorur një shkop druri.
246. Trupi Gjykses konsideron se Sabit Geci and Riza Alija kanë kryer në bashkëveprim dhe janë penalisht përgjegjës për veprën penale krime Luftë kundër Popullatës Civile (Akuza 5 kundër Sabit Gecit dhe Akuza 2 kundër Riza Alijat) për shkak të rrahjes së [REDACTED] nga ata më apo rreth datës 12 prill 1999 që përbën cënim të integritetit trupor.

Cënimi i Integritetit Trupor të Dëshmitarëve K, M, N, O dhe [REDACTED]

247. Aktakuza ngarkon Sabit Gecin dhe Riza Alijan për kryerjen e një krimi lufte në bashkëkryerje sepse kanë cënuar integritetin trupor të Dëshmitarëve K, M, N, O dhe [REDACTED] në data të papërcaktuara mes 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999 në kampin e Cahanit (listuar në Aktakuzë si Pika 6 kundër Sabit Gecit dhe Pika 3 kundër Riza Alijat).
248. Për këtë pikë të aktakuzës, Prokuroria nuk ka pretenduar se Sabit Geci ka patur ndonjë rol personal në dhunën e pretenduar të referuar. Akuza ishte në fakt se Riza Alija ka ushtruar dhunë në bazë të udhëzimeve të Sabit Gecit.
249. Provat vërtetojnë se Riza Alija ka rrahur disa herë Dëshmitarët. [REDACTED] është rrahur nga Riza Alija në dy raste të ndryshme kur ai po kthehej nga nevojtorja. Dëshmitari K dhe Dëshmitari M u rrahën nga Riza Alija me një shufër hekuri rreth datës 16 prill 1999 kaq keq sa Dëshmitari M humbi vetëdijen. Dëshmitari O ishte rrahur nga Riza Alija para se të sillej në dhomën e ndalimit. Është vërtetuar se rreth datës 25/26 maj 1999, Riza Alija ka sjellë një femër në dhomën e ndalimit dhe e ka udhëzuar atë që të rrahë [REDACTED] dhe Dëshmitarin N.



250. Trupi Gjykues konsideron se Riza Alija ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krime Lufte kundër Popullatës Civile (Pika 3 e Aktakuzës Riza Alija) për shkak të rolit të tij aktiv gjatë rrahjeve dhe keqtrajtimit të Dëshmitarëve K, M, N, O dhe [REDACTED] gjatë rasteve të ndryshme mes datës 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999, të cilat përbëjnë çënime të integritetit trupor.
251. Megjithatë, në lidhje me Sabit Gecin, nuk kishte prova të mjaftueshme për të gjetur se ai ka udhëzuar Riza Alijan për të kryer cilëndo prej këtyre rrahjeve. Prova kryesore se udhëzime të tilla janë dhënë mund të gjenden në tregimin e [REDACTED], i cili po citonte atë që i ishte thënë nga Riza Alija.<sup>453</sup>
252. Problemi me këtë provë është se ajo vjen nga Riza Alija, bashkëkryerësi i pretenduar. Nëse dikush ka patur një motiv potencial për të kërkuar të shfajësonte vetveten nga faji personal dhe të fajësonte dikë tjetër, ky person është Alija. Për këtë arsye, megjithëse Trupi Gjykues gjen se [REDACTED] ka përshkruar hollësisht atë që i është thënë nga Riza Alija, Trupi Gjykues nuk mund të mbështetet vetëm në tregimin e pambështetur të një bashkëkryerësi për të gjetur fajësinë e Sabit Gecit për dhënien e këtyre udhëzimeve.
253. Për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, Trupi Gjykues liron Sabit Geci nga Pika 6 e Aktakuzës.

Tortura e Dëshmitarit N më datë 03 maj 1999

254. Aktakuza ngarkon Haki Hajdarin dhe Shaban Hotin me kryerjen e një krimi lufte në bashkëkryerje për torturimin e Dëshmitarit N rreth datës 03 maj 1999 në kampin e Cahanit (listuar në Aktakuzë si Pika 2 kundër Haki Hajdarit dhe Pika 1 kundër Shaban Hotit).


<sup>453</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 04 maj 2011, P262.



255. Prova vërtetoi se Dëshmitari N ishte rrahur keq kur kishte arritur në kampin e Cahanit më apo rreth datës 03 maj 1999 dhe se rrahja ishte kryer nga Haki Hajdari dhe Shaban Hoti dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Rrahja shkaktoi dhimbje dhe vuajtje të mëdha, duke bërë që Dëshmitari N të bërtasë dhe të humbasë vetëdijen. Gjatë kësaj rrahjeje, Haki Hajdari, Shaban Hoti dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së morrën në pyetje Dëshmitarin N mbi punësimin e tij, përfshirjen SDS, hollësi mbi organizatën “Fadofil”, dhe praninë e ushtarakëve serbë në Istog/Istok. Pra, qëllimi i rrahjes dhe marrjes në pyetje ishte edhe për të marrë informata nga Dëshmitari N dhe për t’a ndëshkuar atë për përfshirjen e tij të përceptuar me organizatat dhe entitetet serbe. Siç është shpjeguar më lart, Haki Hajdari dhe Shaban Hoti kanë vepruar në cilësinë e tyre si anëtarë të UÇK-së.
256. Trupi Gjykses konsideron se Haki Hajdari dhe Shaban Hoti kanë kryer në bashkëveprim, dhe janë penalisht përgjegjës për, Krime Luftë Kundër Popullatës Civile për shkak të pjesëmarrjes së tyre në rrahjen dhe marrjen në pyetje të Dëshmitarit N më apo rreth datës 03 maj 1999 e cila përbën aktin e torturës.

*Tortura e Dëshmitarit N më datë 09 maj 1999*

257. Aktakuza ngarkon Shaban Hoti për kryerjen e një krimi lufte duke torturuar Dëshmitarin N rreth datës 09 maj 1999 (Akuza 2).
258. Ndërkohë që prova vërteton se kjo rrahje shtesë e Dëshmitarit N ka ndodhur, tregimi i paraqitur nga Dëshmitari N ishte hutuar dhe i pasigurt, në veçanti përsa i përket pranisë dhe rolit të pretenduar të Shaban Hotit. Ndërkohë që ka disa prova të cilat mbështesin pretendimet e ngritura në Akuzën 2, tërësia e provave mbi këtë akuzë, dhe në fakt pasiguria e të të kujtuarit të vetë Dëshmitarit mbi rolin dhe sjelljen e Shaban Hotit, dhe mungesa e fakteve të tjera mbështetëse bëjnë që Trupi Gjykses të mos mund të gjejë Shaban Hotin penalisht përgjegjës përgjegjës.
259. Për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, Trupi Gjykses liron Shaban Hotin nga Pika 2 e Aktakuzës.




## VIII. AKUZA MBI ARMË KUNDËR SABIT GECIT

260. Kur Sabit Geci u arrestua më datë 06 maj 2010, ai kishte në posedim një pistoletë gjysëm automatike Crvena Zastava M-57 Lux e kalibrit 7.62x25mm për të cilën nuk ishte leje.<sup>454</sup> Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, mbajtur më datë 14 mars 2011, Sabit Geci u deklarua fajtor për akuzën Posedim i Autorizuar i Armës (Pika 7 e Aktakuzës) në pajtim me Nenin 328(2), KPK. Trupi Gjykses e pranoi këtë deklaratë dhe e shpall fajtor për këtë akuzë.

## IX. PARASHTRESA TË REFUZUARA

261. Në pajtim me Nenin. 397 paragrafi (7) KPPK, në vijim është lista e kërkesave të cilat janë refuzuar gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor:
262. Më datë 14 mars 2011, Trupi Gjykses refuzoi kërkesën e Avokatit Mbrojtës Mahmut Halimi, mbështetur nga Avokati Mbrojtës Gezim Kollqaku, se procesverbali i dëgjimit të Dëshmitarit H i datës 11 tetor 2010 dhe procesverbali i dëgjimit të Dëshmitarit B të datës 23 tetor të veçohen nga dosja e lëndës dhe të shpallen të papranueshme sepse deklaratat ishin marrë nga Prokurori pas ngritjes së Aktakuzës. Trupi Gjykses është i mendimit se ligji lejon palët që të propozojnë prova të reja dhe Dëshmitarë gjatë gjithë shqyrtimit kryesor së lëndës, dhe si i tillë nuk ndalon mbledhjen e provave të tilla pas ngritjes së Aktakuzës. Trupi Gjykses ka pranuar gjithashtu arsyetimin e parashtruar në Vendimin KA nr. 64/2010 mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Pranueshmërisë së Provave, më datë 24 nëntor 2010 i cili refuzon të njëjtin argument.
263. Më datë 16 maj 2011, Trupi Gjykses refuzoi kërkesën e Avokatit Mbrojtës Haxhi Millaku për një ekspertizë të shkrimit të dorës për të ekzaminuar nënshkrimet në deklaratat e mëparshme të Dëshmitarit K. Trupi Gjykses gjeti se nuk ka baza për një

<sup>454</sup> Raport i Oficerit, nga Victor Odom i datës 06 maj 2010.



ekspertizë të tillë sepse nënshkrimet në fjalë nuk rezultuan të jenë ato të Dëshmitarit por të Prokurorit.


264. Më datë 16 maj 2011, Avokati Mbrojtës Haxhi Millaku veprimi në drejtim të shpalljes së deklaratës së mëparshme të Dëshmitarit K, të datës 21 prill 2010, si të papranueshme. Z. Millaku kundërshtoi deklaratat për faktin se as versioni anglisht dhe as ai shqip nuk ishin nënshkruar nga Dëshmitari. Kjo pikë u ngrit nga Z. Millaku pasi Prokuroria kishte përfunduar marrjen në pyetje direkte të Dëshmitarit gjatë së cilës Dëshmitari ishte ballafaquar shumë herë me deklaratat që ai kishte dhënë më datë 21 prill 2010. Në asnjë moment, gjatë ballafaqimeve të bëra nga Prokurori me Dëshmitarin K mbi deklaratën e tij të mëparshme asnjë palë nuk ka kundërshtuar pranueshmërinë e deklaratës. Qëndrimi i Prokurorisë është se çështja e pranueshmërisë duhej të ishte ngritur para dëshmisë kryesore të Dëshmitarit. Duke qëndruar në heshtje mbi këtë çështje, edhe para marrjes direkte në pyetje dhe gjatë dëshmisë kur Dëshmitari në mënyrë të përsëritur me deklaratën e mëparshme, Mbrojtja në mënyrë të nënkuptuar ka pranuar pranueshmërinë e dokumentit. Në pajtim me deklaratën e Kryetarit të Trupit Gjykses më datë 16 maj 2011, faqe 35, i është dhënë dëshmisë nën betim në Gjykatë, dhe nuk është marrë shpjegim apo nuk i është dhënë peshë pjesëve të deklaratës së panënshkruar të cilat nuk u përsëritën shprehimisht dhe të cilat u pranuan nga Dëshmitari si të vërteta gjatë dëshmisë së dhënë nën betim.

## X. DËNIMI

265. Kur cakton një dënim penal, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshmit të dënimit për të parandaluar të tjerët nga kryerja e aktivitetit kriminal, dhe qëllimit të veçantë për të parandaluar kryerësin nga rikryerja dhe lehtësuar rehabilitimin.<sup>455</sup>

---

<sup>455</sup> Nenet 34 & 64, KPK.



266. Gjatë përcaktimit të dënimit, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues.<sup>456</sup>

267. Përsa i përket Sabit Gecit, Trupi Gjykses gjeti faktorët rëndues si në vijim:

- Niveli i lartë i pozitës së Geci, dhe fuqia /autoriteti për të kontrolluar dhe drejtuar atë që ndodhi gjatë ndalimeve.
- Kohëzgjatja e ndalimeve të viktimeve në të dy kampet.
- Numri i viktimeve.
- Efekti i ndalimeve, rrahjeve dhe keqtrajtimeve në shëndetin fizik dhe mendor të viktimeve, përfshirë humbje domethënëse të peshës së trupit (tregues i nivelit të privimeve që ata kishin vuajtur) dhe lëndimet permanente të pësuar.
- Rrahjet e Anton Bisakut i cili atë kohë vuante tashmë nga lëndime të mëparshme nga një aksident me makinë i mëparshëm që kishte ndodhur para pak kohe (relevant për Akuzat 2 dhe 3).


Trupi Gjykses gjeti rrethana rënduese shtesë, në lidhje me Pikën 2, si në vijim:

- Përdorimi i dhunës së paarsyeshme, së zgjatur dhe pajustiifikueshme në këtë rrahje masive për fillimin e së cilës kishte dhënë urdhër dhe në të cilën ai gjithashtu mori pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Përdorimi i armëve, shtagave dhe shkopinjve gjatë rrahjeve të viktimeve.
- Elementë psikologjikë dhe fizikë të egër shtuar rrahjeve si detyrimi i një femre (Dëshmitari C) për të qenë dëshmitar i rrahjes së shokëve të së saj para se t'i vinte asaj radha për t' u rrahur.
- Natyra e zgjatur e ngjarjes (e cila ka zgjatur shumë orë përgjatë natës deri në mëngjesin në vijim).


Trupi Gjykses gjeti rrethana shtesë rënduese në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës:

- Numri i rrahjeve të viktimeve.

<sup>456</sup> Neni 64 para (1) KPK.



268. Trupi Gjykues gjeti si rrethanë lehtësuese gjendjen aktuale shëndetësore të Sabit Gecit.
269. Në lidhje me Riza Alijan, Trupi Gjykues gjeti rrethanat rënduese si në vijim:
- Kohëzgjatja e ndalimeve të viktimave në të dy kampet.
  - Numri i viktimave.
  - Efekti i rrahjeve dhe keqtrajtimit në shëndetin fizik dhe mendor të viktimave, përfshirë lëndimet persmanente të pësuar.
  - Përdorimi i objekteve të tilla si shkopinj dhe shufra hekuri gjatë rrahjes së viktimave.
  - Provat nga një numër burimesh se Riza Alija tepër i dhunshëm dhe brutal, dhe më i “padiisciplinuar” se të tjerët.
270. Trupi Gjykues gjeti si rrethanë lehtësuese gjendjen aktuale shëndetësore të Riza Alija.
271. Përsa i përket Haki Hajdarit, Trupi Gjykues gjeti rrethana rënduese përdorimin nga ana e tij të shkopinjve të drurit dhe dhunën e tepërt të paarsyeshme gjatë rrahjes së Dëshmitarit N. Si rrethanë lehtësuese, Trupi Gjykues gjeti faktin se Dëshmitarë të ndryshëm kanë identifikuar Haki Hajdarin si person që ka ndërmarrë hapa pozitivë që të lehtësojë barrën dhe parehatinë e mbajtjes së tyre.
272. Përsa i përket Shaban Hotit, Trupi Gjykues gjeti rrethana rënduese përdorimin nga ana e tij të shkopinjve të drurit dhe dhunën e paarsyeshme të tepërt gjatë rrahjes së Dëshmitarit N. Trupi Gjykues nuk gjeti rrethana lehtësuese.
273. Secili prej të pandehurve është dënuar të paktën për një akuzë të Krime Luftë kundër Popullatës Civile, në pajtim me Nenin 142, KP, RSFJ. Kodi Penal i RSFJ-së parasheh një dënim minimal prej pesë vjetësh burgim dhe dënim maksimal me vdekje për këtë



vepër penale. Dënimi me vdekje u hoq më vonë në Kosovë dhe u zëvendësua me burgim prej dyzet vjetësh.<sup>457</sup>

274. Trupi Gjykses caktoi dënime individuale për secilën akuzë ndarazi në bazë të kontekstit dhe rrethanave të aktit penal individual dhe dhe në bazë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të aplikueshme për secilin të pandehur dhe secilën vepër penale. Gjatë përcaktimit të dënimit unik për ato të pandehur të cilët janë dënuar për më tepër se një vepër penale, Trupi Gjykses është kufizuar nga ligji penal i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, KP RSFJ, maksimumi i dënimit unik prej 15 vjetësh burgim.<sup>458</sup> Dënimet individuale dhe unike të caktuara kundër secilit të pandehur janë përcaktuar në dipsozitiv.
275. Përsa i përket Sabit Gecit dhe Riza Alijat, atyre u llogaritet në dënim koha e kaluar në paraburgim, në pajtim me Nenin 50, paragrafi (1), KP, RSFJ. Sabit Geci ka qenë në paraburgim që nga data 06 maj 2010 dhe Riza Alija ka qenë në paraburgim që nga data 23 qershor 2010.

## **XI. SENDET E KONFISKUARA**

276. Konfiskohet arma e gjetur në posedimin e Sabit Gecit, një pistoletë gjysëm-automatike Crvena Zastava M-57 Lux kaliber 7.62x25mm, në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1), KPK dhe Neni 494 Paragrafi (1), KPPK.

## **XII. KËRKESA PËR DËMSHPËRBLIM**

277. Gjatë procedurës penale, Dëshmitari N, si Palë e Dëmtuar, ka parashtruar një kërkesë për dëmshpërblim për lëndimet e pësuar gjatë ndalimit të tij të paligjshëm dhe rrahjeve në kampin e UÇK-së në Cahan. Ai vuan akoma nga sëmundje fizike dhe lëndim permanent. Si dokumente mbështetëse, ai ka parashtruar kopje të shtatë

<sup>457</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, 12 dhjetor 1999; Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, 27 tetor 2000.

<sup>458</sup> Neni 48(3) KPK, RSFJ.



rekomandimeve mjekësore për t' u vizituar tek mjekët specialistë si dhe një recetë lëshuar nga një specialist.

278. Dokumentet e parashtruara së bashku me kërkesën për dëmshpërblim kanë pajisur në mënyrë të pamjaftueshme me informata Trupin Gjykues për të qenë në gjendje të përcaktojë se në çfarë niveli janë të përligjshme lëndimi, dhimbja dhe shuma financiare që kërkohet në dëmshpërblim. Padia vetë nuk përmban ndonjë shumë monetare harxhuar për shpenzime mjekësore dhe nuk përmban ndonjë shumë e cila kërkohet për dhimbje dhe vuajtje mendore dhe psikologjike. Nuk është parashtruar asnjë faturë apo dokumentacion mbi shpenzimet e bëra për shërbime mjekësore. Për të përcaktuar kërkesën për dëmshpërblim do të ishin dashur kërkime të tjera të rëndësishme dhe kjo do të kishte rezultuar në vonesën e procedurës penale.
279. Për këtë arsye Trupi Gjykues udhëzon Palën e Dëmtuar, Dëshmitarin N që të parashtojë padi ligjore të veçantë në procedurë civile për kërkesën e tij për dëmshpërblim, në pajtim me Nenin 112(2) KKKP.

### **XIII. SHPENZIMET**

280. Duke patur parasysh se ata janë dënuar, secili prej të pandehurve duhet të kompensojë pjesën e tyre të shpenzimeve të procedurës penale në pajtim me nenin 102(1) KPPK, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit me gojë dhe shkrim. Secila pjesë e shpenzimeve është përcaktuar në shumat e paraqitura në dispozitiv.

### **Gjykata e Qarkut Mitrovicë P. nr. 45/2010**



Përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Tara Khan  
Proces-mbajtëse



Jonathan Welford-Carroll  
Kryetari i Trupit Gjykues

Xhevdet Abazi  
Anëtar i Trupit Gjykses



Caroline Charpentier  
Anëtar i Trupit Gjykses

*Mjet ligjor:*

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij akt-gjykimi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut Mitrovica brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të kopjes së akt-gjykimit, në pajtim me nenin 398(1), KPPK.